

BIBLIOTE
SHTETI

854-3

M 3

ANDON
MARA

Kapedan cilia dhe i nipi

TREGIME

ANDON
MARA


854-32

M 32

KAPEDAN CILJA DHE I NIPI

Tregime

2633



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KAPEDAN CILJA DHE I NIPI

Po latonte një bisht kazme, i ulur në një fron, mu në mes të oborrit, me këmbët e gjata të hapura. Rrëzë qafës kishte shaminë e vjetër të kuqe me ca pulla të murme, me cepat të palidhur; kapën prej kadifeje të zezë, dalëboje, e kishte ngritur pak; cullufet e zbardhura, të dredhura lehtë, i binin mbi ballin e djersirë; mustaqet i kishin mbetur më të errëta se flokët; mjekra, me më shumë thinja, i ishte rritur, e parruar prej gati një javë.

Dielli po ngrohte në ato ditë marsi. Dimri nuk kishte qenë i ashpër. Me të hyrë shkurti, kishte filluar të frynte juga, që e kishte ngritur dëborën ca nga ca. Ishte zbuluar toka e zezë, që avullonte. Nga mesi i muajit të shkuar kishte pasur ditë me shira. Pastaj moti ishte hapur përsëri dhe që atëherë po mbante. Toka kishte vlagë e afsh. Kjo i kishte gjëzuar fshatarët, se do të mbillnin më herët. Kush mbjell herët, mbledh herët. Këtyre anëve të ftohtët e dimrit zbriste shpejt nga majat e maleve, bryma zinte misrat në arë e i digjte.

Ai ndiente nxehtësi, një farë peshe në trup.

Fshiu me kurrizin e dorës djersën dhe vazhdoi punën, me kokën poshtë e me sytë ngulur në atë copë dru. ahu, që po merrte trajtë e po gdhendej për merak.

Atë çast, gjerr-gjerr, erdhi një zhurmë jo e zakonshme që poshtë fshatit. Ai ngriti veshin për të shquar q'ishte, kur, fap, latorja i zuri gishtin e mesit të dorës së majtë. Gjaku skuqi drurin.

Shau nëpër dhëmbë, flaku latoren e drurin dhe u çua në këmbë. Drejtoi trupin e gjatë dhe hodhi vështrimin andej nga vinte zhurma. Por rruga për në fshat nuk dukej e tëra. Një pjesë të saj e zinin shtëpitë e Xexollarëve dhe pemët e oborreve.

Doli për tu ngritur më lart, te lëmi i Dodanëve. Nxitoi me hapat e tij të mëdhenj. Gishti i prerë i digje. Shikoi dhe vuri re se gjaku nuk kishte pushuar. Disa pikë kishin rënë mbi rrobat prej shajaku të zi. Qëndroi, nxori nga xhepi i jekut kutinë e trashë të duhanit dhe e pllakosi gishtin me duhan; pastaj e mbështolli me shaminë e qafës dhe mori përpjetë.

Nga lëmi i Dodanëve fshati dukej si në pëllëmbë të dorës. Mirë i kishte shkuar mendja. Zhurma ishte e makinave të ushtrisë. I numëroi: pesë kamionë të mbushur plot. Kishin qëndruar në jug të fshatit, atje ku fillonin manat. Ushtarët po zbrisnin nga makinat dhe po shkonin drejt çadraive, që ishin ngritur prej disa ditësh, nën drurët.

«Të tjera breshka!» murmuriti ai dhe shtrëngoi nofullat.

U ul anës lëmit të shtruar me plloça. Nxori nga xhepi llullën, që e kishte punuar vetë, këtu e tridhjetë vjet të shkuar, disa ditë para se çeta

e tij të zbriste në qytet për të ndjekur ushtrinë e turkut. Llullën e kishte qëndisur me vijaska e me lule. Koka e saj ishte djegur, bishti i ishte ngrënë, por ai kishte qejf ta pinte duhanin me këtë llullë.

E mbushi dhe e ngjeshi me gishtin e madh, që i dukej si një xhungë. Shkrepit urorin mbi gurin, ndezi eshkën dhe e vuri mbi duhanin. Filloj ta thithje llullën me etje dhe të nxirrte tymin nga goja me duf.

— «U pa kjo punë!», mendoi ai.

Kishte një mllef të madh përbrenda këta tre vjet. Një mllef, që i bëhej si lëmsh e i zinte frymën, sa herë që shikonte ushtarë të huaj. Ai rrallë zbriste në qytet, ndonjë ditë pazari. Atje i prishej gjaku më shumë. Në fshat ishte disi më i qetë, ndonëse mendja i punonte gjithnjë në ato që po ndodhnin. Mirëpo, ja, edhe fshati i tyre po mbushej me ushtarë kësulëzinj.

Iu kujtua dita e parë, kur ata kishin shkelur. Dhe iu bë sikur përsëri iu afrua, si atë ditë, ja, mu këtu te lëmi, Petroja, moshatari i tij, me atë fytyrë të butë e të fishkur e me atë kokën krejt të bardhë.

«Ke hyrë në të thella, kapedan Cile!» — i kishte folur ai.

«Hë, ti, Petro, je?...»

«Ku të punon mendja?»

«Ku të më punojë... Shikoj makinat me ushtarë. Është karvani i dytë që po vjen sot».

«Po shtohen si mizat. Na zunë mat. Do të na i bëjnë bërlok!»

«Manat vdiqën, flije mendjen.»

«Ti je i rrahur me këto punë, Cile, vëlla. Ka-

pedan ke qenë, ke luftuar turkun, ke luftuar me andartët grekë... si thua t'i vejë filli kësaj pune?»
«Si do t'i vejë... Doli ujku i tërbuar... Ai do plumbin. Por kush do t'ia japë se...», — tundi kokën i menduar Cilja.

«Nuk kanë humbur burrat...»

«Hëm!... Nuk kanë humbur, thua ti... Po ku i ke?... Na hëngrën me të pabesë, qentë! Na shkelën gjakun, na morën pushkët, dhe u shtruan këmbëkryq bejlerët dhe afendikonjtë! Ne mbetëm zorrëthatë; mbetëm si kau me qafën në tevlig; Ja, tani, dhe breshkat! Doemos, këtë do të na bënte mbreti faqezi. Qeveritarët na lanë në baltë, e ia mbathën!».

Petroja nuk kishte folur më. Kishte mbetur ashtu, duke vështruar qetë, sikur po i thoshte: «Ke hak».

Këto i shkuan ndër mend Ciles, tek po rrinte mbi plloçat e lëmit. Ai u ngrit, dhe, duke përplasur llullën e shuar mbi kofshën e djathët, zbriti për në shtëpi.

Atë drekëherë ai kishte mbetur vetëm. I nipi ishte në arë. Të tjerët kishin ikur. Shtëpia dukej e shkretë. Në mes të oborrit pa latoren dhe druvin që kishte hedhur. Hoqi shaminë nga gishti. Duhani ishte ngjitur mbi plagë. I fryu. Disa fije u shpërndanë e ranë. Të tjera mbetën të ngjitura në vendin e prerë. I la kështu. Mbi rrobat dalloheshin ende pikat e gjakut. Deshi t'i lante. Njomë një cep të shamisë në ujin që kishte fundi i kovës së pusit, fërkoi njollat, por ato nuk u zhdukën plotësisht. E fërkoi vendin edhe një herë me pëllëmbën e dorës, pastaj hodhi shaminë në supin e

majtë dhe u ul në fron. Donte ta mbaronte bishtin e kazmës dhe t'ia vinte veglës.

Nja dy herë iu dëgjua uturimë që poshtë fshatit. U ngrit, zgjati kokën matanë avllisë, doli pastaj te porta. Nuk pa gjë. Ç'djall! Veshët më bëjnë?», tha me vete. I erdhi inat. Mori kazmën dhe i vuri bishtin. Tak-tak, e ngjeshi mbi plloçat e oborrit, që të hynte mirë. Veshët i buçitën. Mbajti frymën. Fshati ishte i qetë. Vetëm një kandër cinxeriste. Bishti i kazmës kishte zënë vend. Ai e ngriti veglën me të dyja duart. Iu duk e rëndë. Bishti nuk ishte as i gjatë as i shkurtër. Vegla kishte peshë. Maja dhe tehu ishin të mprehtë.

E shpuri kazmën dhe e la në një anë të ashefit, atje ku mbanin veglat e punës. Pastaj u kthyte dhe qëndroi në mes të oborrit. Dukej si një njeri në mëdyshje. Nuk dinte ç'të bënte. Shkoi te porta. Në rrugicë nuk kishte njeri. «Xhanxin?!», pëshpëriti. Ku të shkonte në këtë orë? Rakoja e mbyllte kafenenë në kohën e drekës. Moshatarët e tij merrnin një sy gjumë në këtë kohë. Ai nuk shtrihej ditën. Edhe natën gjumin e kishte si të lepurit. Macja të shkonte në hajat, ai do ta ndiente. Hej, kohë komitësh! Që atëherë gjumin e kishte pendë, kurse nga veshët ishte gjithnjë bilbil.

Me tre-katër hapa, që nga porta u fut në tremen e shtëpisë. Hyri në sobë, doli përsëri, vështroi andej - këndej, sikur të kërkonte diçka, të merrej me ndonjë punë. Por u vërvit më kot. Me atë hapin e tij një hosten të gjatë, bëri prapë për te porta.

Atë kohë në oborr hyri një djalosh i hollë, i gjatë, bukurosh e vetullor. Kishte një hundë të kthyer, që ngjiste me të kapedan Ciles.

- C'u ngjite? — e pyeti kapedani.
— Kam pak punë...

Dhe, pa e zgjatur, djaloshi u fut në ulicën e shtëpisë, prapa së cilës kishin një copë vend, ku mbanin dy dhitë, gomarin, plehun dhe kashtën për dimër.

Cilja hodhi sytë me habi nga djali.

Prej ca kohësh po e shikonte si të ndryshuar nipin e tij. Ai ishte bërë më i heshtur. Sytë e tij sikur kishin marrë një hije më të rëndë. Hynte e dilte në shtëpi disi me rrëmbim. E hante bukën sikur ta ndiqte njeri, pastaj kristë e ikte. Natën kishte zënë të vinte vonë. Kapedan Cilja, e ndiente, «Kërr-kërr», kërcisinin shkallët e drunjta. Djali ngjite në katin e sipërm.

Disa net përpëra, mendimet e kishin ngritur kapedanin nga shtrati. Ai kishte dalë në prag të tremes dhe kishte ndezur llullën. Ndofta ishte mesi i natës. Drita e hënës binte pingul në oborr. «Krak», u dëgjua kllopasshka e portës dhe kanati i saj u hap e u mbyll përnjéherësh. I nipi hyri duke dihatur. Kur pa të gjyshin, e ngadalësoi hapin dhe u përpoq të fliste qetë:

- Mirëmbrëma
- Nga ishe kështu?
- Te Bojkot.
- E ç'bënët gjer tanë?
- Hiç, muhabet...

«Te Bojkot... S'para e ka pasur me ta më parë... Nuk janë as vërsnikë...», mendoi Cilja.

I vajti mendja te djali i madh i Bojkove. Vittin e kaluar, kur në qytet kishte ndodhur trazirë, kur njerëzit kishin dalë me flamurë nëpër rrugë dhe kishin thirrur kundër italianëve, bashkë me të

tjerët, këmishëzinjtë e kishin hedhur brenda. E mbyllën nga katër muaj. Kur doli, dukej se kishte luajtur druri në kurrizin e tij.

...Dhe ja, përsëri i nipi hyri e doli si era nga ulica, iku pa thënë pse kishte ardhur e çfarë kishte kërkuar.

«Dreqi e merr vesh punën e tij!», tha me vete kapedani, tekxa i nipi kapérceu pragun e portës.

Nuk i rrihej në shtëpi. Doli për në kafene. Përpara portës së saj, plaka e Xexollarëve po fliste me një grua ngarkuar me shkarpa.

— Shpirti m'u drodh gjersa bëra këto të flamosurat! Më dukej sikur do të na dilnin ushtarët. Kishim dhe nuset e Lelove e të Dinajve. Veç që na jepte zemër e Vançit. «Të na bëhen kurban!, — na thoshte. — Pa le të vijnë... Po mos ua futa me kosore kokës!...»

Kur ai kaloi para tyre, plakëza e pakët i thirri:

— Nga kështu, kapedan?

— Do të hidhem një çikë në kafene...

— Po pse ke dalë kështu, jelekçe?

— Kam vapë. Ky marsi po na djeg...

— Uh! C'është kjo vapë që tanë! Mos u gënje nga marsi, kapedan. Merr setrën, se zemërherë fillon era e grykës dhe ftohesh. Nuk ia ka vaktin mosha jonë për këto punë. S'ke as nusen të të bëjë hyzmet. Merr setrën...

— Jo, jo, — ia ktheu ai dhe ia mbajti poshtë.

Në mendje po i vinin fjalët e gruas së ngarkuar me shkarpa. U kishte hyrë frika grave. Nuk guxonin të ngjiteshin as gjer përmbi fshat për të mbledhur një krah karthje. Eh, ç'maskarenj që ishin kësulëzinjtë! Ata kishin shkelur këtë tokë, po u rrëmbejn mallin e gjënë, donin të vinin

dorë dhe mbi nderin e tyre!» Jo, jo, o edepsëzë! — tha me vete Cilja. — Shqiptarja është me një barrë nder. Ajo nuk e shet atë. Ta dini! Mirë paska thënë e Vançit. Po: jua fut me kosore kokës!».

Rakoja sapo e kishte hapur kafenenë e vogël, që e kishte në një qoshe, aty në mes të fshatit. Dy pleq e ai tre po kuvendonin në një tryezë. Tjetër njeri nuk kishte. Cilja u bashkua me ta. Në atë kohë në kafene hyri një ushtar i shkurtër, pas tij dy të tjerë, të gjatë, me nga një kapë si hinkë, anash saj ngulur një pendë. Njëri prej tyre, që kishte një mjekër të kuqe e të ashpër, i foli Rakos me zë të trashë:

— Çe vino?

— Si.

— Su, dai!¹⁾

Kuqoja dhe shoku i tij u ulën në tryezë. Rakoja u mbushi kupat, të cilat ata i rrëkellyen menjëherë. Kafexhiu ua mbushi prapë.

Ushtari i shkurtër kërkoi cigare.

— Non çe lux? — tha.

— No. Tarabosh...

— Eh, il kapitano vuole sigarete di kualita²⁾,

— vazhdoi ushtari.

Rakoja po e shikonte si i hutuar që prapa banakut dhe e merrte me mend kuptimin e fjalëve të ushtarit.

— Beh! Vado a dirlo. Se li piaçiono, ritorno.³⁾,

1) (Ital.) — A ka verë? — Po. — Hajde, na jep!

2) — S'ka luks? — Jo. Tarabosh. — Eh, kapiteni do cigare të cilësish.

3) Beh! Po vete t'i them. Në qoftë se i pëlqejnë, do të kthehem.

Kapedan Cilja e ndoqi ushtarin me sy, tek do li nga dyqani. Pastaj pështyu dhe u tha dy pleqve.
— Si kërma mbajnë erë!

Ai u ngrit, shikoi vëngër ushtarët e tjerë, që po pinin dhe u largua. Shokët e tij i shkuat pas. Jashtë kafenesë, te kthesa, kishte një sofatillëk, ku pleqtë e burrat mblidheshin mbrëmjeve e bisedonin. Përpara hapej sheshi i vetëm i fshatit, kurse më tej ishte kroi me dy gryka të hekurta e një postaf të madh. Dy vajza po mbushnin stomnat e bucelat. Pleqtë u ulën në sofat të heshtur.

*Bella alpina,
dolce, biondina...1)*

U erdhi në vesh zëri i trashë i mjekroshit. Ushtarët kishin dalë në qoshe, po vështronin vajzat e po qeshnin. Kuqoja eci drejt kroit.

— Sinjorina, dami un po di akua, per favore...²⁾
— i foli njérës me laturi dhe bëri një përkulje përpara saj.

Vajza u shtie sikur nuk dëgjoi, hoqi bucelën nga çezma dhe mori me të shpejtë rrugicën. Ushtarët iu afrua tjetrës. Në këtë kohë kapetan Cilja u hodh në mes të vajzës dhe ushtarit. Ai shpëlau duart në ujin e kroit, u kërrus sikur do të pinte dhe i pëshpëriti vajzës:

— Mos ki frikë, s'e lë unë të të prekë. . Merrri enët dhe nisu.

Ajo ngriti stomnën me vrull. Uji u llokoçit dhe u derdh nga lëfyti. Vajza vapoi tutje.

1) — Malësore e bukur, leshverdhë e ëmbël.

2) Zonjushe, më jep pak ujë, të lutem.

— Aspeti, karina, non aver paura... Ti volio bene, ti volio bene...¹⁾) — thirri mjekroshi, duke bërë disa hapa në drejtim të vajzës. Pastaj u kthye nga kapedan Cilja, që po fshinte duart me shami e po largohej nga kroi.

— Ej, tu, strigone, koza vieni far kui? Sai ke ti skiaçio kome un pidokio?²⁾ skërmiti dhëmbët ai.

Cilja nuk i mori vesh fjalët, por ndjeu qëv ku-
qoja po e shante dhe po i kërcënohej. Ai vazhdoi rrugën dhe murmuriti:

— Ç'më çan kokën, o surratbajgë! Ç'e di këtu, bordellanë të Italisë?! Andej nga haleja të shkojnë këto ndër ne!

Edhe pleqtë e tjerë ishin ngritur nga sofati. Baskë me Cilen u nisën për lart.

— Janë maskarenj, — tha njëri.

Cilja ziente përbrenda. Në shtëpi nuk gjeti qetësi.

I nipi erdhi kur u ngrys. U ul afër vatrës, kundrejt të gjyshit. Ky hapi muhabetin e ushtarëve, që kishin çallëstisur në fshat, foli për gjënë e fshatarëve, që do ta përlante lumi, për nderin e grave e të vajzave, që breshkaxhijtë donin ta njillosnin.

— Ditën vijnë ushtarët, natën vijnë topat. Fshatin po e ndrydh hekuri, — ia priti djaloshi.

— Dhe një zot e di se kur do të na shkulen... — murmuriti Cilja.

— Ata nuk shkulen vetë, — ngriti zërin i nipi.

1) Prit, e dashur, mos ki frikë... Unë të dua, të dua.

2) Ej, tij, shtrig, ç'kërkon këtu? E e di se të shtyp si një morr?!

— Këtë e di më parë se ti, — sikur u prek gjyshi. — Po kush do t'i shkulë se?...

— Ne, — u hodh djali, duke ia prerë fjalën.

— Kush «ne»?

— Shqiptarët.

— E ku janë këta shqiptarët? Apo mos e ke fjalën për ata surretër që janë veshur xhandarë? — u tall Cilja.

— E kam fjalën për bijtë e popullit, jo për disa tradhtarë.

Fjalët e të nipit i dukeshin kapedan Ciles të guximshme e të mendshme. Por ai djalosh tetë-mbëdhjetëvjeçar, të cilit sa po i kishte zënë push faqja, nuk ia mbushte mendjen. Tek po e shikonte, ata sytë e tij të zinj, që sikur ishin plot xixa, i sollën ndër mend, padashur, një nga komitetët e rinj, që kishte pasur në çetën e tij, Milon.. Kështu syzi, i imtë, dhe në moshën e të nipit kishte qenë atëherë ai. Por djalë trim, ama. I tillë ishte dhe Dali-pi, ndonjë mot më i madh, por të merrte gjak në vetull... Mirëpo ishin të tjerë njerëz asokohe, mendoi Cilja. Kurse tani... Nuk është më ai brumë. Ka ndryshuar. Brezi i sotëm është i kërthnjtë.

Cilja tundi kokën dhe qëndroi me sytë të ulur.

— S'po i shikoj këta bij të popullit... — tha ai nëpër dhëmbë.

Pastaj, sikur e kishte zënë të nipin në fjalë, e vështroi në sy dhe priti përgjigjen e tij. Gjysh e nip i mbajtën sytë të mbërthyer te njëri-tjetri. Ata sy sishin të njëjtë, të zinj, të rrumbullakët e me kokërdhokë të mëdhenj. Nipi i kishte shumë të ndritshëm. Por edhe sytë e gjyshit, me gjithë moshën, vazhdonin të ndritnin ende.

Qëndruan të heshtur disa çaste, pastaj djali u përgjigj:

— Bjtë e popullit jemi ne!..

Cilja buzëqeshi.

— Këto fjalë ma përkëdhelin veshin, — tha. Më vjen mirë të të shikoj të hedhur e trim, mirëpo s'më ngjan i tillë.. .

— Ti s'ke besim, e di... — foli djali, — por në damarët tanë, ne, të rinjtë, kemi gjakun tuaj, të gjyshërve, që kanë luftuar... .

Cilja hapi sytë dhe shtrëngoi buzët. Vetullat iu mblohdhën. Midis tyre u sajuan tri vija. Balli iu rrudh më shumë. Fjalët e të nipit i shkaktuan një farë dridhjeje përbrenda. Ai thithi dy herë llullën dhe tha:

— Zemra ma do që t'ju ketë mbetur jar i kulluar gjaku ynë. Gjakun tonë s'e digjte dot as flaka, s'e ngrinte dot as akulli... .

— Ashtu ka mbetur, gjysh, jar i kulluar. Hiç mos të të hajë ai merak.

2

Kaluan tri ditë.

Nata kishte rënë me shumë yje.

Një flakëzë verdhoshe e kandilit mbi oxhak thyente errësirën që kishte pllakosur në sobë. Cilja po rrinte fillikat, këmbëkryq e i kërrusur në minder, me setrën krahëve, me llullën në gojë. Hija e tij e stërmadhe shtrihej mbi muret e zhveshura

Ishte fillikat me mendimet dhe shqetësimet e tij. Vegime i bëheshin përpëra syve. Fishkëllima plumbash mbushnin ajrin, jataganë, farfurinin,

fustanella hidhesin shkrep më shkrep, thirrje të llahtarisura ushtonin, koka priteshin e trupa shtriheshin, një flamur, me shkabë e me fjalët «Ja vdekje, ja liri!», valëvitej. Ai ishte atje, në mes të shkreptimave e të tymit, i gjatë e i shkathët, me mëngët e gjera të këmishës gjer në bërryl, me dy dhjetëshe turke në brez, me një thikë varur në zinxhir anash, me një malisher të shkurtër në dorë, Jepte urdhra e shtinte mbi asqerët, «O burra, bjeruni! shfarosini!», thërriste.

Pastaj vegimet shuheshin dhe ndihej i qullur në djersë e me gojë të shkrumbosur. Errësirë i bë-hej tani. Errësirë e dendur, Ai nuk shikonte asgjë. Ndihej i prerë e i këputur. Kjo ia ngjethte mish-të, ia kreshpéronte qimet, e tèrbonte. Në veshë i vinin fjalët e të nipit: «Bijtë e popullit jemi ne!». Dhe ai mbetej si i shushatur.

Kësaj radhe nuk dëgjoi kërr-kërrret e shkallëve nga këmbët e dikujt, që u ngjit. Nuk dëgjoi, më vonë, as të trokiturat e forta në portën e shtëpisë. Vetëm kur u shkundën kanatet prej rrobulli të vjetër, kur krisën e u hapën, atëherë ai u përmend, u ngrit, mori kandilin në dorë dhe doli në pragun e tremes.

Tre karabinierë u sulën mbi të dhe i shfrynë fjalë të pakuptueshme. Njëri e shtyu me tytën e revoles dhe hyri në sobë.

Si nuk gjetën njeri këtu, karabinierët bënë përlart.

Cilja i ndoqi pas.

— Su, maskalcone!¹⁾ — klithi kreu i karabinierëve.

1) Haj, maskara!

Në shtratin prej dërrase, mbuluar me një velenxë të dhirtë, ishte shtrirë nipi i Ciles. Ai kishte rënë në gjumë të thellë.

— Sbrigati, delinkuente!¹⁾ — lëshoi një bëtmë të çjerrë karabinieri.

Tytën e revoles me mulli ai e afroi te gryka e djalit, që flinte. Cilja ndjeu sikur një majë thike e imprehtë po i afrohej në zemër. Ai kérceu pranë kokës së djalit, afër marshallit. Ky ngriti fletën e velenxës me tytën e revoles.

— Mos! — thirri Cilja dhe me gishtërinjtë e tij eshtakë mbërtheu kyçin e dorës leshtore të marshallit E shtrëngoi fort, sa tjetri bërtiti:

— Ah! via,²⁾ — dhe ktheu revolen drejt kraharonit të Ciles.

Por ky nuk ia lëshoi, dorën; ia shtrëngoi më fort.

— Nuk lëviz, jo! Jam në shtëpinë time! Qërohuni që këtej! — kundërshtoi Cilja.

Karabinierët e nxorën jashtë.

Në këtë kohë djaloshi ishte zgjuar dhe kishte qëndruar ulur në shtrat. Marshalli e zuri përsupi dhe e tërhoqi.

— Ç'doni prej meje?! — tha djaloshi.

Tjetri nxori nga kutia, varur krahaqafë, një palë pranga dhe deshi t'ia shkonte djaloshit duarve. Ai iu shmang dhe u hodh nga shtrati. Iu sul karabinieri tjetër.

— Me ç'të drejtë më arrestoni?! — thirri djaloshi.

— Smetila!³⁾ — iu kanos marshalli.

1) Tundu, kriminel! 2) Ah! Ik! 3) Pusho!

E shtynë nëpër shkallë dhe u nisën me ngut.
— Ku e shpini djalin? Ku e shpini? — vra-
poi pas tyre Cilja.

Kandili iu shua, por ai e mbajti ashtu në dorë,
të ngritur, duke e tundur me ritmin e fjalëve të
ashpra. që shqiptonte kundër karabinierëve.

— Lëreni djalin, katila! Gjakësorë, lëshomani
djalin!... vazhdonte të thërriste.

Ai nuk iu nda atyre, i ndoqi, ashtu në çorape,
siç ishte, ndonëse ata ktheheteshin, i skërmirë dhë-
mbët dhe e shanin.

Djalin e futën në atë dyqanin e vogël të fshatit,
të cilin e kishin shndërruar në karabinieri. Cilja u
turr mbi derën që përplasën ata dhe filloi të godasë
mbi të me grushtin e tij tërë nyje, duke bërtitur:

— Bij bushtrash, lëshojeni djalin!

Koka e tij kishte marrë zjarr dhe ai donte t'u
hidhej atyre në grykë, t'i mbyste me ato duart e
tij, në të cilat ndiente se kishte ende aq fuqi.

Dera u hap rrëmbimthi dhe gjëmoi ulërima e
marshallit:


— Vatene, porko dio!¹⁾

Ai i këputi një shqelm Ciles mu në bark
krejt papritmas. Cilja ra në kurriz. Kandili i shuar
i iku nga dora dhe u rrokullis në vijën e ujit, që
rridhte poshtë.

Nuk po mblidhte dot veten. Barku i therte.
Shpatullat i ishin vrarë keq në gurë. Mbeti një
copë herë pa lëvizur. Pastaj, ngadalë, duke duruar
dhembjet e trupit, u ngrit ndenjur dhe u mblodh
kruspull. Që nga dyqani vinin zëra e fjalë të pa-

2633

1) Qërohu, derro perëndi!



kuptueshme. Ai ndiente në ata zëra një tërbim e një kanosje. E kuptonte se ç'mund të ndodhë me të nippin.

3

Në atë qelinë e karabinierisë, që ishte zyrë e burg, djali po dergjët në dysheme. Bluzën e leshië ngjyrë vishnjë ia kishin hequr. Kémisha me vija i ishte grisur dhe lyer me vurrata gjaku. Sytë i ishin buhavitur e mavjosur. Në vrimat e hundës dhe rrëth gojës gjaku i ishte mpiksur. Në mollëzat e faqeve dhe nënofulla i shquheshin qukat, që kishin lënë gozhdët e këpucëve të marshallit.

Për të dytën herë ai i kishte humbur ndjenjat e kishte rënë në krahun e djathë. Karabinierët e kishin kthyer në kurriz: dhe ai kishte mbetur me krahët të hapur. I kishin hedhur një kanë ujë në fytyrë; ai kishte përpëlitur sytë, por nuk ishte përmendur,

— Akua¹⁾, — u tha marshalli karabinierëve.

Një kanë tjetër u derdh në fytyrën dhe në kraharorin e zbuluar të djaloshit, i cili rënkoj dhe lëvizi kokën. Pastaj hapi sytë. Vështrimi i tretur i mbeti i mbërthyer në tavani. Marshalli iu afroa, e zuri për supi, i ngriti kurmin dhe e mbështeti në mur.

— Trego, se ndryshe të mora shpirtin!

— Nuk kam ç'të them.

— Kush i hodhi traktet komuniste në kampin e ushtrisë?

— Nuk e di.

1) Ujë.

- Njëri nga ata je ti, Pirro Graba! — kërciti dhëmbët marshalli dhe afroi fytyrën e tij të zeshkët. — Trego shokët! Trego ku i morët traktet!
- Kot e keni. Nuk di gjë.
- Do të të torturoj!
- Këtë ke bërë gjer tanë.
- Do të të vras!
- Edhe këtë mund ta bësh. — Dhe një përqeshje u vizatua mbi buzët e djaloshit.

Marshalli u tërbua dhe u bë dyllë në fytyrë. Ndezi një cigare dhe u dha shenjë karabinierëve. Këta i zunë krahët djalit, kurse marshalli u ul në bisht, i shqeu këmishën dhe hapi me shumë kraharorin e tij, mbi të cilin drejtoi e nguli majën e ndezur të cigares. Djalit iu tkurr fytyra dhe iu mblohdhën buzët. Marshalli vazhdoi punën e tij. Maja e cigares kaloi mbi eshtrën e sipërme të kraharorit pastaj në gropëzën e tij dhe u fut nën sjetullat. Të djegurat mbuluan trupin e djalit, të cilit i ranë djersë në fytyrë. Ai shtrëngoi nofullat dhe shqiptoi:

— Ju jeni bisha! Por do t'i paguani, do t'i paguani të gjitha! ...

Mesi i natës kishte kaluar. Në fshat kishin filluar të këndonin gjelat.

Pirro Graba ngriti ngadalë kapakët e syve dhe vështroi rrëth e qark. Ishte aty, në kthinën e karabinierisë. Duart i kishte në pranga. Nuk po e torturonin më. Por mund të fillonin prapë. Goja e tij nuk kishte thënë gjë. Këtë e dinte mirë. Dhe

kjo e qetëson te, duke i duruar ato te cara, ato te dje-gura, ato te se mbuara, qe i per shkonin gjith te trupin.

Mbylli syte. Traktet i shperndan e ashtu si du-hej. Aksioni ishte kryer. Shoket e tjer e ishin shen-dosh e mir e... Kjo kishte rendesi. Ai vet e do te qendron te. Kishte fuqi te per ballonte qdo mundim.

Ndjeu nj e lehtesim ne vetvete. Veshtroi edhe nj e her e rrotull, nep e kthin e. Llamba me vaj-guri po vazhdonte te leshonte nj e drite kalt eroshe. Pran e saj, mbi tryez e, karabinieri kishte ven e duart e kishte mbeshtetur kok e mbi to. Djali e kundroi dhe mbajti vesh. Nj e frym e marrje me fis-hkellim e te mytur dilte nga buzet e karabinierit. Ai po flinte. Djaloshi per gjoji caste te tera. Donte edhe dy ore te gdhie. Sapo vagellonte drita, ne keto dite te motit te mir e fshatar e nxirrin gjene e gjalle per kullote, se plevicat u ishin zbra-zur. E nxirrin dhe e futnin her e, e ruanin nga ushtria, qe ishte brigjeve. Ai mendoi se agimi i dit es se re do te ishte me i rende per te. Levizi duart; ndjeu hekurat, qe i shkaktuan dhembje ne kyce. Beri te ngrihej. I theren brinjet dhe ijet. Por i dha vetes dhe u ndodh ne kemb e. U capit. Nj e cast iu mor en mendt e. Qendroi dhe u mbajt pas tryez es. At eher e karabinieri ngriti kok e dhe e mbajti pezull, qe te per mendej. Pastaj veshtroi djalin dhe thirri:

— Fermi!¹⁾

Por djaloshi, me duart e lidhura, rrrembeu llamben e ndezur dhe ne cast e hodhi mbi fytyren e karabinierit. Ky klithi e ra posht e. Pran e kok es

1) Qendro!

së tij dyshemeja mori flakë, gjuhëzat e saj u përhapën mbi karabinierin.

Djali hapi derën dhe doli në rrugë.

Ajri i freskët i përkëdheli fytyrën, Mori frymë thellë dhe ndjeu freski në mushkëri dhe në gjithë trupin. Po i vinin fuqitë, po përtérihej. Shpejtoi hapin dhe ktheu në dy qoshe.

Që poshtë u dëgjuan pushkë. Një, dy, tri, të shtëna përshkuani hapësirën. Pushkët zbraseshin pa drejtim të caktuar, sa për alarm, sepse qe natë dhe karabinierët ende nuk po kuptionin qartë se ç'kishte ndodhur. Djaloshi nxitoi. Ja, shtëpia e Bojkove ishte aty, disa hapa pranë. Atje kishte një strehim të fshehtë, që e kishin sajuar djemtë. Edhe pak, edhe pak... Porta u hap! Zisi! Pas tij, gjyshi!

— Pirro! — thirri ky dhe vrapi drejt të nipi.

Të shtënat e karabinierëve fashistë u shtuan. Fërshëllimat e plumbave çanin ajrin nëpër natë. Flakët e dyqanit që po digjej çanin errësirën e dendur. Tani karabinierët e kuptuan qartë se ç'kishte ndodhur dhe u lëshuan si të tërbuar nëpër rrugët e fshatit, të kapnин djalin e arratisur.

Gjyshi dhe Zisi, djali i madhi i Bojkove, e morën Pirron dhe e futën brenda në strehimin e fshehtë.

Kapedan Cilja, pasi e pat mbledhur veten nga goditja e marshallit të karabinierisë, pat shkuar te Bojkot dhe ua kishte thënë të gjitha. Djemtë e Bojkove dhe të rinj të tjerë të fshatit me kapedan Cilen në krye, në kohën që krisën armët e para të karabinierëve, ishin duke bërë planet se si do t'uа rrëmbenin fashistëve Pirron nga duart.

Kur qenë futur përsëri në strehimin e fshehtë,

Pirroja i tha kapedan Ciles, duke duruar me të gjitha forcat dhembjet e torturave që i patën bërë pushtuesit:

— Gjysh... A ke besim te ne të rinjtë?...

Duart e tij në pranga ishin enjtur nga përpjekjet për t'i këputur.

Kapedan Cilja vuri pëllëmbët e ashpra mbi plagët e të nipit, pastaj afroi buzët dhe i puthi.

— Ti je gjaku im, gjaku i kapedan Ciles! — tha dhe mezi përbajti një dridhje të zërit të tij.

Karabinierët vazhdonin të shtinin me pushkë e të klithnin, ndërsa andej ku ishte strofulla e tyre po vinte një tym i zi, të cilin e frynte era e lindjes. Pas karabinierëve u bë alarm i madh edhe në çadrat e ushtarëve fashistë që kishin zënë vend në fshat. U zbrazën aq pushkë e mitraloza, sa thua se po bëhej një betejë e vërtetë.

Fshati u gdhi i rrethuar dhe që në mëngjes filloj kontroll i rreptë. Asgjë nuk u gjend.

Kapedan Ciles ia dogjën shtëpinë, plevicën e gjithë c'kishte.

Një javë më vonë, në një natë të errët, kapedan Cilja mori kazmën, së cilës i pat bërë bisht të ri, mori të nipin, Zisin dhe dy djem të tjera, nga të Bojkove dhe me kazma në duar i shpuri atje ku kishte pasur plevicën. Shpërndau hirin me këmbë në një qoshe dhe u tha të rinjve:

— Gërmuni këtu! o djem!

Djemtë gërmomin, ndërsa kapedani hiqte dheun me lopatë me kujdes.

Ata zbuluan një arkë të gjatë të veshur me llamarinë. E zunë nga dy dorëza hekuri dhe e nxorën nga dheu. Kapedani zbërtheu llamarinën

dhe dërrasat, çmbështolli pëlburët e vajosura dhe nxori pesë pushkë. Katër i mbështeti pas murit, kurse një maliher të shkurtër e mbaiti në dorë.

— Merrini! — u tha të nипит, Zisit e dy vëllezërve të Zisit. I kisha ruajtur për një ditë të tillë. E dija që do të vinte kjo ditë dhe që do të dilnin përsëri komitë maleve. Më shkruani edhe mua në defterin tuaj. Kapedanllëkun po jua lë juve, e keni hak. Unë do t'ju ndjek pas. Ky maliher nuk më ka turpëruar kurrë.

NJE GRUA E LAGJES SE VJETER

Vana hyri në sallën përdhese e të gjatë të fabrikës së trikove me një drithërimë në kraharor. A do të ishte edhe ajo midis punëtoreve që do të pushoheshin nga puna?

Hajroja erdhi pa filluar mirë dita e punës në fabrikë, duke hequr zvarë këmbën e majtë, e cila nuk i thyhej në gju. Dorën e djathtë, si e kishte zakon, e mbante në xhepin e pantallonave, kurse në buzët e holla të zgjatura po fërshëllente, me një shushurimë, që sa po ndihej, melodinë e një këngë të re italiane.

Qëndroi në mes të sallës, hodhi një vështrim mbi të gjitha punëtoret dhe foli me atë zërin e tij të çjerrë.

— Siç ju paralajmërova, dita sot... Të mos kemi llafe... Ti, ti, ti... dhe ti, Vanë... Dëgjuat? Sonte do t'i lajmë hesapet.

Vanës iu duk sikur i ranë me thikë. Por i mblodhi fuqitë dhe iu drejtua afendikoit, kur ai po matej të ikte.

— Zoti Hajro, po na hedh në mes të katër rrugëve! Nga t'ia mbajmë?!

Ai vështroi gruan me sytë e tij të gjelbër, ngriti supet dhe u zgërdhi.

— Jua thashë me kohë! S'kam se ç'bëj! S'më vjen mirë, por... forca maxhore...

Dhe afendikoi u largua, duke zvarritur këmbën e me njëren dorë në xhep.

Vana me shoqet dolën në rrugën e ftohtë. Kalldrëmi kishte zënë një cipë të hollë akulli. Shkurti ishte me ngrica atomditët e para.

Afër fabrikës ato hasën një patrullë karabinierësh, të cilët i vështruan me vëmendje dhe i ndoqën me sy gjersa kaluan qoshen.

— Qeni! Na hodhi si plehrat! — tha njëra.

Tjetra iu kthye Vanës:

— Si të tha në mëngjes? «S'më vjen mirë... forca maxhore...

Vanës iu kujtuan fjalët që i pat thënë i shoqi: «Është një dhëlpër ai... Na shtrydhin mirë e mirë, pastaj na flakin në të katër udhët».

— Me djersën tonë i ka vënë të gjitha, — foli përsëri gruaja e parë.

— Me gjakun tonë, thuaj më mirë, — iu përgjigj Vana.

Dhe përsëri ajo kujtoi të shoqin, shqetësimet e ditëve pa punë, mundimet e tij për të nxjerrë kafshatën e gojës, demonstratën e bukës që ishte bërë në qytet, xhandarët, burgosjén dhe sfilitjet e burrit... vdekjen, që i erdhi mbas pak kohe, nga ato që kishte hequr...

Vana hyri në shtëpi me një buçimë në kokë. Ajo nuk e vuri re Dritën, që bashkë me të dy fëmijët ishte ulur në një anë të minderit.

— Vanë, si u ngryse? — i foli ajo.

— O! S'të pashë fare. S'e kisha mendjen...

— tha Vana mbasi u përqëndrua, dhe, sytë e saj të zinj e të mëdhenj u kthjelluan, kur pa vajzën.

— Ç'ke kështu? Sikur s'je mirë...

Vana i tregoi kushërirës hallin e saj. Drita mblođhi vetullat gështenjë dhe heshti.

— Mbaje veten, — i dha zemër Drita, duke parë fytyrën e Vanës të rrudhur nga hidhërimi.

— Nuk do të vdesësh, jo! Njëri për tjetrin jemi.

— Pastaj u mëshoi më fort fjalëve: I poshtri! Prej njerëzve si ai çdo gjë mund të presësh...

Fëmijët po hapnin sytë si të hutuar. Drita e hoqi Vanën në sobën tjetër të shtëpisë.

Gruaja ndjeu se vajza kishte diçka për t'i thënë. Kohët e fundit Drita kishte zënë t'i vinte më shpesh në shtëpi.

— Po nxitoj, Vanë, se po aftron ora e ndalim-qarkullimit. Erdha të të them një gjë. E di që do të më kuptosh. Kam besim se do ta mbarosh këtë punë...

— Fol! Çfarë punë?... — pyeti ajo kureshtare.

— Kemi një shok... Një nga shokët tanë, — theksoi vajza. — Atë e ndjekin. Ne duhet ta ruajmë. Në shtëpinë ku ka ndenjur gjer tani kanë zënë të vërtiten grerat.¹⁾ Nuk ka siguri. Menduam ta sjellim këtu. Ti nuk ke shumë hyrje-dalje.

— S'kam fare pothua... — e ndërpree Vana.

— Shtëpia është mënjanë, mendja s'u vete... Si thua?

Vana pohoi me kokë.

— Të kuptoj, — i tha Dritës. — Le të vijë...

1) Kështu ishin mbiquajtur spiunët e fashizmit.

Vajza i hodhi krahun:

— Atij i pëlqen të vijë në shtëpinë tënde. Kanë qenë bashkë në shogërinë e punëtorëve. Më ka folur për të.

Fytyra e hequr e Vanës u gjallërua. Tiparet e saj të rregullta sikur lëvizën. Ajo pshëretiu dhe pyeti:

— Kush është?

— Do ta marrësh vesh. — Dhe Drita e ktheu bisedën gjetkë. — Shtëpia jote ka disa anë të mira. Në rast nevoje mund të kapërcessh nga një avlli në tjetrën dhe të dalësh tutje.

— Po.

— Duhet të çlirohemi nga fashistët dhe nga Hajrot. Mjaft na shtypën!

Sytë ngjyrë lajthie të Dritës kundronin fptyren e menduar të gruas.

— U vonova... — tha vajza dhe u ngrit. — Duhet kujdes, Vanë, e kuption. Të mos dyshoje njeri... Vjollcën do ta marr ca kohë nga ne; është e vogël, dhe kushedi... Ajo vjen me mua.

— Të ngjitet shumë.

— Ili është ndryshe...

— Atij nuk ia kam frikën, — miratoi gruaja. — Ai nuk nxjerr fjalë jashtë.

Drita e puthi Vanën dhe iku me nxitim.

2

Gjatë ditës Vana bëri rregullime në sobën ku do të priste njeriun që do t'i sillte Drita. Vajti bleu ca sheqer e pak kafe të bluar, të cilën e për-

zieu me elb tē pjekur. U mundua tē përfytyronte atë që do tē vinte. Kujtoi tē gjithë shokët e tē shoqit. Kush tē ishte vallë? Jo kushdo, por një njeri me rëndësi, tē cilin e ndiqte qeveria.

Si vështroi që sobën e kishte pastruar e rregulluar mirë, me tē zënë dita tē thyhej, ajo doli në oborrin e shtëpisë. I ishte dukur se kishin trokitur, por jo, nuk kishte njeri. Hyri përsëri në sobë. U ul dhe mori tē arnonte por pas pak u ngrit, sheshoi me dorë edhe një herë minderin, mbi tē cilin kishte shtruar një batanije tē pastër, vështroi përsëri se mos kishte mbetur ndonjë gjë në dyshemë dhe filloi t'i përgatiste diçka djalit pér tē ngrënë, që pastaj ai tē flinte më shpejt.

Djali ra pér tē fjetur. Çdo gjë në shtëpi e mbuloi qetësia. Dëgjoheshin vetëm sheshlat e Vanës, tē cilat ajo i hiqte zvarrë.

Doli te porta. Qielli ishte i përhimë. Dëbora, që ditën kishte shkrirë aty-këtu, tani kishte marrë përsëri tē ngrirë. Vana pa një burrë tē shkurtër, që vinte nga ana e poshtme, me duart në xhepat e palltos së vjetër dhe me një shapkë tē rrasur gjer te veshët. Ishte Llambi, këpucari, që e kishte shtëpinë më lart. Kur kaloi përpara Vanës, ai e përshtëndeti shkurt dhe iku me kokën tē futur në supe.

Kaluan minuta tē tëra që ajo po priste dhe ndiente zemrën që po i rrihte fort. Njeri nuk po dukej. Ktheu kokën poshtë e lart rrugicës. Askush. Një tis mjegulle po zbriste tani në rrugicën, që nga malet mbi qytetin. Qetësia e ftohtë, zbrazësira e bardhë, sikur e shqetësuant dhe e trembën Vanën. Dyshoi pér ardhjen e tyre. T'u kishte ndodhur gjë? Një zbrazësirë ishte krijuar përbrenda saj.

Pas pak, kjo i kaloi. Ajo mendoi se kishte kohë ende gjer te ndalimqarkullimi.

Ndërsa po vështronte drejt rrugës kryesore të qytetit, nga sipër i erdhi në vesh kërcitja e dëborës. Ktheu kokën me kërshëri e tronditje. Në qoshe, jo shumë larg, u duk një vajzë me një shall të bardhë në kokë. Vana nuk e njoihu në fillim. Vetëm palltoja e kaltër e vajzës i dha të kuptonte se cila ishte. Drita i bëri shenjë që të hynte brenda. Gruaja u hutua dhe nuk lëvizi. Nga qoshja doli një burrë me pallto kafe, me jakë të ngritur, me borsalinë dhe syze të zeza. Duart i kishte në xhepa. Vajza i bëri përsëri shenjë Vanës, e cila kësaj radhe hyri në oborr dhe kanatin e portës e la të hapur. Pas saj hynë Drita dhe ai. Drita e shtyu portën dhe i vuri hekurin.

— Mirëmbrëma, — foli ai me një zë të trashë.

— Mirëmbrëma, — tha shpejt e shpejt Vana dhe u priu. — Urdhëroni.

Hynë në tremen e ngushtë, pastaj kaluan në sobë.

Vana trazoi zjarrin e vatrës, rregulloi drutë që të merrnin flakë dhe tha:

— E kam ca të ftohtë sobën. Është nga veriu. Nuk ngrohet kollaj... Veç kjo dritare e jugut xheku sjell një afsh të ngrohtë... Po na bën kiomet!... Dimér i hidhur... Urdhëroni! Afrohuni te zjarri, — iu drejtua mikut.

Ky kishte hequr syzet, kapelën dhe pallton. Vana kundroi mirë fytyrën e tij me nofulla të mëdha, ballin e lartë, flokët e rrallë e të lëpirë, që po i rregullonte me dorë, hundën e tij të drejtë dhe ata sy gështenjë, që po qeshnin.

— Aa! nuk e kemi kështu, — foli ai. — Ne jemi të rrogozit... E? Si thua, Dritë? — iu kthyesh vajzës.

Kjo buzëqeshi. Fjalët e tij i pëlqyen Vanës. Asaj i kishte shkuar mendja se kushedi me cilin do të kishte të bënte. Ndofta ndonjëri nuk do të gjente rehatin dhe shërbimin e duhur në shtëpinë e saj, por ajo po shikonte se ky nuk ishte sqimatar. Ai ishte ulur pranë zjarrit, sikur të ishte në shtëpinë e tij.

— Vërtet, ca i egër ky dimri sivjet, — miratoi fjalët që kishte thënë Vana. Pastaj vazhdoi: — Kështu ka qenë dhe gjashtë vjet të shkuar. A të kujtohet?

Vanës i ra e papritur kjo. Përse ia kujtonte atë dimër? Vetvetishëm tha:

— Ka bërë, ka bërë edhe tjetër herë kështu ftohtë...:

— Nuk të bie ndër mend?

— Çfarë?

— Më paske harruar...

— Si?!

Atij i qeshën sytë përsëri.

— Nuk e kam të parën herë që po hyj në këtë shtëpi...

Vana mblodhi vetullat kalem, sikur po mblidhët tërë kujtimet e saj dhe filloi të hetonte çdo tipar të burrit që kishte përpara. Tjetri e kuptoi se ajo ishte shqetësuar për atë që nuk po zbulonë dot. Ndaj, me buzë në gaz, i tha:

— Ke të drejtë: erdha e ika si një hije. Nuk ndenja gjatë. Ti pak qëndrove me ne, sa na nxore rakinë dhe na poqe kafenë. Ka qenë pikërisht si tani, muaji shkurt. Kam ardhur një natë me Tenin, disa ditë përpara demonstratës... Kur u ngrita

për të iku, ngulmove që të rrija për darkë, por unë kisha punë.

Vanës diçka po i kujtohej. Ishte dimër... Binte dëborë e imtë dhe frynte... Teni kishte ardhur... me një njeri... Po, Po, ai kishte këto tipe... Vëç, vëç të këtij janë më të regjura.... Koha i kishte ndryshuar...

— ..., Në demonstratë ishim krah për krah me Tenin, kur na sulmuau xhandarët. Por na e paguan shtrenjtë qenat! I shkelëm me këmbë!

Vana po vërente vragën e një plage të vjetër, që zbriste nga cepi i majtë i gojës së tij, gjer poshtë nofullës.

— ... Që atëherë nuk e pashë më Tenin. Më dënuan tre vjet burg. Dola si theu qafën Zogu. Hallet e jetës më hodhën andej-këndeje... Tani, lufta...

— Lufta... — murmuriti Vana, e kredhur në kujtimet, mbresat dhe brengat e saj.

— Kjo është luftë e madhe, që s'e ka bërë ndonjëherë populli ynë. Dhe këtë luftë ne do ta fitojmë, se kemi Partinë.

Vana po dëgjonte, po i thithë ato fjalë, që dilnin të matura e kumbuese nga goja e mikut.

— Kaluan në bisedë tjeter.

— Drita më tregoi se Hajroja të pushoi nga puna...

— Po, — shqiptoi me një fije zëri ajo.

— Hajroja dhe shokët e tij janë bërë ortakë të fashizmit, ijanë veglat e tij.

Ai heshtë dhe vështrimi i mbeti një çast në fotografinë, mbi mur. Në të njohu Tenin. Mendoi se nuk duhej të kishte dalë shumë vjet përpara demonstratës. Në krahun e tij ishte Vana, e fres-

kët, e pashme, me faqe të mbushura. Tani ajo kishte ndryshuar shumë. Rreth të dyzetave duhej të ishte, por e plakur. Hallet kishin qenë më të forta se vitet.

Vana u ngrit të shtronte darkën. Shtroi mbi tryezë një sofrabez të vjetër, por të pastër, pastaj solli pjatat dhe gotat e ujtit.

Kur po hanin, mikut i vajtën sytë te dritarja nga jugu.

- Dritarja që bie nga fqinjët? — pyeti ai.
- Po, — u përgjigji Vana.
- Këtej mundet... — tha Drita.
- Janë njerëz të mirë, — pohoi Vana. — Mihali punon furrxhi. Njerëz të këputur. Prej tyre s'kemi 'frikë. Po ta dojë puna, avllia e tyre është e ulët, hidhesh e del në rrugën matanë, te përroi...

3

— Besim, — i foli Vana burrit, që po rrinte i mbështetur te minderi, — po vjen Drita.

Vajza hyri me hap të nxituar.

- Shpëtuam mirë mbrëmë, — tha ajo.
- Pse? — pyeti ai.

— Sapo kishim ikur ne nga shtëpia, vajtën karabinierët. S'lanë vend pa kontrolluar e pa përblysur. Si nuk gjetën gjë, morën me vete xha Lipen. E pyetën, e shtrënguan. «Ti, shtrig, mban komunistë në shtëpi!», iu hakërruan. «Ku di unë nga këto gjëra! — u thoshte xha Lipja. — Jam plak njeri, kam vajtur në mykët. Lërmëni me hallet që kam». Gjer në të gdhirë e munduan, e kërcënuan. Por xha Lipja në të tijat. Panë ç'panë, e lëshuan duke i bërtitur: «Thyej qafën! Po të

shtiem edhe një herë në dorë, ta dish se lëkurën do të të rrjepim! «Xha Lipja teshtiu një herë kinse, siç bën ai, dhe ia mbathi.

Besimi buzëqeshi, duke kujtuar xha Lipen dhe bëmat e tij hokatare! Pastaj u kthyeshi nga Vana.

— Paskemi shpëtuar me kulaç pas brezi! Nga ti e kemi.

Vana doli. Besimi dhe Drita folën për punët e ditës.

— U shtyp thirrja? — pyeti ai.

Vajza i dha një kopje të traktit.

Ai e mori, i hodhi një sy dhe tha:

— Thirre Vanën.

Si hyri gruaja në sobë, Besimi filloi të lexonte me zë traktin. Ishte një thirrje e Partisë Komuniste.

Duke dëgjuar, Dritës i vente mendja te mbledhja e pasditës, te letra dhe boja, që duheshin siguruar për të nesërmen... Kurse Vana, sy e veshë i kishte mbërthyer te buzet e burrit dhe tundte kokën lehtë. Ajo sikur po i thoshte: «Mirë e ke, bukur po lexon». Dhe në mendje bluante ç'i kishë të thënë dikur i shoqi për një Parti, për «mëmën e punëtorëve dhe të fshatarëve». Kjo Parti do t'i shpëtonte, do t'i çlironte, do t'u jepte bukën, do t'u hapte sytë... Parti Komuniste e kishte quajtur.

Dhe Besimi përfundoi me këto fjalë: *Ndaj na duhet Partia Komuniste...*

Pastaj ai pyeti:

— Ç'thua, Vanë? Partia na bën thirrje të luftojmë, se kështu do të çlirohemë.

— Këto më thoshte edhe ai... — foli mendueshmëri gruaja. — Ai shpresonte se do të ndryshohej bota...

— Do të ndryshohet, po! — theksoi Besimi.

— Si do të bëhet?

— Fashistët do t'i shporrim! Bejlerët dhe afendikonjtë nuk do t'i lëmë të na pinë gjakun...

— Kush nuk do t'i lërë?

— Ne, populli. Qeveria do të jetë e popullit, jo e atyre shushunjave, siç ka qenë gjer tanë.

Vana po e shikonte pa folur. Ato fjalë i pëlqenin, por i dukeshin ëndërr...

...Ora kaloi nga njëshi, dhe Besimi u ngrit për të dalë. Mbledhjen e kishte më dy; shtëpia ndodhej në cepin e qytetit, rrëzë kodrës. Veshi pallton, revolverit i futi fishekun në gojë dhe preku me dorë granatën që kishte në xhepin e majtë. Pastaj vuri borsalinën dhe syzet. Drita ishte gati. Doli te porta, vështroi poshtë e lart dhe, kur pa se nuk kishte njeri, i bëri me kokë Besimit që të nisej pas saj. Që nga pragu i tremes Vana i ndoqi ata me një shqetësim të lehtë në zemër. Ajo nxiti drejt portës, u sigurua që ishin larguar, mbylli kanatin dhe u kthyte në sobë, ku i biri po bënte detyrat e shkollës. I shpjegoi djalit se do të shkon te gjer në shtëpinë e tregtarit për të marrë përgjigjen nëse do ta pranonin si shërbyese apo jo. Ajo hodhi shallin në kokë dhe i tha se nuk do të vonohej.

Përshkoi rrugicën e saj me hapa të shpejtë, arriti në sheshin e qytetit dhe, kur po matej të kapërcente rrugën e madhe, i doli përballë zoti Hajro.

— E paske marrë me yrysh, moj Vanë! — ngërdheshi buzët ai.
Vana e pa vëngër.

— Po nxitoj pér bukën e fëmijëve, — i foli ajo me urrejtje. — Zotrote na le gisht...

— Hi, hi, hi! — qeshi dhe u shëmtua më keq zoti Hajro.

Vana deshi ta pështynte në fytyrë, por ai u largua duke hequr zvarrë këmbën e thatë.

Gruaja shtrëngoi shallin nën mjekër, u fut në rrugën e shtëpisë së tregtarit dhe arriti përparrë portës së saj. Si trokiti, një vajzë shtatmesatare, me dylbenë të bardhë në kokë, me një palë sy laruashë, hapi portën dhe pyeti:

— Si e ke punën?

— Ka njeri?.

— Cilin kërkon?.

— Zonjën... .

— Nuk është.

— Kush ndodhet brenda?

— Vetëm çupa e madhe.

Vajza po shikonte si e mërzitur, sikur don-te t'i thoshte: «Ke gjë tjetër apo ta mbyll portën? Se kam punë».

— Ti këtu je?... — i tha Vana e menduar.

— Këtu.

— Të kanë pajtuar?.

— Po.

— Që kur?.

— Dy ditë kam... .

Vana heshti. E mori vesh se ku kishte përfunduar kërkesa e saj.

— Mirë, — foli ajo dhe u nis.

— T'i them gjë zonjës? — pyeti vajza.

— S'është nevoja, — iu përgjigj Vana.)

Orët e pasditës iu dukën shumë të gjata e të rënda. Ajo shikonte djalin dhe ndiente dhembje. Lehtësohej disi; kur mendonte se e bija po kalonte mirë në shtëpinë e Dritës. Megjithatë thoshte me vete: «Ua bëra bela. Se mos ia kanë vaktin dhe ata... I ati një copë marangoz është. I vëllai, sot me punë, nesër e pushojnë. Ajo po nuk punon...». Si do t'ia bënte hallit më vonë? Në shtëpinë e tregtarit nuk doli gjë. Edhe tregtarët e tjerë kërkonin të merrnin vajza të reja...

Po ngrysej. Gruaja mendoi se Besimi dhe Drita duhej të kthehet. Ajo doli te porta dhe qëndroi në pritje. Nja dy vetë po zbrithin, një po ngjitej. Moti ishte i kthjellët dhe i ftohtë. Vana u mbështet pas portës së brejtur nga koha dhe krimbi. Në qoshen e sipërme u duk një grua e shkurtër, trashaluqe, me një tepsi në duar.

— Ç'paske bërë kështu, moj Dhonë? — e pyeti Vana, kur ajo u afrua.

— Një pispili, të mbledh fëmijët... S'kisha me se ta piqja. E shpura në furrë. Ti, ç'bëhesh? S'të kam parë. Ja, erdha, sa të fut tepsinë... — tha gruaja dhe hyri në shtëpinë fqinje. Pas pak ajo doli duke lidhur në majë të kokës dy cepat e shamisë.

— Po ku ke qenë, moj? — i tha Vanës. — Si nuk je dukur?

— S'kam pasur mend në kokë... ti e di... — u përgjigj tjetra.

— Ç'bëre?

— Asgjë.

— Oi! Ta qajmë hallin. Jemi në kohë të ze-

za, moj motër! Gdhihem e ngrysemi dhe themi:
Si do t'ia bëjmë?... — Dhona pa rrëth e rrrotull dhe
uli zërin: — Të kanë hedhur nga ato?

— Çfarë?

— Nga ato letrat... si u thonë... komunikata...
— Jo.

— Neve na hodhën të premtën dhe dje. I gjeta
në oborr. Ndaj të ngrysur, se përse kisha vajtur në
ashev, kur më zuri syri një fletë. C'të jetë kjo,
mendova. Ia shpura Mistos, brenda. Ai, sapo e pa,
e kuptoi. E fshiu, se ishte lagur ca nga dëbora dhe
ma këndoi. Dje gjeta një me dy fletë. Kur e mora,
se si më erdhi. M'u kujtuan ato fjalët që më kishte
kënduar më parë Mistojë. *Mos ia dorëzo armikut*,
dhe m'u duk sikur më përgjonte ndonjë nga ata
turizintë. Isha prapa portës. E shtyva atë, që të
sigurohesha. Porta ishte e myllur. I vura hekurin.
Komunikatën e futa në gji që t'ia jepja Mistos, se
më ka porositur t'ia ruajt.

Dhona po fliste me gjysmë zëri, por shkoqur.
Sytë e errët i lëviznin si dy sovajka dhe e tregonin
grua të shkathët, ndonëse i kishte mbushur të pesë-
dhjetat.

Ajo vazhdoi:

— Kanë dalë djëmtë malit... Do të bëhet
luftë e madhe.

— Do të bëhet... Në luftë jemi... — pohoi
Vana.

— More vesh gjë?

— Çfarë?

— Djalin e Sofisë, e di ti, të asaj, moj, që ka
ndenjur aty sipër, në shtëpinë e Perovicës... So-
fia, de, e Rrapit...

— Po, po, — tha Vana. — E di. Si u bë?

- Djalin e saj, atë të mesmin, ia morën një-ditëzaj në burg.
- Ç'thua, moj?!
- Por iku që atë natë nga çatia dhe nuk e zunë dot. Shkoi malit.
- Popullit i ka ardhur shpirti në majë të hundës... — theksoi Vana.
- Dy gra të tjera, njëra e moshuar, tjetra e re, duke ardhur së poshtmi, u ndalën. Fytyrat e tyre tregonin se diçka u kishte ndodhur. Plaka dukej më e shqetësuar.
- Ç'keni kështu?! — i pyeti Dhona.
- Na rrethuan atje, në pazar...
- Kush, moj Nastë?
- Ata, flamëmëdhenjtë!
- Pse?
- Kush u nxori sytë!... Rrethuan gjysmën e pazarit. Se kë ndiqnin. Popo zunë të shtinin... Njerëzia s'dinin nga t'ia mbanin. Ne të dyja deshëm të futeshim në një dyqan. Mirëpo, do ti, ai maskarai, që shet manifaturë atje në pazarin e pulave, s'na qasi brenda! Unji qepenat dhe na thirri: Jo, jo, mos hyni! S'kam ndër mend të gjej belanë për ju!, dhe na shtyu. Yt, qërohu, i pacipë, ia ktheva unë. S'ke turp të turpërohesh! Dy gra jemi, dhe na lë jashtë! Ai mbylli qepenat mirë e mirë dhe u klyçit. Nga të venim? Unë e humba. Po kjo e mblo-dhi mendjen, — tha Nasta, duke treguar me kokë shoqen e saj, që ishte rreth të tridhjetepesave, me fytyrë lëkurëbutë e të pastër, me flokë të pilluar e të ndarë në mes, veshur me një pallto ngjyrë bari.
- E hoqa Nastën, — foli gruaja e re, — dhe hymë në një berberhanë. Qëndruam atje gjersau prish rrethimi.

— Morët vesh gjë? — pyeti Dhona.

— I kishin rënë pas një komunisti, thoshin. Më shumë nuk morëm vesh...

Vanës i shkoi mendja te Besimi dhe te Drita. Po bëhej vonë. Ata duhej të ktheheteshin. Cili të ishte ai që ndiqnin? — u shqetësua gruaja.

Ajo nuk deshi që gratë të vinin gre shqetësimin e saj.

— U sftoh shumë! — tha dhe shtrëngoi shallin krahëve. — Vajti ora... A futemi brenda, mos na dalë ndonjë karabinier.

Gratë u ndanë.

Vana hyri në oborrin e saj, por portën e la gjysmë të hapur. Mendjen e kishte tek ata. Fjalët e grave po i ndillnin dyshime. Filloi të vërtitej nëpër oborr, duke mbajtur vesh për lëvizjet në rrugë. Por nuk ndihej gjë. Qetësia sikur po ia ndrydhtë shpirtin. U dëgjuan këmbë. Dikush po vraponte. Të ishin ata? Jo. Këmbët kaluan me shpejtësi para portës dhe u tretën tutje. Vanës iu shtua shqetësimi. U afrua te porta dhe nxori kryet jashtë. Asnjeri. Ajo mendoi se ishte më mirë të largohej. E shtyu përsëri kanatin e portës.

Sapo kishte hedhur tre hapa, dëgjoi një kërcëllimë dhe u kthye vrullthi. Ndjeu një drithërimë që i kaloi nëpër trup. Ishin ata, Besimi dhe Drita.

— Ç'u bëtë? Më shtitë në merak, — u foli ajo me një farë qortimi.

Besimi buzëqeshi dhe i vuri dorën mbi sup.

— Nuk ka gjë, — tha ai me zërin e tij të trashë, në të cilin kishte diçka bindëse e qetësuese. — Fashistët na kyçin që me pulat, nuk na lënë kohë të mbarojmë punë... Kështu që nuk do t'i lemë të na hanë asnjë minutë nga ajo që na takon. Të tje-

rat do t'ua shkruajmë në defterin e hesapeve, që kemi me ta...

Vana mori frymë thellë.

— U bëra merak, se më treguan që në pazar ndiqnin një komunist...

— Kush të tha? — pyeti vajza.

— Dy gra që kishin qenë atje.

Besimi dhe Drita u panë sy ndër sy.

... Ndofta s'është gjë... Fashistëve u ka hyrë lepuri në bark dhe kanë frikë edhe nga hija e tyre... Sidoqoftë, duhet parë... — iu drejtua ai vajzës.

— Po shkoj... — u përgjigj Drita.

— Prit, moj çupë, të marrësh një të ngrohtë...

— u hodh Vana. — Afrohu te zjarri, — i foli ajo Besimit. — Hiqi këpucët dhe theki këmbët. Do t'i kesh qulli, më duket...

— S'kam ngrirë, jo, — kundërshtoi ai.

— Po, po, e shikoj nga hunda, që të është bërë spec i kuq... — ia priti ajo.

— Oj, na paskan tradhtuar hundët! — qeshi Besimi.

Kur Drita u largua, ai u zbath dhe u sheshua te minderi, pranë gllanikut.

Ai e pyeti Vanën nëse kishte vajtur në shtëpinë e tregtarit. Ajo i shpjegoi si qëndronte puna.

... Doemos... — foli ai nëpër dhëmbë. — Marrin vajza të reja... Kur u moshohen ato, i zë-vendësojnë me të tjera...

— Të kanë në dorë dhe bëjnë si u do qejfi... Kur të jetë qeveria e popullit, siç thua ti dhe siç më thoshte im shoq... atëherë do të na qeshë buza...

— Po, Vanë, atëherë do të na mbarojnë hallet, — theksoi ai.

Pas një pushimi, gruaja shtoi:

— Pa le, më doli përpara dhe ai, këmbëthari, Hajroja. Deshi të bënte hallatkë. Por ia preva shkurt. Më erdhi t'i hidhja një gëlbazë në surrat...

— Është shumë i poshtër, — tha Besimi. — Është lidhur këmbë e kokë me federalin; është bërë spiun.

4

Drita ishte një ndërlidhëse e përditshme e Besimit. Merrte porositë e tij, i shpinte aty ku duhej, kthente përgjigjet, conte dorëshkrimet në teknikë, sillte kopje të buletineve, trakteve dhe shtypshkrimeve të tjera. Printe në rrugë, kur ai shkonte në mbledhje e kthehej në bazë. Detyra e vajzës ishte e rëndësishme dhe e vështirë. Vana e shikonte dhe e kuptonte se me sa saktësi, guxim e shkathtësi e kryente ajo këtë detyrë. Ndaj, tanë e adhuronte edhe më shumë. Guximi i vajzës i jepte edhe kësaj guxim. Puna e saj e nxiste të bënte diçka, se i dukej sikur po rrinte e po bënte sehir të tjerët. Ajo e kërkoi dhe e gjeti rastin që të mos qëndronte duarkryq, po që të jepte edhe ajo ndihmën e saj në punën e atyre.

Një pasdite, kur Drita solli buletinin, ajo iu drejtua Besimit:

— Më thoshte Dhona se këto ditë nuk kanë hedhur komunikata në rrugën tonë, siç kanë hedhur në rrugët e tjera.

Besimi rrudhi ballin.

— Ka të drejtë, — foli ai i menduar. Pastaj, sikur lidhi fillin e një bisede të mëparshme, iu kthyesh

Dritës: — Nuk duhet lënë as kjo copë rrugë. Fjala e Partisë, jehona e luftës duhet të përhapen kudo. Drita nuk foli.

Fjalët e tij dhe heshtja e saj e vunë në mendime Vanën. «Ndofta ata ruhen të lëvizin kësaj ane, që të mos bjerë në shtëpi. . .»

— Fqinjët duan të dinë çfarë shkruajnë traktet... — shpjegoi gruaja.

Besimi e vështroi një copë herë, sikur po zbulonte diçka të re në sytë e saj.

— Dinë të lexojnë të gjitha? — pyeti ai.

— Jo, po i lexojmë bashkë. Edhe unë mund t'ua lexoj....

Besimi përsëri u mendua, pastaj i tha Dritës:

— S'e ka keq Vana... Sill dy - tri kopje nga çdo buletin. Ua lexon e ua shpërndan vetë kjo.

— Posi, e bëj unë këtë punë! — i ndriti ftyra Vanës.

... Buletinin e parë, që solli të nesërmen vajza, Vana ia shpuri dhe ia lexi Dhonës. Kur erdhi Gaqi, e lexi edhe ai. Pastaj Dhona e futi letrën në gji dhe ia shpuri Pavlinës. Kjo punë u bë e përditishme. Në qoftë se shkonte vonë e vinte koha e ndalimit të qarkullimit, apo kur në rrugë kishte ndonjë lëvizje të dyshimtë, Vana, mbasi e lexonte buletinin, mbështillte në të një gur dhe, përmbi avllinë që i ndante, ia hidhte Dhonës në oborr. Fqinja, që ishte në përgjim, e merrte, e lexonte dhe me të njëjtën mënyrë ia kalonte fqinjës tjetër. Herë-herë, në shtëpinë e Dhonës ose në atë të Pavlinës, Vana dhe shoqet e saj mblidheshin e bisedon pér ato që flisnin buletinet ose pér ngjarjet e ditës në qytet.

Një mbrëmje Besimi i tha Vanës se do t'i vinin dy shokë. Tashmë ajo ishte mësuar me këta miq, që vinin e takoheshin me Besimin. Zakonisht ata nuk qëndronin gjatë, por kishte qëlluar edhe ta kalonin natën me të. Vana ruante dhe i priste te porta. Në qoftë se ndodhte të vinin papritur, trokitnin me dorezën e portës: një trokitje e gjatë dhe tri të shkurtra të njëpasnjëshme, që ata që ishin në shtëpi të kuptonin se kishin të bënин me shokë.

Tani Vana po qëndronte në oborr. Asaj ia kishte ënda të thithte ajrin e pastër pranveror të mbrëmjes. Kishte hyrë prilli. Moti kishte ndryshuar prej disa ditësh. Një jugë e kishte shkrirë gjithë dëborën. Ngrohtësia, që kishte ardhur menjëherë, po përtérinte natyrën. Në lehet, gjatë mureve të oborrit, kishin nxjerrë krye agulicet dhe manushaqet. Kumbulla, molla dhe trëndafili kishin lëshuar sythë.

Teksa mendja e gruas po hidhej tek e bija, të cilën nuk e kishte parë këto ditë, u hap porta dhe hyri Drita me dy shokë. Njëri ishte i gjatë, shpatullgjerë, me mollëzat e faqeve pak të hedhura, me shapkë në kokë. Moshari tij ishte rrëth të tri-dhjetave. Tjetri, më i ri, nën të njëzetepesat, me sy të kaltër e flokë të verdhë. Ata hynë në dhomën e Besimit dhe u ulën rrëth tryezës me të.

Drita bisedoi me Besimin, i dorëzoi buletinin, i dha edhe një Vanës, pastaj u nis me nxitim. Si lexoi komunikatën e ditës, Vana ia hodhi atë fqnjës, e cila po priste rrëzë murit.

— Ma vonove sonte, — i foli Dhona që matanë.

— Tani ma sollën...

— Dëgjo, — pëshpëriti tjetra, — më tha Gaqi se në pazar kishin dalë shumë karabinierë. Rrugës kishte parë edhe shumë nga ata policët me rroba të zeza.... Ç'do të jetë?...

— Kushedi..., Ndofta bastisin gjëkundi...

— ~~Dofta~~...

— Ç'do të presësh prej tyre

= Hëngshin kështet Natën e mirët

Vana hyri në sobë dha filloj të përgatiste darkën për Besimin dhe shokët.

Në këtë kohë Drita po nxitonte për në shtëpi. Ishte vonë, Për disa minuta qarkullimi ndalohej, dhe shtëpia mbante që andej 15 minuta. Prandaj vendosi të merrte rrugët e mënjanuara, ku patrullat nuk para vozitnin. Bëri përpjetë, në një rrugë të pjerrët me kalldrëm, e cila në krye mbaronte me shkallare. Asgjë nuk lëvizte këtej. Të gjitha shtëpitë sikur kishin rënë në gjumë. Vajza u dha këmbëve, ktheu majtas dhe hyri në një rrugë tjetër. Ajo gati po vravonte, por mundohej të shkelte sa më lehtë, që fronat e shkurtër të këpucëve të mos trokitnin fort mbi gurët e murmë. I dukej sikur rrugët, që zbrisnin thikë, po përhapnin larg zhurmën e këmbëve të saj. Ndaj mendoi të hiqte këpucët e t'i merrte në dorë dhe të ikte zbafhur. Por nuk e bëri këtë, që të mos vonohej, mbasi edhe pak rrugë i mbetej gjer në shtëpi.

Në këto caste, në rrugën poshtë, që bashkohej pingul me atë ku po shpejtonte vajza, ajo shqoi dy policë kuesture. E panë edhe ata.

— Ehi, sinjorina, fermi!¹⁾ — i thirrën.
Ajo bëri sikur nuk dëgjoi dhe nxitoi më shumë.
Ata morën rrugën paralele, dolën në qoshe,
njëri i ra bilbilit, tjetri vazhdoi të thërriste:
— Senti, non skapare!²⁾
Drita u zu ngushtë. Ata nuk ishin shumë larg
saj, mund ta arrinin. Mendoi t'u dredhonte. U kthyesh
prapa dhe, si humbi nga sytë e tyre, zbatësh këpu-
esë, i mënë dë dore dje vrapoi me së luqë kishte,
kart rrugës me shkallare. Njëri nga policët e ndo-
hi, tjetri shkot nepër rrugen paralele, me qellim që ta
flettonin. Vajza, mbasi njëj me vruaj shkallat u
kthyesh në drejtimin e parë të rrugës së saj, majtas,
dhe kaloi në shtegun që ishte mbi shtëpitë e fun-
dit, rrëzë kodrës mbi qytetin. Një hendek i thellë,
pa ujë, shtrihej gjatë shtegut. Vajza u hodh në
hendek dhe u zhduk nepër të. Policët e humbën
nga sytë. Drita arriti në shtëpi duke dihatur, hyri
në oborr, mbylli portën dhe u mbështet e tëra pas
saj. Ishte shumë e lodhur, por e qetë.

* * *

Vana u kishte dhënë darkën Besimit dhe shokëve, kishte vënë në gjumë Ilin dhe tanë po lante
ca tesha të saj e ca plaçkurina të huaja. Si i lau
në ashef, i ndeu në litarin e oborrit. Qielli ishte
plot yje dhe frynte një puhizë. Gjer në mëngjes
rrobat do të thaheshin mirë.

Në këto e sipër, dëgjoi si një zhurmë këmbësh
larg. «Janë korbat», mendoi ajo. «Nuk rrinë as ditën

1) Ej, zonjushë, qëndro! 2) Dëgjo, mos ik!

as natën, Kushedi cilës nënë venë e i marrin djalin...».

Ndihej ë lodhur, por nuk ra të flinte. Deshi të arnonte disa vjetërsira. Në sobën matanë as të tjerët nuk flinin. Në vesh i vinin pëshpëritjet e tyre. Duke nxjerrë nën minder sepetkën me plaçkat, gruas i shkoi ndër mend që t'i pyeste se mos kishin nevojë për gjë. Trokiti lehtë në derë dhe e hapi me druajtje. Besimi i buzëqeshi dhe tundi kokën në shenjë mohimi.

Ajo u kthyte dhe vazhdoi të arnonte. Ora do t'i kishite kaluar të njëmbëdhjetat. Nga rruga u dëgjuan shumë këmbë njerëzish dhe të trokitura këpucësh të rënda me gozhdë. Këpucët kërcitnin dhe gozhdët gjërvishtrin kalldrëmin. Dëgjoheshin zëra, të folura të turbullta.

Vana mbajti vesh. Ajo dyshoi. E la gjilpërën, fiku driten dhe iu afroa dritarës. Tani vozitjet në rrugë ndiheshin më mirë. Ata jashtë do të ishin ushtarakë... Bisedat e tyre vazhdonin. Vinte ndonjë rrokje nga fjalët, por nuk kuptohej gjë.

Gruaja nxitoi në sobën tjetër.

— Përparrë portës sonë ka njerëz; patrulla ose ushtarë... U dëgjohen këmbët e muhabetet. Po dal në oborr të marr vesh më mirë.

Ajo la sheshlat në tremë, hapi ngadalë derën e mesit dhe eci zbathur nëpër oborr.

— «Trak-truk, trak-truk», trokitin këmbët jashtë. Dikush u kollit. Një tjetër sikur dha urdhër.

Që tej erdhën ca goditje të forta e të dendura, thua se i binin portës së shtëpisë, që ishte në cepin kundruall rrugës. Sikur goditnin me tokmak. I ranë e i ranë, pastaj qëndruan. U dëgjua zëri i

rreptë i dikujt, që fliste italisht. Përsëri filluan goditjet në portë.

— Hapeni, hapeni!

— Kush është? — pyet nga brenda zëri i një burri.

— Karabinieria! Hape shpejt, kontroll!

Vana u kthyte me nxitim.

— Besim, karabinierët! Kanë vajtur për kontroll në shtëpinë e Llambit...

Drita e dhomës ishte shuar. Besimi dhe shokët u ngriten, rregulluan gjérat që kishin nëpër duar dhe bënë gati armët.

— Po të trokasin këtu, do të hidhemi në bash-tën e Mihalit, — i tha Besimi gruas.

— Do t'ju sjell shkallën e vogël, e kam në qilar.

Ajo hoqi shkorsën, që mbulonte dyshemenë dhe bëri të ngrinte qepenin e qilarit, që ishte përposhtë. Besimi ndezi çakmakun. Atëherë u dëgjuan të goditura të fuqishme me qyta pushkësh te porta e shtëpisë së tyre.

Për një çast të gjithë qëndruan pa lëvizur. Besimi foli pastaj:

— Ata janë. Shpejt, të kapërcejmë matanë!

Hidhuni ju! — iu drejtua shokëve.

Vana nxori shkallën fët e fët.

Besimi kaloi i fundit në kopshtin fqinj. Vana po u mbante shkallën, të cilën pastaj, ajo ua hodi mbi mur. Mbasi u sigurua që ata kishin kaluar, ajo mbylli dritaren, uli qepenin e qilarit dhe shtroi përsëri shkorsën.

Jashtë mënt po e çanin portën, bërtitnin dhe shanin. Nga soba tjetër djali po thërriste me lebeti:

— Nënë, nënë, ku je?

Vana hyri dhe ndezi dritën. Zemra i rrihte fort. Djali ishte ngritur ndenjur në minder, me sy të çakarritur, i zverdhur.

— Ç'është, nënë? Kush i bie kështu portës?

— Mos u tremb, s'është gjë! — deshi ta qetëson-te ajo. — Bjer ti, do të dal të shikoj unë.

Porta po tundej e tëra, gati të shkallmohej. Vana mblođhi veten, doli në oborr dhe thirri:

— Ç'bëhet?! Kush po na e shqyen portën?!

— Hape, moj, hape! — iu përgjigj me brit-më një zë i ngjirur.

Gruaja shkyçi portën, hoqi hekurin.

Karabinierët u derdhën në oborr me pushkë në duar.

— Pse s'e hap?! — iu kanos ai që e kishte zërin të ngjirur, dhe ngriti pushkën, sikur ta qëllonte në kokë.

— Tani dëgjuam; ishim në gjumë, mesi i natës është...

— Avanti¹⁾) — iu drejtua me rrëmbim një karabinier gruas.

— Ec! — foli zëngjiruri.

Vana lëvizi, duke i vështruar shtrembër e tërë millef.

Dera e tremes kishte mbetur e hapur. Ili ishte ngritur dhe po qëndronte atje zbathur, në të linjat. Ai dridhej.

— Hyr brenda, ëbir, se mos marrësh të ftohtë, — i tha e ëma. — Na llahtarisët, që, si t'ju them!... — u kthyesh ajo nga karabinierët. — Ç'është kjo, të vini në këtë orë në shtëpinë e një gruaje pa burrë,

1) Përpara!

merfëmijë tē vegjël?! Nuk i marr vesh këto punët tuaja!

— Staj xita!!) — ia preu ai, që kishte folur dhe më parë. U futën në tremë. Vana vuri re një marshall, që fliste në gjuhë tē huaj, burrë i shkurtër e i trashë, dhe tre karabinierë, njëri nga të cilët i përkthente fjalët nga italishtja në shqip.

Vana afroi djalin pranë vetes dhe e pushtoi me krahun e djathtë. I vogli po i shikonte karabinierët me sy tē zmadhuar.

— Kuanti sono kui? — pyeti marshalli.

— Sa vetë janë këtu? — përktheu tjetri.

— E la padrona di kaza?

— Ti je zonja e shtëpisë?

— Unë.

— Il suo marito dove e?

— Burrin ku e ke?

— Ka vdekur.

— Çe kualke straniero kui?

— A ke njeri tē huaj këtu?

— Jo.

— Diçe la verita?

— Thua tē vërtetën?

— Po:

— Su, al kontrollo!)²⁾ — u tha marshalli karabinierëve.

Ata filluan tē kontrollonin, tē rrëmonin e tē përbysnin çdo gjë. Marshalli nxori nga xhepi një elektrik dore. Dritën e fuqishme tē tij e hodhi në dollapët, nën tryezë e nën karrige, në çdo cep tē

1) Pusho!

2) Haj, kontrolloni!

errët. Kontrolluan edhe oxhaqet. Hipën mbi tryezë dhe hapën kapakun e tavanit, por nuk hynë brenda. Marshalli ia dha elektrikun karabinierit, që fliste shqip, që të shikonte ai brenda.

— Niente¹⁾, — dha zë nga tavani karabinieri.

Dolën në oborr dhe ndriçuan tërë anët e tij. Rrobat, që kishte nderë Vana, i flakën poshtë me majat e bajonetave të pushkëve. Gruas i erdhi t'u hidhej në grykë.

— Ç'bëni kështu? — u shfryu ajo.

— Va, va! Fa niente²⁾, — foli marshalli.

— Plasja ju preftë! — tha nëpër dhëmbë, ajo, duke mbledhur teshat e hedhura përdhe.

Ata hodhën drithë dhe në ulicën që ishte midis shtëpisë dhe avllisë fqinje.

Më në fund, pa thënë asnjë fjalë, ikën, duke lënë portën hapur.

Vana ziente e tëra përbrenda. Si mbylli dhe siguroi portën, ajo shfreu dufin e saj:

— Qelbësira!

Ili po qëndronte ende te dera e tremes.

— Bjer, bir i nënës, se u qëruan faqezinjë!

— i tha e ëma.

Djali u shtri në minder.

Vana po drejtohej për në sobën tjetër, kur dëgjoi një zë të mekur:

— Vanë! Vanë!

Dhona po thërriste që nga oborri i saj.

— Hë? — i bëri zë Vana.

— E këputën qafën?

— U kromosën!

1) Asgjë. 2) Ec, ec! S'prish punë.

— Si dole, moj? —
— Ç'pyet! më bënë lesh e li. Rrobot e lara m'i hodhën nga litari dhe m'i shkelën me këmbë.
— Hëngërshin kokën! — ngriti zërin Dhona dhe shtoi: — Të jenë syrgjynosur nga rruga jonë?
— Tatëpjetë morën.
— Këtej sipër ishin te Llambi, te Nasta, Pavllina... Gjena, si nuk erdhën te ne...
— Ku t'u shkrepet venë, — tha Vana. — Pa të shkojmë të blem se na lanë pa gjumë.
— Na e prishën terezinë, që u prishshin nga themelitë! Shko, moj motër, shko!...
Dhe ato u ndanë.

5

Të tre burrat biseduan gjerë e gjatë për kontrolllet. Ata arriten në përfundimin se këto nuk ishin të rastit. Nga të dhënët që kishin pasur, në Qarkor kishin qenë të mendimit se armiku do ta shtonte dhunën, do të bënte shumë arrestime. Prandaj kishin marrë disa masa sigurimi për teknikën e shtypit dhe për shokët.

Ata e gdhinë atë natë, duke biseduar për detyrat e reja.

Si ikën shokët, Besimi po priste Dritën me padurim. Por orët po kalonin e vajza nuk po dukej. Ai filloj të dyshonte se mos edhe asaj i kishte ndodhur gjë. Priti, por kur pa që u vonua shumë, thirri Vanën dhe i tha të hidhej gjer në shtëpinë e vajzës, të merrte vesh si qëndronte puna.

— Ika, — u përgjigj menjëherë gruaja dhe u nis. Rrugës ajo vuri re se qyteti ishte i shqetësuar.

Gratë po flisnin kokë më kokë nëpër qoshet, burrat ecnin të menduar. Aty-këtu i zuri veshi ndonjë fjalë për dikë, që e kishin marrë nga shtëpia natën, për **trazirat e vjedhjet që kishin bërë nëpër shtëpitë**. Ajo pa Nastën që po nxitonte.

— Për ku kështu? — e pyeti.

— Për tek ime motër, — iu përgjigj tjetra pa qëndruar. — Kam hall se mos i kanë marrë ndonjë djalë...

Vana nxitoi edhe ajo për të arritur salamë shpejt në shtëpinë e Dritës.

E ëma e vajzës, e kërrusur nga drobitja dhe nga përdhesi, që e kishte shtrënguar ato ditë, e priti Vanën gjakprishur:

— E morën çupën mbrëmë, që u shoftë fara e tyre dhe mos u mbettë nam e nishan!

— C'më thua?! — u trondit Vana.

— Ma morën në mes të natës. Kërkonin djalin. Ai nuk u ndodh... S'u lashë gjë pa thënë derël-myllurve, sa njëri më zuri si egërsirë dhe deshi të më merrte edhe mua. U përpoqa t'i shqitesha nga dora, dhe ai më dha një të shtyrë me tërë fuqinë e më përplasi pas murit. I shoftë mortja, i shoftë!

Vana ndjeu sikur diçka po i shtrëngonte fytin.

— Kanë marrë shumë vetë sonte, — tha. — Ku t'i kenë shpënë?

— Di dhe unë! — mblodhi supet tjetra. — Plaku shkoi, sapo u hap dita, për të marrë vesh gjë, por... s'po kthehet...

Vana e kishte humbur mendjen, ndaj nuk vu-ri re Vjollcën që po i thërriste:

— Mami! Mami!

— Bijë e mamit!

E mori në krahë vajzën dhe e mbushi me të puthura. Si e lëshoi nga dora, i tha:

— Do të vijë prapë mami. Do të të marr në shtëpi të shikosh Ilin. Mirë?

— Më ka marrë malli shumë për Ilin! — foli vajza.

E turbulluar dhe me mendje të ngritur, Vana e pa të bijën me ngashërim dhe iku.

Ajo i përshkoi me vrap rrugët, pa vështruar se kush kalonte e se ç'bëhej rreth e rrotull. Ajo nxitonte që të lajméronte sa më parë Besnikun.

Kur mori vesh se ç'kishte ndodhur, ky mbeti një copë herë i vrenjtur, me ballin, të rrudhur, me duart në xhepat e pantallonave. Pastaj e pyeti gruan:

— Do t'i shpiesh një letër Mitatit, atij shokut, që na ka ardhur dy herë këtu. Shtëpinë e ka te Rruga e Qeramithanave.

— E di.

— Ai duhet të jetë në shtëpi. Në qoftë se s'është, do të pyesësh familjen se ku ndodhet. Duhet pa tjetër ta takosh, t'i dorëzosh letrën që do të të jap dhe të marrësh përgjigjen.

Ai shkroi një copë letër shpejt e shpejt dhe gruaja u nis për ta shpënë atje ku e porositi.

Në letër Besimi i kërkonte Mitatit që ta njoftonin për arrestimet e mbrëmshme, shfaqte mendimin që të shtypej e të shpërndahet, brenda ditës, një trakt, i cili të godiste dhunën e armikut, qëllimet e tij. Të demaskonte tradhtarët, spiunët dhe agjentët e fashizmit, siç ishte Hajroja me shokë. Në fund i thoshte Mitatit, që ky, ose ndonjë shok tjetër, të vinte e të takohej me të, meqënëse Drita ishte arrestuar.

Vana e palosi letrën dy herë, e futi në çorap dhe u nis. Por nuk eci shumë; se në mes të rru-gës u ndodh ballë për ballë me Mitatin, një djalosh disi i shkurtër, që kishte ngjeshur kasketën anash, gjer mbi syrin e djathjtë.

— Për ku kështu, Vanë? — e pyeti gruan ai.

— Për te ti. Më dërgon Besimi. Kam një letër...

Vana pa rrëthi e rrötull, duke menduar të hiq-te letrën nga çorapi. Mitati e kuptoi dhe i tha:

— Lëre, te Besimi po vete.

Gruaja e ndoqi djaloshin pas, ndërsa ai po nxitonte.

Mitati e njoftoi Besimin për arrestimet që ishin bërë. Shumë vetë ishin arrestuar. Një pjesë i kishin futur në burg, të tjerët në ndërtesën e ish-konviktit; gratë i kishin në kuesturë. Thuhet se burrrat dhe djemtë do t'i interionin.

Ata këmbyen mendime mbi c'duhej bërë. Besimi theksoi se trakti duhej të dilte brenda ditës. Në mungesë të Dritës, do të dërgonte për punë Vanën.

Me të ikur Mitati, Besimi e nisi gruan edhe një herë për në shtëpinë e vajzës. Këtë radhë Vana gjeti atje edhe babanë e Dritës. Ai sapo ishte kthyer nga kuestura. Ishte dergjur përjashta, bashkë me të tjerë, të cilëve u kishin marrë fëmijët. Dikush, që kishte kaluar andej, u kishte pëshpëritur se kishte dëgjuar që gratë dhe vajzat do t'i lironin në mbrëmje ose të nesërmën.

Këtë lajm Vana ia shpuri Besimit. Pastaj shkoi përsëri për te Mitati, për të marrë ndonjë lajm më të sigurtë. Edhe djaloshi i tha që kishte mundësin që gratë e vajzat të liroheshin. Kurse burrat po i merrnin në pyetje. Disa po i shtrëngonin

keq. Në letrën që i dha gruas ai shënoi edhe emrat e atyre që kishin dorë në arrestimet. Ndër ta ishte emri i Hajros. Kuestori dhe komandanti i kårabinierisë ishin këshilluar me të.

Besimi ishte skuqur në fytyrë, kur mbaroi leximin e letrës. Të arrestuarit ishin shumë, midis të cilëve edhe komunistë.

...Pasdite Vana vrapiqi te Mitati për të marrë traktin, që duhej të ishte shtypur.

— Vetëm një copë po më jep! — u habit ajo.

— C'i do më shumë? — e pyeti Mitati.

— Për gratë e rrugës sime...

Djaloshi ngriti dërrasën e dyshemesë dhe nën të nxori dy trakte të tjera.

Gruaja i futi të gjitha në gji, rregulloi shaminë e kokës dhe mori me të shpejtë rrugën për në shtëpi.

Te porta e Dhonës pa Pavlinën. I bëri shenjë me kokë dhe i pëshpëriti:

— Më prit te Dhona. Do t'ju sjell komunikatën...

I dorëzoi Besimit ato që kishte për të dhe shkoi te fqinja. Në sobën e saj gjeti dy gratë dhe Gaqin. I dha traktet vajzës, duke i thënë:

— Na i lexo:

Kur vajza mbaroi së lexuari, Gaqi tundi kokën e murmuriti:

— Mirë thonë: derri do plumb.

E shoqja sikur u çudit me këto fjalë.

— Eh, në ç'kohë që arritëm! Edhe Gaqi, që s'ther dot një pulë, më flet për plumba!

— Flet puna, — ia priti i shoqi. — Djemtë nuk e kanë keq...

— S'ka! — ndërhyri Vana. — Kësaj radhe do të përbysjet e liga!

* * *

Besimi e kaloi natën, gati pa fjetur. Agimi e gjeti me sy hapur, duke menduar se ç'duhej bërë më tej, çfarë duhej biseduar dhe vendosur me shokët.

Vana mori vesh nga fqinjët dhe i solli lajmin se ishin liruar disa gra e vajza. Po Drita nuk po dukej.

Në orën dhjetë Besimi u bë gati për të dalë.

— Dó të kthehem nga mbrëmja, — i tha ai gruas.

— Po të më kérkojë ndonjë shok, të vijë te «vëndi».

Vana filloi të merrej më punët e shtëpisë, mbasi iku Besimi. Ili kishte dalë në oborr. Ai po sodiste kumbullën e mbushur me lule të bardha dhe mollën më ato lule ngjyrë trëndafili. Siç dukej, pemët do të kishin shumë.

Djalit i shkëlqyen sytë, kur në oborr hyri Drita.

— Mami, mami, erdhi teta Drita! — thirri ai me ngazëllim.

Vana doli me nxitim nga soba dhe iu hodh vajzës në qafë.

— Shpëtove! — i tha, pa përbajtur dot gjëzimin.

— Gjysëm ore ka që më liruan. Po vij fill e nga shtëpia. Ku është Besimi?

Vana i dhaporošinë e tij.

— Po shkoj, atëherë, — foli Drita. — Duhet ta takoj medoemos...

Por ajo nuk e takoi dot në vendin, ku kujtonte se ai duhej të ishte. Mbledhja, për ku kishte shkuar Besimi, ishte zhvilluar gjetkë. Në atë mbledhje, ndër të tjera, ishte marrë vendim që të nesërmen të bëhej një mbledhje e komandantëve të një-

siteve, partizane në fshatin Vedrenë, jo shumë larg qytetit.

Besimi po kthehej vonë në bazën e tij.

Në rrugët e ngushta të qytetit, shtruar me kalldrëm, me shtëpi një ose dykatëshe, me sofate përpara, kishte pak njerëz. Ndonjë çirak e ndonjë zanatçi, që sapo kishte mbyllur dyqinin e vogël, me kokën të rënduar nga andrallat e ditës, po ngjitej në shtëpi. Një grua këtu, një plakë atje, ulur në sofate, bisedonin, duke pritur burrin apo djalin. Fëmijët po loznin me ashikë e me cingla.

Besimi i njinte mirë këtë lagje të vjetër të qytetit, ku banonin familje të këputura, mbi të cilat tani rëndonte më shumë pesha e robërisë dhe e mjerimit, Ato kishin èndrruar gjithmonë përditë të reja. Këto èndrra ishin kthyer tani në shpresë, se burrat dhe djemtë e kësaj lagjeje po hidheshin të gjithë në luftë, që do të sillte jetën e re.

Me këto mendime dhe me ndjerëjën e dashurisë së madhe për këta njerëz, Besimi kaloi nëpër rrugicat dhe po i afrohej shtëpisë ku qëndronte. Kur do të kthente qoshen, dëgjoi prapa tij një zë të ashpër:

— Alto-la!!

E kuptoi që po i drejtoheshin atij, mbasi tjetër njeri nuk kishte në rrugicë. Shpejtoi hapat që të kaptonte qoshen dhe të humbiste nga sytë e atyre, që i kishin rënë pas. Vendosi të ecte shpejt në anën e sipërme e të mos shkonte në bazë.

Ndjeu se tani kishin zënë të vraponin prapa tij, kurse i njëjti zë gjëmoi:

— Alt! Alt!

1) Ndal!

Sic dukej ata kérkonin ta kapnin. Ai nisi gati tē rendte. Kur arriti nē qoshe, ktheu kokën pas. Tre karabinierë, me pushkët peshë, i ishin afruar mjaft. Bëri majtas, sipër rrugës. Por, sa hodhi hapol e parë, vuri re se dy karabinierë tē tjerë i kishin dalë pérpara. Nuk kishte si tē kalonte. Duhej tē merrte poshtë, ndonëse kësaj ane do ta kishte më vështirë, mbasi rruga tē shpinte nē qendër tē qytetit. Mirëpo nuk kishte si bënte ndryshe. Vrapoi dhe arriti pérpara shtëpisë së Vanës. Atëherë pa tre karabinierë tē tjerë nē anën e poshtme tē rrugës, tē cilët po vinin sipër. Vetvetishëm Besimi ndali nē vend. Tē gjitha anët ishin zënë. Nga t'ia mbante? Vetëm një shteg i mbetej: tē hynte nē shtëpi, tē kalonte te fqinjët dhe që andej tē hidhej nē përruan matanë kopshtit tē fqinjëve. Kështu mund tē humbiste gjurmët.

Pa se dera e shtëpisë ishte gjysmë e hapur. Shkoi drejt saj. Në këtë çast krisi një pushkë. Plumbi i vërshëlleu mu nē vesh. Tre karabinierët që e kishin ndjekur, kishin dalë nē qoshe dhe, duke parë se mund t'u humbiste nga sytë, kishin shtënë. Besimi u struk nē portë, nxori revolverin dhe iu përgjigj zjarrit me zjarr. Kjo i shtangu karabinierët. Atëherë ai hyri nē oborr, kaloi nëpër shtëpi dhe kapérceu tutje...

Të gjitha këto ngjanë brenda disa casteve. Në rrugë nuk kishte njerëz. Vetëm te sofati ishin Dhona me Vanën. Gratë u trembën dhe u hutuan. Ato panë rrezikun që i kanosej Besimit.

Karabinierët, nga rruga e tërthortë dhe që sipër, ishin afruar, gati për të hyrë nē shtëpinë ku ishte zhdukur njeriu që donin tē kapnin. Vetëtimthi, Vana u hodh për t'i penguar. Ajo mbylli me rrë-

mbim portën e saj kryqëzoi duart dhe qëndroi me fytyrë të vrenjtur, sikur po u thoshte karabinierëve: «Nuk e kaloni dot këtë prag!»

— Via, — shkumbëzoi njëri nga ata dhe, pasi tha një fjalë të ndyrë, ia ngjeshi me kondak.

Gruaja ra menjëherë, pa nxjerrë zë. Në fillim anash, pastaj u shtri sa gjatë-gjerë dhe zuri tej e tej portën.

Karabinierët, duke shkelur mbi të, u turrën brenda. Si nuk gjetën njeri, kapercyen në kopshtin e Mihalit.

Ndërkohë Besimi kishte marrë përruan përpjetë, drejt grykës, që sajohej nga dy kodrat mbi qytet. Që këtej do të kalonte në Vedrenë.

Dhona, në fillim ngriu në vend nga ato që ndodhën. Pastaj e mblođhi mendjen. Vajti menjëherë të ngrinte Vanën. Në rrugë kishin dalë njerëzit nga shtëpitë e afërta.

Vanën e futën në sobën e Dhonës. E shtrinë në minder, i fshinë gjakun, që i kishte rrjedhur nga goja dhe i ishte përhapur në mjekër. Vetullat i kishin mbetur të mbledhura. Në këtë kohë erdhì Drita. Ajo e mori kokën e Vanës dhe e vuri në prehrin e saj. Gruaja hapi sytë. Vështrimi i saj ndeshi në atë të Dritës.

Vana pëshpëriti:

— Ç'u bë Besimi?

— U shpëtoi, — i tha Drita. — Qetësohu.

Vana mbylli sytë, pastaj i hapi përsëri dhe buzëqeshi.

— Mos ma keni hallin. S'kam gjë unë, — iu drejtua grave që ishin mbledhur rrotull saj.

Në sobë u ndje dihatja e Gaqit, që hyri me vrap.

— Ngrehu, Vanë! — i thirri gruas. — Mblidhet
veten, se Hajroja ta mori të keqen, e palosën
trimat!...

Vanës ni shkëlqyen i sytë e zinj, ata sy të mëdhenj, që dikur kishin qenë shumë të bukur dhe që vazhdonin t'i ruanin gjurmët e asaj buku-rie. Drita, që e njihet atë mirë, e kuptoi se ishte shumë e gjëzuar në këto çaste.

Gruaja lëvizi.

Do tē ngrihem, — tha, — pos. Do tē ngrihem, se duhet tē qërojmë nga faqja e dheut tē gjithë Hajrot!

MIREMËNGJES, PROFESOR!

Ai ktheu qoshen e rrugës dhe mori shkallët e larta prej kaldrëmi, që çonin në ndërtesën jashtë qytetit, ku, atë vjeshtë të vitit 1942, kishte kaluar shkolla. I shkurtër dhe i thatë, dukej disi një tip i veçantë nën atë borsalinën e tij kafe me strehë të gjerë dhe me atë pardesynë bojë vaji, të kopositur, por që hapej në kraharor, ku spikaste koka e trashë e kravatës së kaltër me pikla të bardha. Çantën e madhe e mbante në dorën e majtë, mbështetur pas ijes, dhe ecte me trupin drejt e me kokën të ngritur, sikur të kërkonte të zgjatej. të paktën, nja dy gishta.

Nxënësit kalonin pranë tij me hap më të nxituar, duke pëshpëritur me njëri-tjetrin a duke folur me zë më të fortë.

- Mirëmëngjes, profesor!
- Mirëmëngjes!...
- Mirëmëngjes!

U mblodhën rreth tij djem e vajza, të vegjël e të rritur të klasave të ndryshme. Nxënësit e klasës së tij kishin hedhur shtat. Gjashëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetëvjeçarë. Këta të dytët i njihte më

mirë. I kishte qysh vitin e kaluar. Po që nga qershori i fundit e gjer tani në vjeshtë, i dukej sikur kishin bërë një kërcim të menjëhershëm përpjetë. Ja tek po ngjitej Mirdashi i zgjatur tepër, mbi të gjithë. Stiliiani leshverdhë, që rrinte në një bankë me të, nuk ishte zgjatur shumë, por ishte zgjeraur në shpatulla dhe fytyra i kishte marrë një pamje pjekurie.

- Mirëmëngjes, profesor!
- Mirëmëngjes!

Në sallën e profesorëve hynin e dilnin kolegët e tij, të dhënë pas përgatitjeve pér fillimin e orës së mësimit. Njëri kërkonte regjistrin, tjetri varte kapelën, dy jepnin e merrnin, sikur po zgjidhnin një problem të vështirë, një tjetër kishte qëndruar në dritare dhe po sodiste tutje, kodrat e verdha.

Hyrja e tij në rrugicën e shkollës, pastaj në sallën e profesorëve, i krijoi atë ndijim karakteristik të këtyre mjediseve. Ai futej në vorbullën e punës, të mendimeve e shqetësimeve, të nxënësve, profesorëve, e të drejtorit të shkollës. Zëra, thirrje, zhurmë, zilja, pastaj qetësi, tension nervor, përqëndrim pér të dëgjuar e pér të shpjeguar mësimin, ngacmime, kënaqësi, dëshpërim. Në fund, lodhja e madhe. Në mbrëmje, tension i ri pér të nesërmënen.

Ai hyri pa u ndier nëpër derën e hapur, përshtëndeti me zë të dobët atë që parakaloi afër, ua bëri me kokë të tjera, që ishin më larg. Lëshoi çantën në një qoshe, të tryezës katrore në mes të dhomës, hoqi pardesynë e kapelën, i vari dhe rregulloi nyjën e kravatës. Kostumi i tij blu i errët, me via, dopiolet, me manishëta të gjera të pantallonave, ishte puthitur mirë pas trupit të

tij të pakët. Dhe e kishte mbështjellë si ndonjë fëmijë të lidhur paq në pelena e të ujdisur hijshëm. Filloi të kërkonte regjistrin e klasës ku kishte mësim orën e parë.

Kur ra zilja, doli te dera e sallës së profesorëve. Nxënësit, në rresht, kaluan dhe u ngjitën në katin e dytë. Disa e përshëndetën me kokë. Ai ua ktheu me një buzëqeshje që sapo u ravijëzua mbi fytyrën e tij të hajthme. Me sy i ndoqi nxënësit gjersa humbën në bërrylin e shkallës tjetër. Kur u shuan shushuritjet dhe këmbët nga kati i sipërm, ra zilja e dytë dhe ai u nis për në klasë.

Ngjiti shkallët me një ecje të ngadaltë, duke shkelur me kujdes, sikur nuk donte që hapat e tij të turbullonin njeri, dhe kështu përshkoi rruginë e gjatë.

Dera e klasës ishte e myllur. Që brenda dëgjohej një zhurmë. Shtyu derën dhe, që në pragun e saj, pushtoi me një vështrim tërë klasën. Sikur vuri re një dridhje në atmosferën e saj. Në bankat e fundit dhe në dy bankat pranë dritares nxënësit ishin ulur nga tre dhe kokë më kokë po lexonin pa zë diçka që njëri e mbante në gjunjë. Në bankat te dera dy vajza po i thoshin njëra-tjetrës mësimin. Nxënësit e bankës së mesit po bisedonin të kthyer nga dritaret. Në dërrasën e zezë njëri po fshinte formulat e kimisë, që kishin mbetur nga dita e djeshme.

Me praninë e tij, bankat e para u ngritën në këmbë. Andej nga fundi u bë zhurmë nga një farë lëvizjeje, ndonjëri u ngrit përgjysmë, pa hequr sytë nga ajo që lexonte. Nga banka e parë pas dritares ra një fletë dhe mbeti aty përpara, mbi dysheme. Kjo fletë, sikur përmblidhte në rrëshqitjen

e saj gjithë atë i dridhmën e atmosferës së klasës, tërroqi vëmendjen e tij. Ai dalloj rreshtat e zinj të saj dhe turbullirën e shkronjave të makinës daktiologjike. Një nxënës u ul nën bankë, zgjati dorën, e mori fletën dhe e futi me ngut, në xhep.

Kur ai u drejtua për në katedër, nga banka prapa asaj së vajzave, doli një djale me fytyrë me kokrriza; i veshur me kostum prej stofë leshi të gjelbër po me kokrriza, si ato të fytyrës së tij.

Me leje, zoti profesor! Kam harruar detyrën e fizikës në shtëpi. Kemi orën e dytë. Më lejoni të vete ta marr?

Ai e pa djalin në fytyrë për një çast, pastaj përqëndroi shikimin mbi jakën e kollarisur të këmishës së tij dhe tha:

— Tani fillon ora e mësimit...

— E di, më falni. Por, ju lutem, më lejoni të shkoj, se do të më tërheqë vërejtjen profesori i fizikës. Shtëpinë nuk e kam larg.

Ai i hoqi sytë nga djali, vendosi çantën dhe regjistrin mbi katedër dhe murmuriti:

— Mos, u vono.

Me hov, djali hapi e mylli derën e klasës dhe u zhduk.

Ai u ul në karrigen e katedrës, mori frymë thellë, dhe çeli regjistrin. Hodhi sytë në shtyllën e emrave, e cila iu duk si një pllakë, e murme. Pastaj i ngriti sytë dhe pa se në bankat e fundit po vazhdonte ende ai leximi i heshtur, i mistershëm; që kishte vënë re me të hyrë. Në bankën pas dritarës, të tre nxënësit po pëshpëritnin midis tyre. Si pavetëdijshëm, ai shikoi djalin që kishte marrë fletën e rënë, por shpejt e hoqi shikimin prej tij.

Balli me tri vraga tejetetj i mbeti i anuar mbi regjistrin, por ai nuk po u thërriste emrat nxënësve. Pérpara kishte atë fletën me rreshta të zinj, me shkronja makine daktilografike. I shëmbellente pikërisht si ajo që, javën e kaluar, drejtori kishte treguar në mbledhjen e këshillit disiplinor. Në shkollë po qarkullonin trakte këtë muaj të dytë të viti të ri mësimor. Dy ditë më parë ai kishte vënë re se nxënësit e tij diçka po lexonin fshehurazi. Trakte duhej të ishin...

Këto fletë të çuditshme, për të cilat tanë po flitej gjithmonë edhe më shpesh, rrëfenin se po i gjenin nëpër shtëpi, në dyqane, të ngjitura rrugëve, madje edhe në zyrat e kuesturës. Kishin krijuar një pështjellim të tërë, kishin hapur punë dhe po sillnin lloj-lloj lajmësh, që elektrizonin qytetin. Këtë qytet të lindjes së tij, ku kishte kaluar gati dyzet e pesë vjetët e jetës, nuk e kishte parë kurrë kaq të shqetësuar e kaq të tendosur, sa këto kohë.

Dikur ai dilte nga shtëpia dhe në rrugë hasej me shkujdesjen dhe me hallet e ndrydhura vetjake të fqinjëve, të grave që fshinin, me të njëjtën mënyrë monotone, kalldrëmin, të zanatçinjve, që zbritnin të plogët në dyqanet e tyre. Në kafenenë e madhe të qytetit, ku kthehej të pinte kafenë e tij të zakonshme, i zinte veshi muhabete nga më të ndryshmet, mbi falimentimin që priste një tregtar dhe fitimet e mëdha të një tjetri, mbi prikën e madhe që kërkonte djali i njërit afendiko, i cili sapo ishte kthyer nga Parisi, mbi pokerin që katër vëtë kishin luajtur natën e kaluar, mbi një film të ri me Greta Garbo, që kishte sjellë pronari i kinemasë.

Tani, që kur ishin dukur traktet, të gjitha këto,

edhe fytyrat e njerëzve, dhe muhabetet, në kafene, e kishin ndërruar pamjen. Kishte vënë re gratë, tek po fshinin, të pritnin bisedën e tyre dhe ta shikonin si me dyshim, kur u kalonte pranë. Ndonjë zejtari i njohur, kur e përshtendoste, sikur i thoshte me vështrimin e tij: «E, mo profesor, do të vijë dita që t'i japim fund edhe ne fukarallékut». Kurse në kafenenë e madhe njerëzit i kishin ulur zërat. Ai nuk, përzihej, nuk i shponte llafet, por profesori i matematikës i vinte në tryezë dhe i pëshpériste në vesh: «Dëgjove gjë? Mbrëmë bastisën në mëhallën lart». «Thonë se një çetë goditi komunën e Bredhasit. Janë vrarë dy xhandarë». Nuk qëndronte shumë në kafene. Flitej se atje vërtiteshin: «grera», Ngrihej e shkonte në shtëpi.

Ai vente në shkollë dhe në kokë kishte datat e ardhjes në fuqi e të rënies së perandorëve, shtresat shoqërore në vende dhe epoka të ndryshme, kryengritjet dhe luftërat qytetare, lartësitë e maleve dhe thellësitë e oqeaneve, paralelet dhe meridianet e rrugullit tokësor. Të gjitha këto mundohej t'ua shpjegonte sa më qartë nxënësve dhe ai kënaqej kur këta e ndiqnin me vëmendje, e pyetnin dhe i kuptionin ngjarjet, shkaqet dhe pasojat e tyre. Asgjë tjetër, veç kësaj, nuk e shqetësonte.

Jeta dhe historia (pse jo?) i kishin dhënë një mësim të madh. Njëzet vjet më parë, ai kishte ardhur në këtë shkollë me diplomën e histori-geografisë rië xhep dhe më ngazëllimin e moshës dhe të profesionit në zemër. Kishte studiuar gjeografinë e vendeve dhe historinë e popujve, të jetës dhe të luftës së tyre, të padrejtësive e të shtypjes, të revolucioneve e të botëkuptimeve. Ato e kishin bërë të urrente e të dashuronte. Dhe këtë urrejtje e

dashuri donte t'ua frymëzonte e t'ua bënte të qarta edhe nxënësve të tij. Me këtë zell e synim filloj punën. Ai mendonte se koha po fitonte atë pjetëkuri, që do të ringjallte Shqipërinë, që do të vinte në vend të vërtetë e të drejtë. Dhe erdhën ngjarjet e qershorit 1924. Nxënësit dolën vullnetar pér në kryengritje. Ai u bashkua me ta. Por, pas gjashtë muajsh, çdo gjë u përbys. Vullnetarët që u nisën pér të mbrojtur qeverinë, nuk arritën dot në Tiranë. Noli kishte iku dhe Zogu kishte hyrë atje. Një èndërr që i la një shije të hidhur.

Këtë hidhërim ai e ndjeu gjatë gjithë kohës që pasoi. Sikundër ia kishte dëshmuar kaq e kaq herë historia, të plotfuqishme, u bënë demagogjia, rrena, privilegjet, dhe padrejtësitë. Dhe ai u hoq larg tyre. Gjeti strehë në librat, në shkollën dhe në shtëpinë e tij. Historia përsëritez...

Por tani këtë strehë po ia cënonin. Kush? Historia? Nxënësit e tij? Ai bëhej mënjanë tyre fizikisht. Por mendimet nuk i mënjanonte dot. Ato nuk përbaheshin. Gjenin rrugë të lirë e dilnin nga shtëpia e tij, nga kafeneja, nga salsa e profesorëve, Mendimet dhe zemrën e tij nuk i lidhte dot.

C'kërkonin ata djem të njomë, që çdo ditë dukeshin më të arrirë? Ishin ata nxënës të 1924-ës, apo të tjerë?

Ngriti sytë dhe pa kokën e vogël, mbi një qafë të hollë e të gjatë, të Mirdashit. Ky po e shikonte si me keqardhje, sikur të priste një përgjigje prej tij. Pranë ishte Stiliani me atë vështrimin pak të vrenjtur, por jo kërcënues.

Ai ktheu dhe pa dy vajzat e vetme që kishte klasa. T'i kishin lexuar edhe ato traktet?

Uli sytë përsëri mbi regjistrin. Duhej të bënte apelin, të fillonte mësimin. Sa minuta kishin kaluar?

Si do të vente e si do të mbaronte kjo punë që kishte nisur?

Historia përsëritez...

Qfarë mund të nxirrte në shesh Shqipëria me këtë pushtim të ri? Legionet romake, taboret osmane... Shekujt e robërisë... Mos ishte fashizmi më pak i fuqishëm?...

Le të fillonte apelin...

Historia do të kishte fjalën e saj...

Zuri të lexonte emrat. Zëri i tij mezi arrinte gjer te bankat e fundit. Dhe veshi i tij, si nëpër kllapi, kapte përgjigjet e nxënësve.

— Nuk ma thirrët emrin, profesor, — i tha një nxënës, kur ai mbaroi.

E pa atë djalë shtatvogël, vështroi në regjistër dhe u përgjigj:

— Jo, nuk të kam vënë mungesë. E paskam kapërcyer emrin tënd. — Pastaj shtoi: — Asnjë nuk mungon...

— Vetëm ai të cilit i dhatë leje.

Po, njërit i kishte dhënë leje të shkonte gjer në shtëpi...

Zbriti nga katedra, i pavendosur q'të bënte në fillim të orës së mësimit. Të pyeste mbi mësimin e kaluar apo t'i linte pyetjet për në fund? Nuk ia kishte ëndë të ngrinte nxënës. Nuk e ndiente veten të përqëndruar... Të shpjegonte mësimin...

Klasa sikur nuk merrte frymë. Sytë e saj sikur ishin ngjitur mbi të. Ai e ndiente, ndonëse nuk po i shkonte nxënësit, porse po qëndronte me duart prapa dhe me shikimin në dysheme,

përpara këmbëve. Çfarë mendonin e çfarë pritnin ata prej tij? E dinin që ai e kishte parë traktin që kishte rënë nga banka pranë dritares dhe që e kishte kuptuar se edhe të tjerë po lexonin trakte, kur kishte hyrë në klasë? Vetëdijen e kësaj pyetjeje ai e kishte dalluar në fytyrat e Mirdashit e të Stilianit. Çfarë besim kishin ata tek ai?

Eci drejt dritares. Nxënësit e bankës së parë po rrinin fare të qetë dhe po e ndiqnin me bishtin e syrit. Mbeti këtu i palëvizur. Çfarë po shikonte përtëj qelqit? Asgjë.

Ai u kthyte kur u hap dera e klasës me rrëmbim. Një oficer dhe dy karabinierë hynë brenda duke dihatur.

Nxënësit nuk luajtën nga vendet.

— Alcatevi¹⁾ — bërtiti oficeri, pa përfillur nëse mësuesi ishte apo jo në klasë.

U dëgjua zhurmë këmbësh, por nxënësit nuk po ngriheshin. Karabinierët u futën nëpër rreshtat e bankave dhe filluan t'i kapin nxënësit për krahu për t'i ngritur.

— Profesor, a e keni nën kontroll klasën tuaj?

— pyeti oficeri dhe shtrëngoi nofullat e gjera si të kalit.

Profesori rrotulloi vështrimin mbi të gjithë nxënësit dhe iu përgjigj, duke u munduar të ruante qetësinë në zërin e tij:

— Po, zoti major.

— Çfarë kontrolli mund të keni ju, kur në shkollën tuaj qarkullojnë trakte komuniste! — thirri majori. Pastaj u foli karabinierëve: — Shikoni me imtësi kudo!

1) (Ital.) Ngrihuni!

Dhe filloi edhe vetë të kërkonte nën bankat dhe nëpër xhepat e nxënësve.

Fytyra e profesorit ishte prerë. Maja e hundës së tij pak e kërrusur, ishte zbardhur. Bebet e syve gështenjë ishin zmadhuar dhe vetulla e majtë i ishte ngritur hark.

Ai po i hetonte nxënësit një pér një, por nuk po vinte re ndonjë ndryshim të ndjeshëm. Ajo larmi fytyrash, që mbushnin klasën, ishte në një harmoni të plotë.

Ç'do të bëhej? Ç'i priste ata dhe atë vetë? Nuk e kishte parë veten kurrë në çaste të tilla, kaq të rënda.

Karabinierët po kontrollonin Mirdashin dhe Stilianin. Këta kishin ngritur duart, por sytë i kishin tek ai. Ata sy nuk ishin aspak të trembur. Përkundrazi, ishin të qetë e të guximshëm. Stiliani po i buzëqeshte. Dhe nga kjo buzëqeshje sikur po dilte përshëndetja e tij: «Mirëmëngjes, profesor», ashtu siç e kishin përshëndetur nxënësit, kur po vinte sot në shkollë.

«Mirëmëngjes, profesor».

Mbushi kraharorin me frymë dhe ndoqi kontrollin që po u bënин nxënësve të fundit.

Karabinierët u hoqën mënjanë dhe majori deshi të largohej pa i folur asnjeriu.

Po profesori nuk mund t'i linte të shkonin ashtu. Ai mendoi se fjala i binte atij. Këtë fjalë e kërkonisnë të gjithë ata nxënës, e kërkonte e drejta, e kërkonte zemra e tij. Ai përdori guximin që i kishin dhënë ata.

— Zoti major, kjo sjellja juaj pa vend nuk është aspak e lejueshme, — tha me theks dhe me një farë madhështie, ashtu si theksonte pjesët e

mësimit që i pëlqenin më shumë. — Unë protestoj që ju hytë kështu, pa prudencë, dhe pa më pyetur, në orën time të mësimit. Këtu përgjigjem unë. Faji juaj bëhet edhe më i rëndë, pas rezultatit të kontrollit tuaj të rrëmbyer.

Majori e vështroi me egërsi, nuk denjoi t'i përgjigjej, vetëm u thirri karabinierëve:

— Andiamo!¹)

Ai përplasi derën duke ikur.

Në klasë u bë zhurmë. Nxënësit filluan të flisnin pér atë që ndodhi. Ata rrethuan profesorin.

— Qëndruat si duhet, profesor, — i tha atij Stiliiani.

— Pó traktet? — pyeti ai me padurim.

— I hëngrëm.

— I hëngrët?!

— Sa pamë që i biri i afendikoit ju kërkoi leje dhe iku, e morëm me mend se ku mund të shkonte. Prandaj i copëtuam letrat dhe i gëlltitëm.

Profesori po çuditej. Ai kishte një besim të madh te nxënësit e tij, më të madh se kurrë ndonjëherë.

1) Ikim.

M O L L E T

Marsi ishte më të dalë, dhe, ato ditë, moti sikur po kthente përmbarë. Dielli, si t'i shtynte me dorë retë, nxirrte kryet dhe hidhte mbi pllajë një ngrohtësi të cilën njerëzit mezi e prisin. Por, lart, çukat e maleve nuk e kishin shkundur dëborën.

Këtë pasdite ishte vrenjtur përsëri dhe kishte nisur një erë që vinte tutje nga gryka. Ajo të kujtonte reshjet dhe cingërimën.

Nga një kasolle e veçuar dilte një tym, i rrallë.

Në të ndarën përdhese ndihej një zbrazësirë e madhe, ndonëse atje kishte dy njerëz dhe një mace, e struktur pas gllanikut. Këta nuk mbushnin dot të ndarën me katër muret e zhveshura, me trarët e zbuluar e të nxirë të pullazit, dy postigjet e rrjepura nga koha, një sënduk e një sofër në një qoshe dhe një musandër me dërrasa të kalbura.

Çdo gjë heshtte. Veç macja laramane, që kishte futur kokën në hirin e vatrës, gërhiste. Dy njerëzit, plaku me plakën e mbështjellë me një shami të

zezë të zberdhulët, po rrinin mbi postiqet, kundruall njëri-tjetrit. Plaka kishte lëshuar fytyrën e gjatë me atë lëkurën pala-pala, si petë dhe po dremiste. Plaku, me një setër të arnuar krahëve, po hiqte një palë tespihu të vjetra, kokëvarur. Në atë gjysmerrësirë të së ndarës dhe të fytyrës së tij, zbardhnin çuditërisht koka e tij e qethur rrafsh dhe mustaqet, që binin poshtë si dy xhufka me majë të hollë.

Në vatër po digjeshin fundërrinat e ca shkarpave dhe ngrihej një fjollë tymi ziosk që e thithte oxhaku. Vështrimi i plakut ndiqte rrugën e kësaj fjalë, të cilën e merrete me mend që dilte përmbi kasollen e tij, pastaj shpërndahej e përhapej kushtet ku, në pafundësinë. Kështu ishin shpërndarë, gjatë viteve, edhe mendimet e tij, të cilat, si ai zjarri, e tymi, ishin ndezur, kishin marrë flakë, pastaj ishin platitur, dhe kishin nxjerrë vetëm tym, që davaritej e humbiste. Tani sikur i kishte mbuluar hiri...

Nga oxhaku zbriti një rrymë ere, që theu vijën e drejtë të fjollës së tymit, dhe e fryu këtë përkrah së ndarës. Tymi i hyri plakut në hundë e në gojë dhe atë e zuri kolla.

Plaka përpëliti kapakët e rënduar të syve dhe pyeti:

- Fole gjë?
- Jo. Zuri erë...
- Mos na e kthejë me dimër...
- Dimër?... Molla lëshoi sythe...
- I ka këto marsi. I gënjen pemët...
- Më mirë të mos gelin...
- Më mirë... Të mos i zërë ngrica në lulet...

Prilli është ndryshe...

Plaku tērħoqi sētrēn, qē i kishte shkuar mē-njan ē, u fut mē mirē nēn tē dhe tha:

— Me 'żjarr si do t'ia bējmē, po na ra dēborē tjetér...

— S'imbeti klečkē nga kumbulla?

— Jo.

Plaka mori frymē thellē dhe sikur u ankua:

— Iku dhe ajo, se e pate merak pēr ta prerē....

— C'tē digjnim tērē dimrin? Nuk bēnte mē. Tre ġerekē ishte tharē. Nja dy kokrra, dhe ato i krimbte. C'e doje?

— Eh!... — psherētiu plaka dhe mbylli sytē përséri.

Ajo dōntē tē humbiste nē dremitje, tē harron-tē gjithċka.

Plaku po e shikonte me bishtin e syrit. Atē kumbullēn ajo e kishte mbjellē vetē, kētu e tri-dħjetē vjet tē shkuar. Bēnte kokrra tē kuqe, tē ċembla, e me lēng. Prej tyre bēnin hoshafe. Pastaj kokrrat i kishte pakēsuar, kishte zēnē t'i krimbte e t'i rrēzonte.

Plaku po e shikonte plakēn ashtu tē pakēt, me lēkurē tē fishkur e me gojē tē futur nēn hundēn pak tē zgjatur. Pesēdhjetē e ca vjet me radħe ai e kishte parē, kishte ndenjur e kishte pu-nuar me tē, kishte kuvenduar e ishte kēshilluar, kishte vēnē re vetitē e saj dhe ndryshimet qē ajo kishte pēsuar. Mbante mend shumē gjéra. Nē ato pesēdhjetē vjet ajo ia kishte leħtesuar shumē herē mendimet.

«Po tē mos bjerē gjē nesér, do tē dal tē bēj ca shkarpa», deshi t'i thoshte plaku asaj. Por nuk guxoi t'i prishte atē qetēsinē, nē tē cilēn e kishte kredhur dremitja.

* * *

Tre kalorës po ngisnin me nxitim. Dukej se donin të arrinin shpejt në vendin për ku ishin nisur.

Por, kur mbërritën atje, ku udha thyhej pak e degëzohej poshtë, më të djathëtë, kurse krahë i majtë i saj merrte faqen e shpatit, ata i mbajtën kafshët.

— Unë them të kthehem i te plaku, — u tha një djalosh mbi njëzetvjeçar dy të tjerëve. — Kasollja e tij ishte e veguar; në fshat nuk hyjmë, dhe as na ndien njeri në këtë kohë.

— A thua?... — foli mendueshëm kalorësi më i gjatë, që qëndronte mbi një kalë të bardhë qimendritur.

— Në qoftë se milicët janë nisur këtyre anëve, — iu përgjigj kalorësi i tretë, që dukej i imtë brenda gozhupit të tij, — duhet t'u shmangemi.

Tjetri u mendua përsëri, pastaj tha:

— Nuk duhet të vonohemi, na presin...

Djaloshi, që pat folur i pari, ndërhyri:

— Nuk do të qëndrojmë shumë te plaku. Së të erret. Milicët nuk lëvizin kur ngryset. I biem, pastaj, nga Përroi i Thatë dhe shkurtojmë rrugë.

Kalorësi shtatgjatë e miratoi këtë mendim. Të tre u kthyen më të majtë, faqes së shpatit.

Përpara kasolles zbriti i pari djaloshi, i cili tanë u duk me tërë trupin e tij mesatar, të bëshëm, me kofshë të trasha, që sajoheshin nën

poturet prej shajaku tē zi, me kopsa anash nē kércejtē e këmbëve. Ai shtyu trinën, hyri nē atē copë oborr dhe u fut nē tē ndarën e kasolles. Pas pak doli me plakun.

— Urdhéroni, urdhéroni! — u dëgjua ky që nē pragun e kasolles, pastaj nxitoi drejt kalorësve, zuri pér freri pelën e bardhë dhe vazhdoi: — Zbritni, urdhéroni, mirë se tē vini! Urdhéroni!

Dukej sikur ishte hutuar ca. Ai po u vinte rrotull kafshëve, diçka donte tē bënte, tē shërbente me ngut, e me kujdes. Në lëvizjet e tij kishte një zhdërvjelltësi si tē përshkënditur aty pér aty.

Kapërceu trinën kalorësi me pelën e bardhë, pas tij ai me gozhup, që ishte sa i imtë, aq dhe i shkurtër, pastaj djaloshi me shajak. Deshën t'i hiqnin kafshët e t'i lidhnin mënjanë, por plaku u hodh:

— T'i futim brenda, nē katoq; jo, jo, këtu...

— Nuk nxë atje, — ia preu djaloshi. — Një çikë do tē rrimë, jemi pér udhë...

— Sa tē rrini. Hajvanët. janë tē djersirë. Po fryn erë e po veson...

Kishte zënë një shi i hollë, tē cilin era e përhapte dhe sikur e ndërpriste pér një çast.

Katoqi ishte përballë së ndarës së pleqve, përposh truall, me mure tē lyera me baltë. Sipër kishte vetëm një frëngji pa xham, me dy purteka pér parmakë. Në një qoshe ishte shtruar ca kashtë, ku kishte rënë më gjunjë një dhi e kuqërreme. Plaka po e dëbonte dhinë e po u hapte vend tri kafshëve tē udhëtarëve që kishin buajtur nē kasollen e saj. Pastaj mori atë dorë shkarpa që kishin

mbetur, i theu, i vendosi në vatër dhe filloi t'i frynte zjarrit.

Macja, që nuk e kishte prishur gjumin, lëvizi atëherë, u çua, u shtriq së gjati kockë e lëkurë, pastaj ngriti kurrizin si gungën e një deveje dhe hapi gojën, mjaulliu me një zë që mezi u ndje, si një ankım i përtuar. U largua nga vatra dhe vajti t'u fërkohej njerëzve pas këmbëve.

— Kemi miqësi të vjetër me të atin, — u foli plaku dy miqve, duke treguar djaloshin. — Hallet e jetës na lidhën. Shkonim e punonim si mjeshtra në Myzeqe. Ngrnim shtëpi për bejlerët. Për vete mbetëm me këtë kasolle. Si i thonë: kovaçi masha bën e mashë s'ka.

Ishin sheshuar të gjithë rrëth vatrës. Dy miqve u kishin lëshuar postiqet. Plaku dhe djaloshi, këmbëkryq, mbi dhogat e ronitura të dyshemesë. Veç plaka po vinte rrötull si një hije, herë dilte jashtë, herë hapte dhe shikonte brenda në musandër, sikur t'i kishte humbur ndonjë send dhe nuk kishte se ku ta gjente. Ajo iu afrua plakut dhe e vështroi me ankth. Ky e pa dhe i foli shkurt:

— Ulu, tanë.

Me këto dy fjalë sikur i dha përgjigjen për të gjithë atë që e mundonte, i hoqi peshën e çdo kërkimi të kotë, që nuk sillte gjë.

— Mos u shqetësoni për ne, — foli miku shtatgjatë, me një zë të plotë e të butë. Ai sikur të kishte gërmuar thellësinë e shpirtrave të dy pleqve.

— Asgjë nuk duam. Për pak do të nisemi.

— As duhan nuk më ndodhet, — tha plaku. — Nuk e kam pirë tërë jetën.

— Mirë ke bërë, — tha tjetri. — Huq i keq ky i duhanit. Nga ne të tre vetëm unë e pi.

Ai nxori një paqetë dhe ndezi një cigare.

— Të shkretën! — u pikëllua plaka. — Shtiri e flamosura dhi! Qumëshти iu tremb dhe i iku!

— S'ka gjë, rri rehat. Zemrat tuaja mjaft i kemi.

Plaka kundroi fytyrën e mbushur të mikut dhe sytë e tij të zinj që qeshnin. Ajo u ul midis djaloshit dhe miku tjetër, i cili e kishte hequr gozhupin dhe e kishte lënë pas murit. Mbështeti dorën e saj në gjurin e tij; edhe ai vuri dorën e vet mbi atë dorë të vogël me një bardhësi të vrapë. Plaka ndjeu ngrohtësi. Ajo ngriti sytë dhe e pa drejt. Fytyra e tij e rrumbullakët ishte shumë e qetë. Mendoi se ai duhej të ishte njëzet e pesë vjeç. Pastaj ktheu kokën nga tjetri, i cili iu duk se do t'i kishte kaluar të tridhjetat. Të rinj ishin të gjithë ata.

— Vetëm një djalë keni pasur... — tha miku shtatgjatë.

— Vetëm një, — tundi kokën plaku.

Plakës sytë e përtharë iu mbushën me lotë të papritur, se dukej që çdo burim i tyre kishte *shteruar*. Ajo vuri dorën tjetër mbi atë të mikut që kishte pranë, e shtrëngoi fort, sikur donte të ndalonte rrëkëllimën e atyre lotëve, mbi faqet e saj të mpita.

— Mbetëm kërcurë... — vazhdoi plaku.

— Biftë tuaj, jemi të gjithë, — i tha zemër miku.

— Të na rroni! Vëç, si po na shikoni...

- Nuk do të mbeteni kështu...
- C'mund të presim?...
- Shumë.
- Ne, tani...
- Të zezë e patët rininë. Por pleqërinë do ta keni të bardhë.

Plaku heshti. Fryu shkarpat që po tymosnin, dhe një flakë tjetër mori me kërcitje.

Pastaj plaku pa mikun e tij në sy dhe tha:

- S'e zuri plumbi mbretin...
- Do t'i zërë, atë dhe të tjerët, — u përgjigj miku.
- Eh!... — Dhe pas një pushimi plaku pyeti:
- Ç'të reja na sillni?
- Komandantin e policisë e vranë në qytet, — iu përgjigj kësaj radhe miku që rrinte pranë plakës.
- E vranë! — u kthye me gjallëri drejt tij plaku, sikur të kërkonte ndonjë shpjegim më shumë.
- E shtrinë mu përpara shtëpisë së tij. Dy «trimat» që e ruanin ua mbathën këmbëve.
- Komunistët e vranë?
- Bjtë e popullit, që janë ngritur përliri.
- A dini të më thoni kush janë komunistët? C'është ajo partia e tyre, që kam dëgjuar se qenka mbledhur në Tiranë? — pyeti plaku dhe u duk se këto dy pyetje po e mundonin prej kohësh.

Për disa çaste në të ndarën mbetën të varurra vetëm këto dy pyetje.

Miku shtatgjatë thithi cigaren, të cilën e ki-

shte vënë në një cigarishte të hollë dhe foli:

- Partia e komunistëve është populli, jemi ne, jeni ju, të varfërit e të shtypurit...
- Kjo parti është ngritur kundër Italisë, kundër bejlerëve?..
 - Ajo lufton për të çliruar vendin, për t'u dhënë fabrikat punëtorëve, toka fshatarëve...
 - Ç'më thoni!... — lëvizi kokën plaku. Pastaj ra në mendime, duke hequr tespihet. — Do të bëhet luftë, the? — murmuriti pas pak, me sytë te prushi që kishin lënë shkarpat e djegura.
 - Pa luftë nuk fitohet gjë.
 - Dhe fshatarët do të fitojnë tokën? — ngriti kokën plaku.
 - Do të marrin tokën e tyre.
 - Eh! çudi!...

Në këto fjalë të plakut kishte diçka, të cilën plaka e njihte mirë. Ai kështu thoshte sa herë prishte një gëzim, një lajm a një punë të kryer së mbari. Dhe atëherë gëzimi i tij lehtësonte edhe shpirtin e saj. Ndaj, thellë në zemër ajo po uronte tanitata që, në këtë mbrëmje, kishin mbushur atë të ndarën e tyre përdhese, e cila rrinte gjithnjë bosh.

Plaka shtrëngoi përsëri dorën e mikut pranë saj, dhe ky i buzëqeshi.

- Sill atë kandilin, — tha plaku. — U err.
- Plaka mori kandilin nga guri i oxhakut dhe ia' dha. Ai e afroi të thëngjijtë, u fryu këtyre dhe fitili mori flakë. Plaka e vendosi prapë kandilin mbi oxhak.
- Na ndjeni, — foli miku shtatgjatë, duke u ngritur. — Duhet të nisemi.

U ngritën dhe të tjerët.

— Këtë ditë nuk do ta harroj, — u mëshoi ngadalë fjalëve plaku. — As e fal me kaq. Ju pres pérherë. Mbase do t'ju sjellë puna këtyre anëve. Derën e keni të hapur.

— Do të vijmë, — thanë ata.

— Si?! Kështul... — u turbullua plaka dhe e vështroi edhe një herë plakun me atë ankthin me të cilin e kishte kundruar kur miqtë ishin ulur pranë vatrës. Plaku e kuptoi përsëri, dhe tha:

— Të bëjmë gati kuajt...

— Daleni! — kundërshtoi plaka.

Ata nuk dinin përse donte t'i ndalonte.

Ajo shkoi pranë sëndukut dhe ngriti kapakun, që lëshoi një zhurmë të lehtë. Që brenda erdhi era e gjërave të ndenjura. Plaka u kërrus, futi dorën, kërkoi në një qoshe të sëndukut dhe nxori që andej dy kokrra mollë.

— Këto të dyja paskan mbetur, të shkretën!

— foli ajo.

Mollët kishin një ngjyrë të zbehtë kafe dhe ishin fishkur.

— Urdhëroni, — ua zgjati dy miqve plaka. — Duken si të kalbura, por jo. Brenda janë të brydhëta. — Pastaj u përligj, duke treguar djaloshin:

— Këtë e kemi djalin tonë. Merrini ju.

— Bashkë do t'i hamë, — i tha mikë i imtë, që kishte veshur gozhupin.

— Na falni, — foli si e turpëruar plaka. — Nuk na u ndodh gjë tjetër...

— Nënë.. — deshi të fliste mikë shtatëgjatë, por ai nuk shtoi tjetër fjalë.

E përqafoi plakën dhe e puthi. Pastaj i shtrën-goi dorën plakut dhe e përqafoi.

Ata shaluan kafshët.

— Do t'ju vijmë, — tha me zërin e tij të plotë kalorësi shtatgjatë.

— Këtu na keni, — iu përgjigj plaku.

Ata u nisën.

Gjersa trokitjet e patkonjve humbën në errë-sirë, plaku dhe plaka qëndruan te pragu i kasolles.

PËR TËRITJE

Brenda autobusit të vogël ishte zagushi. Një-rezit ishin struktur pranë njëri-tjetrit. Shoferi kishte marrë tre vetë jashtë vendeve. Të tjerët ishin ankuar, por ai nuk ua kishte vënë veshin. U kishte thënë se në këto kohë të vështira, kur mezi nisej një autobus nga Tirana për në qytetet e tjera, kishin porosi që t'u bënин vend nevojtariëve në ndonjë qoshe. Ai mbante ca frona të ulët. Dy i kishte futur në rruginën e ngushtë të automjetit, tjetrin e kishte vendosur afër derës. Por udhëtarët nuk i kishin gëlltitur shpjegimet që u kishte dhënë. Ata e dinin se në këto kohë, një vend në autobus bënte njëqind franga nën dorë dhe këto shkonin në xhepin e shoferit.

Ndonëse gati të gjitha dritaret e makinës ishin të hapura, udhëtarëve sikur po u zihej fryma. Që jashtë, nga lugina e lumi, ku po kalonin nuk vinte asnjë puhizë. Gushti kishte hyrë me vapë. Dita ishte gdhirë me re që paralajmëronin shi, por që ende nuk po dukej.

Ndërmjet tregtarëve, komisionerëve, nëpunësve dhe një nëntogeri mustaqelli të milicisë, i cili

po udhëtonte me kostum civil, që rrinte si diçka e huaj në trupin e tij eshtërmadh, në radhët e para të autobusit ishte një burrë trupvogël, rrëth të tridhjetepesave, me vetulla të zeza, me mjekër të rruar atë mëngjes, por që dukej si gjer në mbrëmje do t'i rritej përsëri e dendur, e ashpër dhe e nxirë. Ai kishte shkopsitur jakën e këmishës, kishte liruar kravatën dhe kishte ngritur në majë të kokës borsalinën ngjyrë mavi. Ballin ia kishin mbuluar bula djerse. Ndiente vapë e lodhje. Muhabetet që zukatnin ishin pér të një ngacim, të cilin ia kishte acaruar rënëkimi shurdhues i autobusit, më ato gjërvishtjet e mprehta, kur kishte ngritur të përpjetën. Udhëtimi me autobus ishte i gjatë, i mërzitshëm, rraskapitës. Ai kishte rastin të vinte me mileçenton e drejtorit të nozullimeve, por e kishin këshilluar të udhëtonë më mirë me autobus.

— Shofer, qëndroje pak, të marrim një çikë frymë, se na u zu fare... — foli njëri.

— Ja, atje poshtë, të kafeneja... Lagim gurmazin dhe çlodhemi, — u përgjigj shoferi.

... Si ktheu filxhanin e kafesë dhe shpiu këmbët, burri më kapelë ngjyrë mavi u ndje disi i lehtesar. Tani, ndonjë orë rrugë mbetej deri në qytetin ku do të arrinin. Autobusi po shkonte buzë liqenit. Ujërat e tij, më kohë të kthjellët, ishin nga më të kaltrat e më të tejdukshmet. Por sot ishin murrëtyer. Ai ishte larë më ato ujëra të ngrontha, kishte vozitur mbi to me varkë. Disa herë kishte ardhur këtu edhe me nxënësit e tij. Ruante kujtime të dashura. Mbi dy vjet kishte dhënë mësim më liceun e atij qyteti. Kohë jo e gjatë, por që i kishte mjaftuar pér t'u njojur e pér t'u miqësuar me kolegë, nxënës dhe familje të përmen-

dura. Ishin tē afruar, tē zgjuar, me kulturë ata qytetarë. Po kthehej pas tre vjetësh. Dy vjetët e Tiranës nuk mund t'i krahasonte me ata tē qytetit krahinor. Ç'është e vërteta, ai kishte nisur një jetë tē re në Tiranë, ishte futur në rrethe tē larta, ishte argëtuar ashtu si nuk mund tē bëhet në krahina, por, prapëseprapë, jeta, ambientet, atmosfera e atij qyteti, kishin diçka tjetër. Sa për vitin që kaloi në Itali, oh, puna ndryshonte! Ku Ballkani, Jugosllavia e Greqia — ku kishte studiuar — dhe ku Italia! Sidomos Romë, Firence, Milano! Qytetërim, art, bukuri! Kishin tē drejtë tē mburreshin, kishin tē drejtë tē kërkonin...

A do t'i gjente përsëri ato ambiente, atë atëndosferë tē ngrohtë e frymëzuese? Kishin kaluar tre vjet, dhe gjatë këtyre tre vjetëve kishin ndodhur ndryshime. Edhe për atë qytet kishte dëgjuar disa gjëra, ndonëse vitin e fundit kishte qenë përtej Adriatikut. Veçanërisht eprorët e tij, para se ta nisnin për detyrën e re, e kishin sqaruar dhe udhëzuar. Ai e kuptonte: në qytet dhe në lice nuk ishte gjendja e tre vjetëve më parë. Sidoqoftë, atij i duhej tē kishte kujdes dhe tē vepronë me mend. E dinte që në personelin e liceut ishin bërë lëvizje. Një pjesë ishte larguar: tē tjerë kishin ardhur. Për disa prej tyre kishte marrë porosi. Megjithatë, në shkollë kishin mbetur disa profesorë tē vjetër, me ndonjërin prej tē cilëve ai kishte pasur muhabet më shumë. Sidomos, duhej tē përpinqej tē afrohej me nxënësit, i kishin thënë. Këta ishin pikë nevralgjike e shkollës. Tani, nxënësit, tē cilëve, u pat dhënë gjuhën shqipe dhe latinishten, ishim në klasat e parafundit dhe tē fundit. Ishin rritur. Me shumë prej tyre kishte pasur miqësi.

Ishin fëmijë nga familje fisnike, nxënës të zellshëm e të sjellshëm. Disave u kishte vajtur shumë herë në shtëpi. Ishte miqësuar edhe me prindërit e tyre. Me të tjerë kishte dalë kaq herë shëtitje kodrave. Kishte shkuar në bibliotekën e qytetit, kishte rrahur mendime për shkrimtarë e vepra letrare, i kishte ndihmuar. Një nga më të mirët e më të dashurit e tij ishte Pandushi. E ka në sy atë fytyrë disi të zbehtë, vështrimin e kaltër, që gjithnjë sikur qeshte, flokët e çelur. Ja tek i vjen zëri i tij i druajtur, që shpreh një mendim të kthjellët. Këta nxënës do të jenë një mbështetje për të. Ata janë të rritur. Të tjerët, të klasave më të ulëta, nuk mund të krijojnë probleme.

Këto mendime e shoqëruan atë gjer në të hyrë të qytetit, i cili iu shfaq me të njëjtën pamje, ashtu siç e kishte lënë para tre vjetësh, por si më i lodhur dhe disi i ngrysët.

2

Në zyrën e drejtorit ai e ndiente veten krejt ndryshe. Ishte vetëm. Për të parën herë po rrinte vetëm në këtë dhomë, një anë e së cilës vinte e rrumbullakët, sipas trajtës që kishte ndërtesa në një krah. Zyra ishte gati po ashtu e pajisur, si tre vjetë të shkuar. Tryeza prej arre e drejtorit, një tryézë tjetër e gjatë, rrëth së cilës mblidheshin trupi mësimor, një dollap bibliotekë i mbushur me enciklopedi dhe libra të tjerë të huaj, dy kolltukë e një kanape në një qoshe, kasaforta e vogël në qoshen tjetër. Përposh, një qilim persian ngjyrë portokalli. Nga tavani i varej një abazhur me tre

krahë të kristaltë. Po, po, ndonjë ndryshim i vogël ishte bërë në këtë zyrë. Fotografitë e perandorit dhe të Duçes ishin vendosur në korniza të mëdha ngjyrë ari; takëmi i bojës së shkrimit ishte zë-vendësuar me një më të madh, krejt i zi; dy taketuke prej kristali me shenjat e liktorit dhe një servizio likeri për miqtë në syzen e poshtme të bibliotekës.

Të gjitha të tjerat, siç kishin qenë atëherë kur ai vinte për mbledhje. E kishte zakon të ulej në të njëjtin vend, aty nga fundi i tryezës. Kundrejt, pak më lart, kishte ndenjur disa herë ajo, profesoresha e re e historisë. Gjatë mbledhjes, ai vinte re mirë tiparet e saj të brishta, ato buzë të pangjyera, por joshëse, ata sy me qepalla të ulura, ata flokë të ndritur ngjyrë gështenjë, që binin në supet e saj. Kishte një zë të qetë dhe në klasë ose me kolegët fliste butë, si ndonjë fëmijë. Por, në mbledhjet e drejtorisë, ku ajo nuk mbetej asnjëherë pa folur, zëri i saj merrte tjetër ngjyrë, fuqizohej. Ajo gjallërohej e të linte vragë me ato që thoshte. Kishte gjithmonë diçka për të thënë, përmësimin, për programet... Dhe fjala e saj sikur e bënte më të bukur... Ai kujtonte se do ta gjente prapë këtu. Për të kishte pyetur sapo kishte marrë vesh se emërohej në liceun e vjetër. Por i kishin thënë se ishte transferuar në Gjirokastër. Përse? I kishin dhënë një përgjigje të vakët.

Tani ndihej i vetmuar. Kishte përpara, mbi tryezë, dosjen sekrete, që e kishte nxjerrë nga kasafora, dera e së cilës kishte mbetur e hapur. Kishte lexuar raporte e karakteristika, për një dy profesorë, që tani kishin kaluar në shkolla të tjera, kishte gjithashtu disa shënime jo të mira. Në

fletëkarakteristikën e saj ishte bërë një pikëpyetje e madhe me laps të kuq. Shënime me mendime dyshimi kishte gjetur edhe për disa nxënës. Ai duhej t'i studionte mirë të gjitha këto, duhej të bënte hetime. Por, me mend e me takt; të ndërrohej pakëz fleta; të mos binte në gabimet e paraardhësve të tij.

Mbresat e ditës së parë ishin të kënaqshme. Në shkollë nuk e kishin pritur keq. Disa profesorë i kishin shtrënguar fort dorën, i kishin buzëqeshur, ndonjëri e kishte përqafuar. Nxënësit, sidomos ata të klasave të fundit, e kishin vështruar të heshtur e si të habitur. Ai kishte dalluar Pandushin midis tyre. Ishte zgjatur, fytyra e tij sikur ishte burrëruar, por ajo ruante atë farë zbehtësie, atë vështrim soditës.

Djaloshin e kishte ftuar në zyrë, në mbarim të mësimit. Shikoi orën e dorës. Edhe pesë minuta që të binte zilja. Mbylli dosjen, e futi në kasafortë dhe e kyçi këtë. Ndezi një cigare dhe filloi të vozitë nëpër dhomë. U dëgjua tringëllima e ashpër e ziles. «Ky Gaqi ia sillon shumë», mendoi. Iu kujtua se në Itali zilet binin më embël. Në disa shkolla ishin vënë zile elektrike.

Zhurmë nëpër korridore, zëra nxënësish, të thirrura jashtë, tek dilnin nga shkolla. Pastaj zhaurima u largua ca nga ca.

Por Pandushi nuk po dukej.

Shkolla sa vinte e po qetësohej më shumë. Si kështu? Të kishte ikur edhe ai?

Drejtori mbajti vesh. Iu dëgjuan këmbë që po afroheshin. U përqëndrua. Këmbët u languan prapë. Kush të ishte? Ndonjë nga shërbyesit?

Më në fund, trokitje te dera.

— Hyr, — foli, duke zvarritur zérin drejtori. Dera kërciti ngadalë.

Pandushi u duk, duke mos lëshuar dorezën. Drejtori buzëqeshi dhe eci drejt tij.

— Eja, Pandush, po të pres...

I zgjati dorën. Djali i dha të tijën pak me vonesë. Drejtori e tërhoqi brenda dhe e uli në kanape. Ai ndenji pranë djalit. Nisi ta pyeste për tre vjetët e fundit, për të dhe për familjen, për shokët, për profesorët, për qytetin. I shfaqi vetë ndonjë mendim. I tha se ishte rritur e kishte bërë ndryshime. I kujtoi copëza ngajeta e shkollës, kur ishte profesor në lice, ndonjë orë mësimi, diçka të veçantë e gazmore, një ndodhi... Djali dëgjonte. Ai përgjigjej shkurt, jepte ndonjë shpjegim, herë tundte kokën në shenjë pohimi ose thoshte vetëm «jo».

Drejtori hetonte çdo lëvizje, peshonte çdo fjälë të tij,

— Kemi kaluar shumë mirë, — tha pastaj.

— Po, — miratoi djali.

— Sigurisht, edhe më mirë kemi për të kaluar në të ardhmen...

Djali nuk foli.

Drejtori heshti. Mbështeti kokën në shpinën e kanapesë dhe thithi thellë cigaren. Ai rrudhi vetullat. Djali mendoi se tani do ta kishte zënë cigaren; atëherë nuk pinte.

— Nga ata dy vjet e gjysmë që kalova me ju këtu, kam kujtime shumë të bukura, — foli si në ëndërr drejtori. — Të gjithë ju keni qenë të mirë. Veçanërisht ti, Stefi, Gori e Samiu keni qenë shumë të zellshëm, të shkëlqyer në mësimë, të përpiktë. Te ti, sikundër dhe te ndonjë profesor,

gjeta miq tē vërtetë që nē ditët e para tē ardhjes sime. Isha i ri nē këtë qytet. Nuk njihja njeri. Por ngrrohtësia juaj më dha prehje dhe optimizëm. Ti më ndihmove edhe me libra, që nuk i kisha lexuar. E... – buzëqeshi përsëri drejtori.

Këto fjalë po gjallëronin kujtimet e djalit. Dita e parë e mësimit me tē. Zelli me tē cilin u shpregonë lëndën. Komentet që u bënte copave letrare, aftësia e tij nē gramatikë, rrjedhshmëria e tē folurit, ndihma, që nuk ua kursente. I ftonte përkëtë edhe nē shtëpi. Nxënësit e çmonin. Në shtëpinë e tij kishte vajtur edhe ai. Herë për t'i shpënë librat që lexonte, herë për tē biseduar rrëth një mësimi a një romani. I priste tē gjithë me qejf nē atë dhomëzë beqari, vetëm me një krevat tek, një tryezë tē vogël e dy karrige prej shavari. Shtëpinë e zënë me qira e kishte nja dy rrugica më poshtë se shtëpia e vet nē lagjen e moçme tē qytetit. Shpesh kishte ndenjur gjersa fillonte të binte mata. E dëgjonte me kujdes t'i fliste për një sërë gjérash, tē cilat ai nuk i dinte. Pastaj këmbe-nin mendime. Profesori e dëgjonte gjithashtu me vëmendje dhe vlerësonët gjykimet e tij. Kështu kishte lindur një miqësi e çiltër midis tyre.

— Si ia keni shpënë këto vite? — i bëri gati tē njëjtën pyetje për tē dytën herë drejtori.

- Mirë.
- Me profesorët, me shokët?...
- Po.... si me profesorët dhe si me shokët..
Drejtori qeshi.
- Verite dë La Palis¹⁾, — tha.

1) Frëngjisht: E vërtetë e la Palisit — shprehje për diçka tē vërtetë, që duket sheshit.

Buzëqeshi dhe djali.

— Të mirë i keni profesorët?

— Kjo varet... Si ta shikosh... dhe për ç'marrë-dhënie ta gjykosh karakterin e tjetrit...

Drejtori kapsalliti sytë dhe i tha djaloshit:

— Qenke bérë spiritoz! Më pëlqen...

Dhe në të njëjtën kohë, ai mendonte: «Mpreh-tësia e tij sikur ka marrë nuanca të tjera. Koha ka bérë punën e saj...»

— Stefin, Samiun, ke gjithmonë shokë të ngushtë?

— Jo vetëm këta. Klasa jonë është miqësuar më shumë. Vetëm dy-tre qëndrojnë larg. «Qibarët»...

Drejtori qeshi përsëri.

— Qibarët!... — Pastaj, — vazhdoi: U bëtë maturantë. Vitet kaluan shpejt dhe sollën ndryshimet e tyre, si zakonisht. Ndofta, në jetën tonë, në vendin tonë, këto tri vitet e fundit kanë sjellë ndryshimet më të mëdha të kohës... Çfarë fakultet dëshiron të ndjekësh pas maturës?

— Çfarë fakultet!... — tha Pandushi i menduar.

— Letërsinë, besoj.

— Letërsia... Është e bukur...

— Në këtë lëndë ke qenë nxënësi më i mirë. Të këshilloj të studiosh letërsi. Universiteti i Firencës ka fakultetin më të shkëlqyer.

Djalit vetvetishëm i vajti mendja atje. Studentë të letërsisë i kishin folur për Firencen, për universitetin e saj. Pastaj i erdhë ndër mend Parisi, për të cilin kishte éndërruar vite të shkuara. Por këto éndrra tanë ishin venitur.

— Përse mendon? — e pyeti drejtori, duke e parë me kujdes.

— Më duket e pamundur të shkoj në universitet...

— Pse?

— E... Familja ime nuk ka mundësi ekonomike...

Drejtori i hodhi dorën në sup.

— Këtë preokupacion mos e ki... Për nxënësit e mirë ka bursa, — theksoi ai. — Nuk dua të bëhet çështje poshtë e përpjetë, por po të premtoj se qysh tani do të interesohem për bursën tënde. Nuk do të kërkoj një favor, por një të drejtë që të takon plotësisht. — Ai pshërëtiu. — Dëshira ime është që e gjithë klasa të ndjekë studimet e larta. Ka shumë nxënës të mirë. Pothuajse të gjithë. Veç, nuk e di... — Ai qëndroi. — Sapo kam ardhur. Më duhet pak kohë që t'i njoh nga të gjitha anët. — Në këto fjalë, drejtorit iu duk se i kishte shpëtuar ndonjë gjë që nuk duhej. Deshi të mos keqkuptohej — Ti më merr vesh, Pandush — vazhdoi me zë më të ulët. — Kjo kohë ka ca gjëra... Njerëzit, sidomos të rintjtë, bien viktimë pa dashka, nga mungesa e prudencës, nga eksperiencia e paktë që kanë në jetë... Megjithatë, unë nuk dua të besoj gjëra të atilla për nxënësit e mi. — Dhe e ktheu bisedën gjetkë: — Pandush, ti ke qenë një bibliotekë për mua.

— O!... — murmuriti djali.

— Po, po, një bibliotekë e vërtetë mund të them. Kam lexuar faqe të bukura nga librat që më pate dhënë. Tani dua të laj një borxh të vjetër. Nuk më kanë ardhur ende të gjitha plaçkat, gjersë të zë shtëpi... Për ca kohë jam në hotel. Të ftoj të më vish. Në valixhen time kam disa libra inte-

resantë të autorëve kontemporanë. Do të të pël-
qejnë.

— Faleminderit, — tha djali. — Matura është e
ngarkuar me shumë mësime. Po i rralloj një çikë
leximet e tjera.

— Sidoqoftë, shkrimtarët e kohës duhen njo-
hur. Ata sjellin zërin e epokës sonë, krijojnë nova-
cione në art. — Duke parë ngurrimin e djalit, shtoi:

— Po i marr me vete disa libra nesër. Kalo nga
zyra, të t'i jap.

Pandushi u ngrit.

— Më falni...

— Mirë. Dhe nesër eja për librat.

3

Djali nuk i vajti të nesërmen. Ndonëse drej-
tori e kujtoi edhe një herë, ai iu përgjigj se mund
të vinte kur të ndihej i lehtësuar nga mësimet.

Drejtori i ri po njihej pérherë e më shumë
me gjendjen e shkollës. Në sytë e tij po zbulohet
shin të panjohura, paraqiteshin ndodhi shqetësuese,
ngriheshin pikëpyetje. Dy klasat e fundit përbë-
nin shqetësimin e tij më të madh. Atje diçka lë-
vizte. Dhe nuk ishte problemi i tre-katër vetëve,
për të cilët çdo gjë ishte e qartë, por i të gjithë
nxënësve, me përjashtim të disave. E çudiste Pa-
ndushi. Diçka i kishin thënë pér të. Vetë e kishte
vënë re. Që ditën e parë. Pastaj, gjatë bisedës së tij
në drejtori, të nesërmen për librat... Përgjigjet e
djalit ishin të zgjuara, zbavitëse, por... në to a nuk
fshihej një kuptim i dytë? Ç'donte të thoshte me
ato: «Kjo varet... Si ta shikosh... dhe pér ç'marrë-

dhënie ta gjykosh karakterin e tjetrit...» Klasa jonë është miqësuar më shumë. Vetëm dy-a tre qëndrojnë larg... Qibarët...». Ishin miqësuar më shumë! Po, drejt e kishte. Ai e kishte parë disa herë me Nuzin. Dikur, Pandushi nuk kishte pasur shoqëri me të. Ata ndryshonin si zjarri me ujin, që rrjedh i qetë nëpër lëndina. Pandushi rrinte në bankën e parë, Nuzi gjithmonë në të fundit. Ai ishte i dhjetave, ky-nxënës mesatar. Jo se nuk merrte dot nota më të mira: edhe nëntën, edhe dhjetën i kishte marrë kur kishte dashur. I zgjuar ishte. Por dukej se mjaftohej me ato që përvetësonë në klasë, gjatë shpjegimit të mësimit. Në internat nuk mësonte. Çfarë bënte? Dreqi e merrte vesh. Në klasë nuk rrinte keq. Por internatin e kishte sjellë nga dy herë vërdallë. Ishte zënë e rrahur. Kundërshtonte kujdestarët pér ndonjë mungesë. Kishte ngritur në këmbë pér *këtë dhe nxënësit e tjerë*. *Ment ia kishin prerë ate gjysmëbursë që i jepnin. Pandushi me Nuzin! Ci lidhta tanit... Nuk duhej t'i hiqte shpresat nga Pandushi. Tjetër brumë ishte ky djalë. E kishte psikologjisur ai. Nuk mund të futej në ato ujëra.*

4

«Ja, përsëri me Nuzin...», mendoi drejtori tek po dilte nga kuestura. «Ç'kërkojnë këtej?».

Atij i mbetën pezull këto mendime, se një tjetër e tronditi: «Më panë?» Uli kokën më shumë, ngjeshi borsalinën gjer në hundë dhe ktheu me nxitim rrugicën e afërt, që të humbiste nga sytë e tyre. «S'besoj të më kenë njojur...», i dha zemër

vetes. «Po bie errësira...» Disi i qetësuar, ai ndolli mendimet e para: «Shtëpia e Pandushit nuk ësh-të këtej.. Do ta marr vesh nesër...».

Shpejtoi hapat e tij të shkurtër, dredhoi në rrugica të tjera dhe kaloi në rrugën që e shpinte në shkollë. Kishte punë atë natë në zyrë.

Siq shkonte ashtu, kokulur, pa shkuar as dja-tħtas as majtas, sikur t'i shpëtonte dikujt që po e ndiqte, ai nuk pa se nē qoshen e një rrugice kishin arritur pérpara tij dy djemtë. Ata ishin mbështetur pas murit.

— Ai qenka,,, — foli Pandushi.

— Të thashë,,, — theksoi Nuzi.

— C'ka dashur në kuesturë?... — vazhdoi Pandushi me vështrimin nē gurët e kalldrëmit, kur filluan të ecnin ngadalë. — Të jetë bërë vegël e tyre?... S'mund tē ma merrte mendja...

— Mos u çudit, — i tha Nuzi.

— *Kuijt vitet pérpara pushtimit... Na sillej mirë. Apo jo?*

= Ashtu ka qenë, = poħol Nuzi. = Ne iendén e tij nuk riņja dot pa mësuar... Mirépo...

— Si eshtë e mundur? — pyeti Pandushi, sikur këtë pyetje t'ia bënte më shumë vetes.

— I morën mendtë.. I gjetën dobësinë: grata. E dërguan nē Itali. E joshën. Ra nē qejse...

— E ēmbëlsuan..

— Jo vetäm kaq. E degjeneruan, e pérpunu-an mirë. Shokët thonë se eshtë oficer i SIM-it¹⁾.

— Mundet... Të tregova muhabetin nē zyrë. Që atje vura re se ai nuk ishte profesori ynë i dikurshëm. Fjalët e tij, mënyra se si më fliste, pér-

1) Policia politike e fshehtë fashiste.

i drédhjet e lajkat e tij më pështirosën. Ndonëse përpjegj të më paraqitej si dikur, nuk ia arrinte.

Fjalët e Pandushit shprehnin një ndohtësirë dhe një keqardhje. Nuzi po e nuhaste këtë. Ai po e vështronë me bishtin e syrit shokut e tij, që po ecte pa folur. Për Nuzin këto ndjenja ishin të përligjshme. Ai e njihte mirë shokun. Që në klasën e parë të liceut e gjer tani kishin qenë bashkë. I urtë, i ndjeshëm, i ciltër, i dhënë shumë pas mësimeve, disi i myllur, dikur Pandushi jetonte kryesisht me librat, kishte të bënte me një a dy shokë vetëm dhe me ndonjë profesor, sidomos me atë të letërsisë.

«Kohët kalojnë dhe njerëzit ndryshojnë përmirë a për keq, — mendoi Nuzi. — Disa përtërihen, të tjerë veniten... Ka dhe nga ata, të cilëve nuk u ndërron as lëkura, as qimja. Pandushi është nga të parët. Shtresa, karakteri i tij, do ta hidhnin me Lëvizjen. Ai na kuptoi shpejt. U bë një nga anëtarët më aktivë të organizatës sonë».

Nuzi ktheu edhe një herë tërthorazi sytë e tij të mëdhenj dhe vëzhgoi për disa çaste shokun e tij, që tani po ecte me duar në xhepa. Sytë e tij të gjallë, me bebe të zëza sterrë, ishin pak të egra, por të pastra. Tek po soditnin Pandushin, sikur miratonin diçka.

Mbi tryezën e drejtorit ishin tri copë trakte të zhübrosura, ndonëse u kishin shkuar dorën përsipër për t'i shtrirë. Drejtori, në këmbë, me duart prapa, kishte mbetur me sý të ngulur mbi to, si-

kur një magnet i fuqishëm/ ta kishte mbërthyer/ e
të mos e linte të lëvizte. Dy hapa larg tij ishte
profesori i italishtes, që kishte mbaruar studimet
një vit më parë në Romë, me distiktivin e Gufit⁴)
në mostrën e majtë të xhaketës. Profésori shikonte
herë drejtorin, herë traktin, duke pritur një men-
dim, një vëndim që të vepronte. Por drejtorit sikur
i ishte prerë gjuha.

Më në fund, duke rrökëzuar, me një çjerrje në
grykë, ai tha:

— Ishin shumë trakte?

— Gati çdo nxënës kishte një në dorë. Vrapo-
va, po Nuzi, Pandushi dhe Stefi, duket, i mblohdhën
dhe i zhdukën. Nuk i arrita dot. Vetëm këto dy i
gjeta të mbledhura shuk në fund të korridorit.

— S'po duket Gaqi.., — tha drejtori.

— Po vete ta kërkoi... — u hodh tjetri dhe,
sikur t'i kishin shkelur një sustë, u nis me hapa të
mëdhemj, me atë trup që dukej si një trung druri
i vendosur mbi dy trarë.

Drejtori filloi të vozitë mëpër zyrë, ndërsa
mendja i vërtitej si një qerthull. I shfaqeshin dhe
i zhdukeshin si vetëtima fytyrat e nxënësve. Dy
prejtësia i ngelën mësy dhe po e shikonin quditë-
risht. E pàra, fytyra katrorë e Nuzit, me atë gojë të
shtrënguar, me ata sy që nuk i duronte dot. Pastaj,
fytyra e Pandushit, që dridhej. Ajo i shfaqej me dy
pamje. Një herë më e zbehtë; fare e qetë dhe ën-
dërruese; një herë, hijerëndë, e menduar, hetuese.
Por, në të dyja këto pamje ai shikonte të përbash-
këta: gjiltërsinë dhe vullnetin. Këto i shkrinin në
një të dyja pamjet e fytyrës së tij.
Qëndroi i kthyer/inga dritarja e zyrës dhe mori
frymë rëndë. Sikur iu lehtësuat disi ajo peshë

që ai ndiente në lugth. Përpara syve të tij çelëj fusha e zymtë, mbi të cilën ulej qelli i përhimë i nëntorit. Në afersi të shkollës, plepat kishin shkundur gjethet dhe qëndronin drejt me lakuriqësinë e tyre, që i solli drejtorit një mornicë nëpër shpinë. Por rögovecat ruanin ende disa gjethe të gjelbra. Kjo i pëlqeu. I vinte mirë që ato gjethe të mos binin kurrë.

Ai nuk ndjeu që u hap dera e zyrës. Dëgjoi vetëm zërin e profesorit të italishtes:

— Zoti drejtor...

U kthye si me përtim, dhe pa, pranë profesorit shërbëtorin e shkollës, me ato pantallona të arnurë në gjunjë, që i zbrisnin si shallvare të gjera.

— Ç'bëre, Gaqi? — pyeti drejtori.

— S'ka gjetur asnjë..., — u përgjigj në vënd të shërbëtorit profesori.

— Si është e mundur?

— Pashë në tërë anët. S'ka..., — mbledhi supet Gaqi.

— Ik, — i tha drejtori.

Si u largua shërbëtori, profesori i foli drejtërit, që po qëndronte në mes të zyrës kokëvarur.

— I kanë fshehur, i kanë zhdukur, ju thashë...

— Çfarë duhet të bëjmë? — pyeti drejtori; pa e vështruar profesorin.

— Masa të menjëherëshme...

— Këtë e kam vendosur. Po kundër kujt?

— Nuzit, Stefit...

— Këta do të janë të parët. Ai Nuzi...

— Eshtë koka e tyre, — nxitoi të plotësonë profesori.

— E kam të qartë. — Drejtori heshti, pastaj pyeti: — Për Pandushin çfarë mendim ke?

— Dyshoj edhe për të, ndonëse në mësimet e
në sjellje është nga më të mirët. Ju tregova si iku
me Nuzin dhe Stefin.., Kam vënë re që më Nuzin
ka relacione të ngushta...

— Por, për ndonjë masë kundër tij, nuk kemi
prova të mjaftueshme, — tha drejtori.

— Pooo..., — foli i menduar profesori, — hë-
përhë nuk jam për ndonjë masë. Nxenësit që do
të mbeten, do t'i orientojmë, atyre do t'u sinjali-
zojmë pasojat, përfundimin e rebelëve...

Drejtori u çapit drejt karriges së tryezës së tij.
Qëndroi dhe u kthyte nga profesori.

— Mund të shkosh. Do të të thërras më vonë.

Profesori u përkul dhe murmuriti me një theks
hündor.

— E kam merak vetë, zoti drejtor. Më falni...

— Dhe doli, duke bërë disa hapa prapa.

Drejtori mori telefonin e linjës që e lidhte
drejtpërdrejt me kuesturën.

Atë mëngjes u përhap në shkollë së ikishin
dëbuaritetë nxenës: katër të klasës së fundit, tre
të sëparafundit dhe një të klasës së gjashtë.

Kuestori, më kostum civil, më këmishë të zezë
dhe me çizme të lüstrosura, erdhë në shkollë dhe
bëri mbledhjen e tri klasave bashkë, në prani të
drejtorit e të profesorëve. Ai filloi të fliste butë,
por nuk e fshihte dot shqetësimin e tij. Pastaj,
ngriti zërin ca nga ca, ngriti gjithashtu dorën e
djathtë e gishtin tregues dhe thirri, u skuq, nxori

stërkala pështyme, kërcënoi. Në klasat e tjera nxënësve u foli drejtori.

Katër nga të dëbuarit i arrestuan. Nuzin dhe Stefin i shpunë në kuesturë; të tjerët në karabiniieri.

Midis nxënësve filluan të qarkullonin fjalë mbi të arrestuarit. Thoshin se po u bënин tortura të mëdha. Stefi ishte keq. E kishin shpënë në spitalin e burgut.

Shkolla nuk ishte e qetë. Fytyrat e nxënësve ishin vrenjtur. Profesorët flisnin mënjanë me zë të ulët, me një farë ankthi.

Aktivi i Rinisë Komuniste ishte vënë më shumë në lëvizje. Nuzin, sekretarin e tij, e zëvendësonte tanë Samiu, një djale me fytyrë të gjatë, me flokë të zinj të shtruar, që fliste me fjali të shkurtër, me një logjikë vepruese. Ai sillte njoftimet dhe udhëzimet e Qarkorit të Rinisë.

Të arrestuarit qëndronin të paepur. Qarkori kishte mundur të lidhej me ta. Tani duhej të shtoheshin aksionet. Fashistët duhej të merrnin vesh mirë se nuk ishin vetëm disa nxënës, por tërë shkolla ishte një depobaruti, që do të shpërtheonte dhe do ti groposte ata.

Mbledhja e fundit e aktivit u zhvillua më e gjallë. Folën tërë të rinxjtë. Pandushi ndiqte një për një fjalët dhe mendimet e tyre. Ai i mirafonte ato. Kishte ardhur koha për veprime më të mëdha, mendonte. Armikut i duheshin dhënë goditje më të rënda. U duhej rënë kokës spiunëve, cilëtdo që të ishin ata.

Mbledhja mori vendim dhe ndau detyrat.

Ndonëse kishte ndenjur, vonë natën me Zefin, profesorin e italishtes, duke u këshilluar dhe duke marrë në shqyrtim nxënësit, dhe profesorët e dyshimtë të liceut, drejtori ishte ngritur herët në mëngjes për të shkuar në shkollë, dhe për të perfunduar reportin që i kërkonte atë ditë kuestura. Nga ora nëntë, i kishin thënë, do të dërgonin një agjent për ta marrë.

Ai ndihej i lodhur dhe i turbullt. Koka i rëndonte. Telashe të shumta po e mundonin dhe siç dukej, ato po shtoheshin. Një parashikim të tillë nuk e kishte bërë dot. Të tjera i kishin folur dhe të tjera po ngjissnin. Nuk ia kishte marrë mendja se punët do të arrinin gjer këtu. Ato që kishin filluar të ndodhnin, ia kishin parashtruar dhe ai i kishte menduar si punë kalamajsh, që do të ndryshonin me ndyrhyrjen më të vogël. Dhe përsëri do të vinin prehja e kënaqësia. Puna dhe shërbimet e tij do ti' mritnin vlerën e pas kësaj, transferimi, gradimi, përsëri Italia...

Mirëpo...

Ai po i afrohej shkollës. Ishte herët dhe mëngjesi dukej i qetë. Donte të hynte në zyrën e tij dhe të mbaronte raportin pa i dalë përballë asnjë nxënës, asnjë profesor. Takimi me ta e shqetësonte, e hutonte, sikur i priste energjitet. Nuk, donte të shikonte njeri. Do të kyçej në zyrë dhe do të punonte në atë freski mëngjesore.

Por qetësinë e kërkuar nuk e shijoj dot. Para se të ngjitte shkallët e jashtme, në murin përballë lexoi: *As kërcënimet, as torturat nuk i mposhtin revolucionarët! Vdekje fashizmit! Liri popullit!*

Shtangu në vend. Këto fjalë të tmerrshme, të shkruara me bojë të kuqe e me shkronja të mëdha, sikur ia këpüten gjunjët.

Mbeti ashtu disa çaste. Pastaj mbloodi veten, hyri me vrap në shkollë dhe zuri të thërriste në rruginën e saj:

— Gaqi! Gaqi!

Zëri i tij jehonte në zbrazësirën e ndërtuesës, por shërbëtori nuk dukej gjékundi.

Si i shkalluar, vrapoi nëpër rruginë, kapërcëu shkallaret, hapi dyert e klasave, duke thirrur gjithnjë.

Gaqi nuk po dilte.

Zbriti në bodrumet e shkollës, shkeli nëpër coprat e dërrasave dhe në rrangullinat e tjera, kapela iu mbulua me cerga merimangash. Shërbëtori nuk ishtë as këtu.

— Gaqi! Gaqi! — u zgjat zëri i tij.

Kur po kthehej nga bodrumi krahëprerë, në rruginën e katit të parë u duk shërbëtori.

— Në çvrimë ishe futur? — i klithi atij. — C'mi ke lënë ato shkronja komuniste në muret e shkollës?...

— Zoti drejtori!

— Fshij! shpejt! Atje, jashtë!...

Gaqi mori një kovë me ujë dherua hodhi shkronjavë.

— Tutku! — bërtiti drejtori. — Të plasën sytë! Nuk shikon se është bojë vaji? Më ujë do të fshihen?

— Me se?...

Nuk dinte ç'të bënte. U turbullua. Mori një gur që e gjeti atje jashtë dhe nisi të gërvishjtë shkronjat, në kulm të dëshpëritit.

— Hë, po më grrri?! — iu kthyé sherbëtorit,
i cili po është shikontët më i vjetër?

Ndërkao kishin filluar të vinin në shkollë
nxënësit dhe profesorët. Ata lexuan çka ishte
shkruar mbi mur.

Brenda! Brenda! të gjithë! — iu kanos atyre
drejtori. — Zef, mos lër njeri jashtë!

Profesori i italishtes, i bërë flakë në fytyrë,
filloj t'i shytte nxënësit.

— Nëpër klasa! Nëpër klasa! Shpejt!

— Është hérët!

— Hyr brenda, të them! Pis!

— Mos prek me dorë!

— Mbaj gojën!

Një grumbull nxënësish nuk po lëviznin.

— Do të hyni apo i t'ju futem me shqelma?!

— U hakëfrua Zefi dhe çakarriti sytë me kokërdhokë të mëdhenj.

Pse iflet me këtë gjuhë? — ndërhyri Pandushi.

— Pandush, edhe ti?!

— Ç'po bëjmë? — tha qđiali. — Ti imblidh gjuhën! Nuk ke asnjë të drejtë të shash!

— Pa fjalë! — bërtiti Zefi. — Jeni rrugaçë!

— Mbaje përvete këtë fjalë!

Zefi u afroja i dhe ngriti dorën. Në këtë çast, drejtori, që përpiquej të shuanë shkronjat e kuqe mbiomur, lu hodhi në mës tyre.

— Qëndro, Zef! Ngjitu në zyrë dhe merr në telefon.

— Ai i zgjati tjetrit çelësin, që është nxori nga një kuletë. U mundua të përbante shqetësimin dhest'udrejtohej nxënësve më butësi:

— Hyni, djema! Hyni. Po vete ora e mësimit.

U dëgjua buçimë makine! Në të përpjetën drejt

shkollësu duk një veturë e vogël, me mbulesë mu-shamaje, e lyer njolla-njolla në ngjyrë të hirtë e të legjelbër.

— Karabinieria, — tha një nxënës.

Nga makina zbritën një marshall e tre kara-binierë. Ata iu drëtuan murit ku skuqnin shkron-jat. Fjalia e parë ishte ciflosur vende-vende. Parulla e fundit ishte e pëprekur dhe ngjyra e shkronja-ve, mbi të cilën binin rrezet e para të mëngjesit, vezullonte:

Vdekje fashizmit! Liri popullit!

* * *

! Në mbledhjen e aktivit të rinisë, që u zhvillua atë pasdite, kishte ardhur i deleguar i Qarkorit të Rinisë Komuniste një djalë i shkurtër, faqethatë, me kasketë në kokë, të cilën nuk e kishte hequr as gjatë mbledhjes. Pandushi e njihte. Punonte në dyqanin e një këpuçari.

I deleguari i përgëzoi për aksionin e parulla-ve dhe për qëndrimin që kishin mbajtur kundër karabınierisë.

— Por, mos kujtoni se odo gjë është mylli, — tha ai. — Këtë radhë nuk arrestuan njeri. Ç'është e vërteta, fashistët e kanë humbur toruan. Kujtuan se, me burgosjen e Nuzit, të Stefit dhe të shokëve të tjerë, si edhe me dëbimin e disa nxënësve, kishin në dorë gjithçka dhe se do ta mbytnin lëvizjen në shkollë. Tani po hanë goditje të tjera. Nuk dinë ç'të bëjnë. Duan të mderrojnë taktilë, t'ju marrim me të mirë, t'ju hedhin thi syve, por këto nuk do t'u shkojnë. Së fundi, nuk përjashtohen arrestime të

tjera. Prandaj aksionet duhet të vazhdojnë. Ato i tmerrojnë fashistët, ua mbledhin edhe spiumëve, që kanë hall të ruajnë lëkurën. Nga ana tjetër, i çoroditin dhe krijojnë, si mund të themi, kushte lehtesuese për shokët e arrestuar: lëkundet mendimi i fashistëve, se janë vetëm ata organizatorët e aksioneve:

— Si janë Stefi, Nuzi?... — pyeti Pandushi.

— Stefi ka qenë rëndë. Plagë ia kanë bërë tërë trupin, — u përgjigji i deleguari. — Por kemi mundur të lidhem i me një shok infermier që i shërbim. Ai kujdeset shumë dhe i shpie fjalët tonë. Moralin e ka të lartë. Kurse Nuzi mbahet fort. Dy të tjerët, që janë në karabinieri, thonë se do ti i internojnë bashkë me një grup shokësh të arrestuar prej kohësh. — I deleguari ndaloi, pastaj shtoi: — Duhet vepruar me kujdes. Të mbahet shumë konspiracioni. Të keni mendjen nga grerat. Atyre që dihen, Zefit, drejtorit, të birit të prefektat, u ruhen kollaj. Duhet pasur mendja nga ndonjë thëngjill i mbuluar.

Fjalët e fundit Pandushi i dëgjoi më me vëmendje.

— Drejtori përpinqet të lozë rolin e të pafajshmit, — shpjegoi i deleguari. — Mundohet t'jua shkojë ujin nën rrugoz. Por është ujk. Raportet e tij kanë shkuar njëri pas tjetrit në kuesturë. Ai ka marrë pjesë edhe në pyetjet e torturat e Nuzit. Por, edhe ai, edhe të tjerët, do ta gjejnë vendin.

Pandushini e përshkoi një tronditje: Ndjeu faqet e nxeheshin. Ai përfytyronte Nuzin, dhe Stefir, të torturuara. Nuzi mbahet, ishte i fortë shumë, kishte trup që nuk epej lehtë dhe shpirt të parposhtur. Mund t'u hidhej fashistëve në grykë

e t'i shqyente. Nuk kishte dyshim as për vendosmërinë e Stefit. Por ky kishte shëndet të dobët. Ishte sëmurur disa herë. Ndaj dhe torturat e kishin sfilitur shumë.

Faqet e zbehta të Pandushit u përskuqën. Vështrimi i tij mori një hije të rëndë.

Drejtori ishte... ujk. Ai kishte raportuar në kuesturë, kishte marrë pjesë kur kishin torturuar Nuzin. Çfarë nuk po zbuloheshin për të!.. Pas trikatër vjetve... Për një çast djaloshit i dukej çudi, disi e pabesueshme. Profesori i tij i letërsisë i dilte në sy me buzë në gaz, dëgjonte zérin e tij, të shtruar, thua të përzemërt, shihte kujdesjen e tij për nxënësit...

Vetëm trëkatër vjet kishin kaluar që atëherë... Dhe gjithçka kishte ndryshuar... Në dukje ndofta jo aq shumë, por në brendi...

I deleguarji i Qarkorit kishte të drejtë. Drejtori mundohej të trëgohej i dashur e i sjellshëm me nxënësit. A nuk kishte bërë ashtu edhe me të; që sapo kishte ardhur në shkollë, kur e kishte thirrur në zyrën e drejtorisë?

Natën Pandushi kishte kaluar thuajse pa gjumi. Kishte menduar përmirëngjarjet në shkollë, për të internuarit, që i kishin nisur, për Stefin, që nuk e merrte veten... Dhe për atë...

Pas dëbimit dhë arrestimit të nxënësve, në shkollë ishte krijuar një gjendje e re. Nëpërruginat, dhe klasat kishte më shumë urrejtje, zemërim, dhe etje për ndeshje. Nxënësit flisnin, ko-

kë më kokë, në pushimet, pëshpërisnin, në bankat gjatë orëve të mësimit. Drejtori ishte bërë nervoz. Ai shkonte vazhdimisht klasë më klasë, dilte e i binte shkollës rrëth e qark... Pandushi kishte ndjekur sjelljet dhe shndërrimet e tij qysh në takimin e parë me të. Natën që shkoi, ai përsëri bëri krahasime midis profesorit të dikurshëm të letërsisë dhe drejtorit të sotëm. Dhe mendoi për fatin e njeriut. Ku mund të kataniset! Ai profesor, në dukje i butë, tashmë ishte bërë një bishë. A ishte e mundur kjo? Kështu flisnin punët. Përse? Kush e kishte fajin? Egoizmi i tij, lavdia, kënaqësia e një shijimi të lehtë të jetës, frika? Ndofta të gjitha nga pak. Ishte si një mish llurbë, pa kocka? Apo një i patëkeq, të cilit ia hedhin si një fëmijë? Jo, i tillë, nuk ishte Por, një i dobët, një i flashkët... Kjo, po... Kurse tani kishte bërë dhe ishte gati të bënte poshtësi e krimet. Dhe djali kishte menduar më tej: Njeriu i dobët, pa ideale të mëdha, pa vullnet të fortë, i prirë ndaj endjeve të vogla e të fëlliçura, egoiste e ledhatare, merret nëpër këmbë dhe bëhet pre e mbartësve të së keqes. Ai niset në një rrugë, së cilës nuk ia di fundin, dhe ndofta nuk e dëshiron. Dhe ja secili na qenka ky fund! Donte, nuk donte, nuk iu shmaang dot. Atje e shpunë këmbët. U bë vegël e pushtuesve, u vu kundër nxënësve dhe kundërmëndit të tij. Në këtë fund, atje e shpanët, si bë Por, tej këtij fundi çfarë kishte? Çfarë e priste atë? Logjika ka dy anë të saj.. A mund t'i shmangeti anës tjetër? Në këto pyetje e kishin kapitur mendimet dhe pagjumësia djalina. Ai kishte një mllif dhe një dhembje.

...Ajri i ftohtë i mëngjesit, ia kishte mbështjetë llë fytyrën, tek po e cte rrugës, ashtu, si pa qëllim. Ishte e diel. Në ato orë nuk kishte ndonjë punë. Afër drekës kishte lënë një takim me Samiun.

Donte të endej atyre rrugëve, ku kishte pak lëvizje.

Kur, ja, pranë një shtëpie elbasanë i doli përparrë ai.. Dhe i foli:

— Mirëmëngjes, Pandush!

E pa. Vinte, siç dukej, që poshtë, nga tregu apo që diku gjetkë... Kishte veshur një pardesy gabardine të trashë, ngjyrë hiri të errët, kurse në kokë kishte borsalinën e zakonshme.

— Sa mirë! — foli prapë. — U takuam përparrë shtëpisë sime të re. Të pëlqen? Kam një javë që e kam marrë... Rasti që të më bësh një vizitë. Kam mallin e atyre viteve... Dua të përsëriten... Eja, Pandush!..

Djali u shqetësua. Deshi të shpëtonë prej tij.

— Më falni, por kam një punë të ngutshme, nuk vij dot...

— Oh! Mos ma prish! — i tha ai. — Dy minuta vetëm. Sa të të tregoj apartamentin tim. Eja...

E zuri djalin për dore dhe e tërhoqi. Ajo dorë iu duk Pandushit e ftohtë dhe e flashkët, sikur një rreckë e qullët u mbështoll në pulsin e tij. Bëri ta tërhiqte, por, si një legëtyrë që të përdridhet e nuk të shqitet lehtë. ~~dora e drejtorisit mbeti e ngjashme pës së aqes. Kombelet i zvarriti pa veçëdje është hyrë në shtëpi.~~

Ndërtesa njëkateshë, me qilarë të lartë përposhtë, kishte një cardhak të mobiluar, një dhomë pritjeje, dhomat e punës dhe të gjumit të drejtorisit.

Si ia tregoi të gjitha, ai i tha djalit:

— Ejə tē shikosh bibliotekēn time. Tani e kam
tē pasur. Siç tē premtova nē takimin tonē tē parë,
do tē tē laj borxhin tim tē vjetér.

Duke buzëqeshur, i shpjegoi llojet e ndryshme të librave, që mbushnin raftet. Dollapi i bibliotekës ishte i ri dhe shndriste nga lustra.

—A e ke lexuar d'Anuncio? — pyeti drejto-
ri.

isaib — ñr.

— Më pëlqen shumë. Është i madh. Kam komplet veprat e tij. Do të t'i jap me gjithë qejf, që të njohësh penën e tij të fortë. Është shkrimitar klasik dhe modern. Do ta shikosh. Do të më japësh të drejtë. Do të flasim shtruar.

Pandushit i vrah veshin emri i d'Anuncios. Rrotulloj sytë. Mbi bibliotekë pa një portret të tij me shënimin nën të: «Il poeta soldato»¹⁾. I hoqi sytë nga fotografia dhe theksoi:

— Ju thashë që nxitoj.,

— A, më vjen shumë keq, — e ndërpeu drejtori. — Nuk do të më bësh një urim të vogël përapartamentin? Ulu, de, Pandush. Dikur ke qenë shumë i dëgjuar, — vuri ai buzën në gaz, duke lëshuar mbi tryezën e mesit dy gota dhe një shishe.

E kapi djalin për supesh me të dyja duart, e detyroi të ulej në njërin nga kolltukët e dhomës dhe i zgjati gotën e mbushur.

— Nuk pi, — tha Pandushi.

Një vermut i bardhë... — foli drejtori. —
Bëne fare i katë. — Ngati gatën e tij. — Mës se
të vish kurdherë në shqipinë time. Dyert i ke
githmonë të hapura.

— Gëzuar, — foli ngadalë djali dhe sa e çiku gotën në buzë.

Drejtori e kuptoi se ai nuk do të qëndronte gjatë. Ndaj nxitoi t'i shprehte qëllimin e tij:

— Pandush, më jepet rasti për dy fjalë me ty, për të kërkuar edhe mendimin tënd... Do të flas shkurt, por ti do të më kuptosh, jam i sigurt. Sa gjëra të papëlqyera kanë ndodhur në shkollën tonë! Janë një turp e një vandalizëm! Ç'kërkojnë disa rebelë? Të prishin qetësinë, të lënë pa mësime, të marrin në qafë nxënësit me edukatë dhe të mirë? Jo, nuk do ta bëjnë dot. Ata morën atë që meritonin. Por... fatkeqësisht, dûket se ka dhe të tjerë. Dhe një dru i shtrembër prish gjithë barrën, thotë një fjalë. Ata bëhen shkaktarë që të pengohet programi i mësimit, madje të mbyllët shkollë. Po, po, kjo mund të ngjasë. Ti je në maturë, por nga anarshizmi i disave rrezikohesh të humbasësh vitin. Në vend të shkosh në universitet, të përsëritësh klasën, ti, nxënës i shkëlqyer, për shkak të disa horrave. Siç të kam thënë, po interesohem për bursën tënde. Kam bindjen se do të të jepet për njërin nga universitetet më të mira të Italisë. Ndihmomë, pra, të vëmë rregullin në shkollë, të evitojmë humbjen tënde dhe të nxënësve të tjerë të disiplinuar.

Pandushi po e vështronte drejt. Kishte përparë këtë fytyrë me turinj të zgjatuar, me hundë me majë të mprehtë, me sy të vegjël nën vetullat e trasha, me dy të prera në faqet, nën mollëzat. Dalloi se tërë indet e kësaj fytyre ishin të ndera. Nuk e kishte hetuar ndonjëherë kështu si po e hetonte tani. Dhe për të parën herë kjo fytyrë iu dûk si një ndërthurje e përdredhur damarësh e eshtrash, nëpër të cilën fshihej një dinakëri e një dëshirë

e ndezur egoiste. «Pse dikur kishte një pamje tjetër, që të têrhiqte?», mendoi djali.

Ai vazhdoi ta hetonte. Ata sy si detka dhe ato buzë të prera drejt e gjysmë të hapura, prisnin me padurim fjalën e tij.

— C'kérkon i prej meje? — pyeti djali.

— Asgjë të madhe. Diçka të thjeshtë. Të bëshkëpunojmë për të zbuluar se cilët janë rebelët që kanë mbetur në shkollë. Ti mund të më ndihmosh shumë për këtë...

Këtë e kishte pritur, e kishte kuptuar djaloshi qysh më parë. Për këtë i ishte vërtitur ai tërë këtë kohë. Kurse tani po ia thoshte troq...

Kishte marë fund çdo gjë. Një zhgënjam i egër i ndyrë. Përballe tij djali kishte një fëlliqësirë, por dhe një bishë. Atë e kishin dërguar fashistët drejtor të shkollës për të zbuluar dhe zhdukur ata që ishin ngritur në luftën e drejtë. Ai ishte agjent i tyre. Kishte çuar një burg e në tortura gjithë ata nxënës. Dhe kërkonte të tjerë.

Këtu kishte mbaruar ish-profesori i tij i letërsisë, pas tri-katër vjetëve.

«Drejtori, përpiqet të lozë rolin e të pafajshmit», i tingëlluan në vesh fjalët e të deleguarit të rinisi. «...Por është ujk... Edhe ai edhe të tjerët do ta gjejnë vendin.»

«Ashtu sic e kanë gjetur gjithë spiunët», mendoi djaloshi. «Dhe ky i tillë është.» M'u duk si e çuditshme, si e pamundur kur më tha Nuzi se flitej që është oficer i SIM-it... Por ashtu ishte.

Tek po ngrihej, dora e majtë i ndjeu në prekje fortësinë e armës që kishte nën pallto. Në brez ai mbante tani revolen: që i kishte lënë Nuzi. Kur kishin vajtur në internat për ta arrestuar, ai ia ki-

shtet kaluar fshehurazi revolen një shoku dhe i kishte pëshpëritur që t'ia dorëzonate Pandushit.

«Çfarë duhet ta presë një agjent të tillë? — tha me vete djali... — ai... do ta gjejë vendin...», i tingëlluan edhe një herë fjalët e të deleguarit, «Nga kush?», mendoi djaloshi. Dhe shtoi: «Nga ata që kérkon tu bëjë varrin».

— Hë, Pandush, nuk po më përgjigjesh? — i folli drejtori.

— Përgjigja ime është kjo, — tha djali, duke i drejtuar revolen.

Drejtori u pre në fytyrë. Ai më shumë po habitej nga ajo që po i shikonin sytë. Ç'ishte kjo?! Pandushi?!

— Pandushi... ti... — belbëzoi, pa ditur ç'të thoshtite.

— Kjo të takoni ty, i poshtër! — theksoi djali.

— ... Bën shaka?... A është e mundur?... — nxori të copëzuara këto fjalë drejtori, duke u ngritur me vështirësi nga kolltuku.

— Ne nuk bëjmë shakë, ashtu si nuk bëni ju me ne. Ti je agjent i SIM-it. Ti dërgove në burg e në internim shokët tanë. Ti e bëre për vdekje Stefins.

— E ke gabim, Pandush...

— Do ta mohosh, ë? Përse më thirre në zyrën tënde që sapo erdhe, përse më fute sot në këtë shtëpi, çfarë kérkon prej meje? Të bëhem spiun, të trádhetoj shokët, «të zbulojmë rebelët»? Ja, pra, ku i ke «rebelët» që kérkon.

— Pandush... unë për ty...

— Po, do të më dërgosh në Itali, në universitet, po të të shërbej. Qelbësirë, me gjithë universi-

tetin tënd! Për ne universitet është sot lufta për liri!

Djali hoqi këmbëzën e armës. Një krismë e thatë mbushi dhomën.

Drejtori u lëkund dhe u mbështet pas bibliotekës. Pastaj, vari kokën dhe u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.

U mbështet me shumë qëndrueshmëri, me shumë vlerësim, me shumë empati. Nëse nuk ka qenë një vëllim i tij, do të jetë një vëllim i tij.

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

“Duke u përmbyt mbi parketin e verdhë, që u skuq nga një vazhdë gjaku. Pranë tij ra nga biblioteka dhe iu thyte xhami portretit të Gabriele d'Anuncios.”

KEPUCET

— Më falni, se ndonjë nga shokët mund dhetë këtë dëgjuar këtë histori, por... — kështu e filloi tregimin e tij Nezhdeti.

Ai e kishte fjalën, sigurisht, për nja dy, të cilëve ua kishte rrëfyer kur kishte ardhur rasti. Por, kur ndodhë që shokë të tjera të ishin të pranishëm, sidomos ndonjë i ri, i porsanjohur, dhe biseda binte mbi ngjarje dhe njerëz të luftës, Nezhdeti nuk përtonte ta tregonte përsëri, madje dukej se ndiente kënaqësi, se ndillte kujtime të shtrenjta, të cilat ishin bërë, tashmë, pjesë e pandarë e jetës dhe e ndjenjave të tij.

Atje në froni e gurtë të lulishtes, më të dalë të qytetit, ku ishim ulur, binin hijet e pishave, të plepave e të shelgjeve lotuese. Ishte një kënd i qetë kundërmues nga erërat e tërfilit dhe zhumbropicës ato ditë maji. Ky kënd ngjallte frymëzime e sillte kujtime.

Nezhdeti vazhdoi:

...Me të isha njojur prej vitesh. Bashkë kishim punuar në postën e qytetit. Dy nëpunës të vegjël me nga një rrogëzë që avullonte, pa e marrë

vesh, brenda dy javëve. Ai ishte i ri. Unë kisha gati dyfishin e viteve të tij. Por puna na njoju dhejeta na afroi. Qanim hallet. Unë kisha një barë të madhe në shpatulla: Prindërit, të cilëve nuk u bënë këmbët e duart dhe një motër të vogël, së cilës i kishte kaluar qëkur koha kur mbleskat mund të vinin, e të trokitnin te dera e shtëpisë. Merreni me mend. Edhe ai nuk kishte më pak halle. Vec që ishte i ri, dhe, si i thonë, i riu si veriu. Ishte shpuzë në punë e në llaf, i dhembur për shokë. Bisedonim e shoqëroheshim dendur. Ai, së pari, më foli për komunizmin, më mori, në demonstratat në prag të 7 prillit, më tha se duhej ta luftonim fashizmin me çdo mjet, kur tanket italiane mbushën rrugët e qytetit.

Pask kohë pas pushtimit, atë e hoqën nga posta. As e pranuan në ndonjë nëpunësi tjeter. Mbeti pa, punë, pastaj hyri si punëtor në gurore, më vonë në punishten e pijeve, dhe, në fund, në një sharrë qëresteje. Por, me sa shikoja, ai, merrej me shumë punë të tjera. Edhe mua nuk i ma zgjatën në postë. Pas një viti e ca më vunë drutë. Mezi gjeta një copë vend si ndihmësllogaritar, në dyqanin e një tregtarit të madh, të konfekzioneve, dhe kinkalerisë.

Këto rrerhatari i gralluan takimet tonë. Megjithatë, shikoheshim herë pas here.

Po shkoja pazarit përmë dyqan, kur ndjeva, një mëngjes, të më thérresin nga prapa: "Nezhdet! Nezhdet!" O, Ndireko! Ishte ai! M'u afroa Dukej se e kishte me ngut, përfqendroi disa minuta. "Fillove punë?" — më pyeti.

— Fillova.

— Sa tē paguajnë?

I tregova.

— Pak, shumë pak, — dhe mblođhi sytë, në cepat e tē cilëve u bënë ca rrudha. — Ata nxjerrin sa tē pēlcasin, — tha pastaj, — po i gërryejnë napolonat me lopatë, nga çmimet që i ngrenë çdo ditë, por punëtorit nuk i japid as sa tē ngopë barkun me bukë. Häm! Eshtë akoma koha e tyre. Dhe fashizmi ka lëshuar mijegull pér ujxit. Por do t'ua hedhim nofullat!

— Ti nga merresh? — e pyeta.

— Në gurore, — m'u përgjigj shkurt dhe nxitoi.

Dredhoi rrugës së pazarit pér në fushë.

— Ç'ne këtej pér në gurore!, mendova. Siç e dini, gurorja ka qenë prapa Kodrës së Thatë. Ku-shedi kú e shpinin punët e tjera tē tij...

Një kohë pas këtij takimi, erdhi e më kërkoi në dyqan. Unë punoja në një tryezë përballë hyrjes. Ma bëri me sy që në prag dhe ktheu qoshen.

— Dua tē fjalosemi një çikë, — më tha, kur dola jashtë. — Merri leje afendikoit.

Ky mezi më lejoi pér nja dhjetë minuta. Ishte drekëherë. Kaptuam rrugicat dhe shkuam nga pazar i peshkut. Fund korriku a fillim gushti ishte. Dielli digje. Tezgat e peshikatarëve ishin bosh. Megjithatë, nëpér afshin e së nxeh tës çohej era e mbutur e cironkave.

— Dëgjo, Nezhdet, lufta po ndizet, — filloi tē më thotë. — Do tē ngrihen në këmbë i madh e i vogël. Asnjeri nuk duhet tē ngelë. Edhe ti duhet tē gjallërohesh, tē lëvizësh, tē futesh në luftë. Kështu vetëm do tē shpëtojmë. Të gjithë po organi-

zohen. Edhe nëpunësit e vegjël po mblidhen. Ti do të bësh pjesë me nëpunësit privatë. Pas ca ditësh, do të vijë një shok të të takojë. Besoj ta njohësh. Sidoqoftë, ai do të të thotë se vjen nga ana ime. Ti do të kesh lidhje me të kryesisht. Kështu, haj, me të mira, shko se mos të të shajë afendikoi. Edhe unë kam punë. Pleqtë si i ke? — më pyeti para se të ndaheshim.

Ca hallet e familjes, ca, ndofta, ngurrimi e vëçimi im, më kishin lënë një çikë në periferinë e ngjarjeve të rëndësishme, që po merrnin fill. Gjendja e prindërve bashkë me merakun e tyre përmotrën e mbetur në derë, kishin bërë që të thithesha nga andrallat e atypératishme të ditës dhe të jetës së vështirë. Ngjitesha me kokë të rënduar në shtëpi dhe nuk dija c'përgjigje për një zgjidhje të shpejtë e të kënaqshme t'u jepja. Por dora e madhe që ishte ngritur në atë pështjellim të paparë të kohës, nuk mund të më linte si një gjeth të shkëputur që e davarit era. Ajo më mori dhe më futi në mes të të tjerëve, më ndihmoi t'i njihja, t'i kuptoja dhe të lidhesha me ta në një varg të vetëm:

Hyra në marrëdhënie me shokët, siç më kish te porositur Ndrekova. Shkoja në mbledhje, bisedonim për gjendjen e brendshme e të jashtme të Luftës, punonim broshura teorike, përcaktonim se si mund të aktivizoheshim.

Ndrekon nuk e kisha parë prej ca kohësh. Pyëta një nga shokët, i cili banonte në një mëhallë me të. Më tha se edhe ai rrallë e kishte parë dhe së i kishte vdekur i ati. E kishte pllakosur një hall më i madh! I ati ishte murator dhe xheq nxirrte edhe ai. Tani në krahët e Ndrekos ishin

varur të gjithë: e ëma dhe tre fëmijët e tjerë të familjes.

E takova pak më vonë në një mbledhje. Ishte dimër, janar i 1943-së. Erdhi e na foli kryesisht gjerë e gjatë për situatën politike. Kishte veshur një pallto, të kojtur treçerekëshe ngjyrë hiri dhe kishte rrasur një kasketë në kokë. Ishte dobësuar, dhe fytyra, me atë hundë të vogël, i kishte mbetur sa një pare. Më pyeti gjerë e gjatë për njérën e për tjetrën. E ngushëllova për vdekjen e të atit dhe për hallin e tij. Mbeti i heshtur, me vështrimin diku, pastaj m'u përgjigj:

— Jeta është luftë, Nezhdet. Por kjo, tanë, është lufta jonë më e madhe. Po e fituam këtë, kemi fituar të gjitha luftërat. Dhe do ta fitojmë me siguri!

— Po, të vegjlit e tu?...

— Disi do ta kalojnë edhe ata...

Dhe ai filloi të fliste në mbledhje. Ndër të tjera, tha se së shpejti do të organizoheshin sindikatat ilegale. Kjo do të ishte një arritje e rëndësishme e punonjësve. Me luftën politike, me luf-tën e armatosur, duhej të gërshtetohej edhe ajo për të drejtat ekonomike. Padronët nuk duhej t'i linim më të dridhni valle mbi kurrizin tonë. Po, duhej t'u shkëputnim, të paktën, disa gjëra edhe në kushtet e tanishme, në luftë.

Për mua po bëhej gjithmonë dhe më e ndërgjegjshme se lufta kishte shumë anë të saj dhe se për secilën, që kishte rëndësinë e vet, duhej menduar dhe vepruar shumë.

Më ngarkonin dhe kryeja detyra midis nëpunësve privatë. Merresha me mbledhjen e ndihmave për partizanët. Disa herë isha dërguar edhe si ko-

rrier jashtë qytetit, meqenëse unë kisha të bëja me disa fshatra ku afendikoi im kishte ara e vresh-ta dhe ku më dërgonte për punë hesapesh e të ardhurash. Kështu mund të mos bija në sy dhe të humbisja gjurmët përsa u përkiste detyrave të Lëvizjes.

„Nezhdeti qëndroi një çast, sikur deshi të bënte një pushimi në tregimin e tij e të merrte vrull të ri përtë ta vazhduar e përtë ta përfunduar atë. Ai preku e rregulloi bigën e djathtë të syzeve, siç e kishte zakon të bënte herë pas here, dhe tha: „Ishte fillimi i prillit, kur më ngarkuan përtë shpënë një letër në një nga fshatrat e Rrëzës. Atje do të më priste një shok nga komanda e qarkut. Parullë nuk më dhanë, pasi, më thanë, ai më njihte dhe unë e njihja atë. Por kush ishte nuk më treguan, ndonëse i pyeta dhe u bëra kureshtar.

— Ec! Atje do ta marrësh vesh, — m'u përgjigjën.

U nisa një të diel. Ishte kohë e keqe. Prej disa ditësh kishte rënë shi, qelli ishte i mbushur dhe pritej ndonjë rrebesch tjetër. Shiu dhe lagështia e kishin ftohur ajrin. Mora shtegun e Kroit të Lisis, duke lënë më të djathtë rrugën dhe postbllokun. Si kalova bostanet dhe hëdha përruan, dola në fu-shëne vogël, që shtrihet në këmbët e kodrave. Ka-përceva nëpër toka të pambjella, që të bija në udhë. Këmbët më fundoseshin në muzgun e verdhë dhe mezi i nxirrja. Kisha një palë këpucë me qafa, të cilat i kisha blerë nga një ushtar. Nuk ishin të reja, por pak ishin përdorur dhe shuajt i kishin të trashë. Proqet e tyre nuk ishin ngrënë. Balta i mbuloi krejt, madje m'u ngjit në çorapët e lëshëtë. Kisha mbathur një palë pantallona fusko-

dhe kisha veshur një pardesy prej një farë mu-shamaje, por e hollë, që sikur ma fuste më shumë të ftohtët në mish. Ndonëse u vërtit, shiu nuk më zuri udhës dhe thashë me vete se kisha shpëtuar prej tij, kur iu afrova mullirit të fshatit. Uji vinte me vërtik, shkumbëzohej, përplasej në pendën, dëgjohej një zhaurimë, dhe pastaj dilte përsëri në vijën e tij. Por as trokashkë nuk ndihej, as frymë njeriu. Po matesha të hidhesha matanë vijës, kur më doli përpara një njeri. Më erdhi e papritur dhe mbajta një çikë këmbët, që të vëreja se me cilin kisha të bëja. Por, pa e mbledhur mirë veten, ai më foli:

— Vdekje fashizmit, shok! — dhe ngriti grush-tin pranë strehës së kasketës, ku skuqte një yll cohe me përmasa disi të mëdha.

E vështrova me habi atë që më ishte drejtuar, ai zë më tingëlloi i njobur, dhe iu përgjigja:

— Liri popullit!

Ai m'u hodh në qafë.

— Nezhdet, nuk më njohe?!

Më dukej e pabesueshmë.

— Ndreko, ti qenke?!

Ai më shtrëngoi dhe më puthi.

Ndrekoja ishte, po. Që në shkurt ai kishte kluar në mal. Nuk isha parë me të që nga ajo mbledhja e janarit. Dhe ja, tani, ku e kisha përpara; kjo më gëzonte.

Ky ishte shoku i komandës së qarkut, për tek i cili më kishin nisur dhe më kishin thënë se më njihte dhe e njihja.

Ndrekoja! Miku im dhe i pari partizan që pa takoja! Nuk e tregoj dot se nga ç'ndjenja të reja isha pushtuar ato çaste. Në një zonë, thuajse të

lirë plotësisht — atyre anëve nuk kishte komunë, as postë xhandarmërie — kisha takuar një partizan, një nga luftëtarët që i ishin futur një rrugë të madhe dhe që do të sillnin atë që populli priste: lirinë dhe jetën e re.

I dhashë letrën. U ulëm në një trung të shtrirë, që ishte prapa mullirit dhe filluam të pyesnim e të tregonim, ai të tijat, unë të miat, ndonëse edhe ai edhe unë nxitonim. Ndrekova duhej të shkonte në qendrën e komandës sa më parë, unë nuk duhej të vonohesh, pasi para se të ngrysej ndaloheshin hyrje — daljet dhe qarkullimi në qytet. Më pyeti për vepriktarinë që zhvillonim, më përgëzoi që po aktivizohesh gjerësisht dhe u interesua, sidomos, për ndihmat që mblidheshin dhe përfurnizimin e partizanëve me veshimbathje e sende të tjera.

Ishte i veshur me atë pallto të kojtur tregerekëshe dhe me pantallona të gjata, si në qytet. Ndryshtimet e tij ishin ylli në kasketë dhe një kobure shkuar në një rrip të ngushtë, të cilin e kishte nxjerrë mbi pallto. Fliste shpejt e me fjali të shkurtstra, si zakonisht, veg zëri i tij sikur kishte tanë një tingull më të trashë e më të plotë.

Nuk na mbetej kohë për t'u zgjatur. Ai më dha disa porosi për shokët e qytetit dhe u ngrit. U përqafuam dhe u puthëm. Kur u shkëputa prej tij, e vështrova edhe një herë që nga koka e gjer të këmbët, si të merrja e të ruaja prej tij gjithë mbresat e atyre minutave që kaluan bashkë aty, prapa mullirit, në një tokë ku liria kishte filluar të rrihte flatrat e saj. Atje në fund, te këmbët e tij, vështrimin ma shqetësoi diçka. Nuk e kisha vënë re më parë. Poshtë, pantallonat e zhubbavitu-

ra Ndrekoja i kishte mbledhur dhe i kishte lidhur me gjalimë. Në këmbë ai kishte një palë opinga llastikun të ronitura. E majta ishte hapur në majë; në përfundim të çarën dilnin gishtinjtë e baltosur. Opinga e djathtë ishte ngrënë prapa dhe e gjysma e thembrës shkëlqet Jashtë. Ngrita sytë dhe e pashë edhe një herë Ndrekon, i cili, siç dukej, po kuptonte mbresën dhe shqetësimin tim të atij çasti. Nga veshja, haheshe. Por më ato gjysmë opinga! Si mund të bariste?! Këmbët nuk i kishte aspak të mbrojtura. Pse kaq keq?! Në qytet ai kishte një palë këpucë, ndonëse të vjetra. Po këtu, ç'i kishte bërë? T'i kishte flakur brenda dy muajve? Ndofta:

Nuk mund të ndahesha e ta lija Ndrekon me këmbët në atë gjendje. Vështrova këpucët e mia të llangosura, dhe u mendova. Pashë përsëri Ndrekon në ftyrrë. Ata sytë e tij të zinj, të vegjël, të rrumbullakët, sikur kishin një shkëndijë ironie dhe sikur po më thoshin: «E di se ku e ke hallin...»

— Ndrekë, ç'i ke ato opinga... — i fola.
— Epo... — mblodhi supet e tij të ngushta.
— Për të zhdukur këto opinga po luftojmë... — përfundoi ai duke vënë në gaz buzët e tij të holla.

— Na, merri këto të miat, — dhe fillova të zgjidhja këpucët:

— Po ti, zbatohur do të shkosh në shtëpi?
— Më jep opingat e tua.

— Ndrekoja qeshi me zë.
— Si, ore, me opinga do të hysh në qytet?! Do të të marrin përfundim partizan...

— Partizan jam edhe unë...

— Do të të kapin pepinot...

— Po të më kapin, le të më marrin opingat, — ia ktheva.

Ai qeshi përséri, — ndërruam këpucët dhe opingat. Si u mbath, Ndrekova tha: — C'më ndejtkan tamam në këmbë! Paskeini një mase, ndonëse ti je më i gjatë se unë. — E, këmbën nuk e kam të madhe. Hajde, t'i mbash me shëndet!

Kur po largoheshim, ai më thirri: — Ki mendjen, se ato opinga mos të të marrin në qafë!

Mos ki merak, — iu përgjigja.

Me vështirësi munda të ecja dhe të arrija më qytet përpëra ndalimqarkullimit. Opingat më pengonin shumë pér të nxituar. Aty te Kroj i Lisit më zuri një vesë shi. Po, ndonëse gjatë rrugës nuk më vajti shumë mendja, kur iu afrova shtëpive të para, më ngacmoi mendimi se si do të kaloja kështu nëpër rrugët e qytetit, kush mund të më shikonte e çfarë mund të më thoshte. Por nuk kisha ç'të bëja. Ashtu hyra, duke shpejtar hapat e duke parë majtas e djathtas mos bija në sy. Merreni më mend se si e bëra tërë atë rrugë gjer në shtëpinë time.

Nezhdeti heshti dhe u duk sikur po çuditej ende, pas kaq vjetësh, më këtë ngjarje.

Dhe në përfytyronim këtë burrë të gjatë e të thatë, me syze, me një pardesy të hollë e me pântallona fusko, mbathur me opinga llastiku të rëna copë, që parakalon te rrugët e qytetit më drujtje të madhe, se mos e shikonte njeri e dukej qesharak. Nejse kaloi mirë vazhdoi Nezhdeti, — Ish-te vonë, shiu binte, kështu që njerëzit ishin të rrallë. Dhe ndonjë që shkonte, ia kishte shkelur me

vrap që të mos lagej e që të arrinte shpejt në shtëpi. Unë bëhesha mënjanë, futesha nën ndonjë strehë ose ulesha sikur diçka rrregulloja, që të mos më shikonin opingat. Portën e shtëpisë e hapa me kujdes, mbajta me një dorë zilkën, që të mos dëgjonin brenda, hyra në ashef, hoqa e fsheha opingat dhe mbatha një palë këpucë, të cilat i kisha futur në një kamare. Atëherë mora frymë lirshëm.

Ndonëse nuk kisha bërë ndonjë gjë të madhe, ndieja një farë kënaqësie që i kisha dhënë Ndrekos ato këpucë, me të cilat ai mund të shkonte një kohë të gjatë, se ishin të forta; sidomos këmba nuk do t'i lagej, por do t'i rrinte e ngrohtë këta muaj me lagështi. Dhe kur, pas nja dy javësh, më dërguan përsëri me detyrë për të takuar Ndrekon, isha me qejf se kësaj radhe do ta shikoja me këpucë në këmbë.

Por, për habinë time më të madhe, ai më doli përpara as me këpucë, as me opinga llastiku, por me një palë opinga kau me retrë, më keq se të parat.

— Kundi ke këpucët, o Ndreko? — kjo ishte fjala e parë që i thashë, pa pritur të pëershëndeteshim:

— Këpucët dashke më shumë se mua.. — foli ai sikur deshi të më zbuste.

— Nuk e kam hallin te këpucët, por te këmbët e tua. Ato do të griseshin, doemos, por, kaq shpejt? S'ka as dy javë! Nuk besoj të kenë dalë jashtë-përdorimit. Ç'i ke bërë?

— E lëmë këtë muhabet... — ma preu Ndrekona. — Ç'kemi andej nga qyteti? Shokët si janë? Të tutë si i ke?

Ai ma ktheu fjalën gjatkë, larg këpucëve të

mia dhe opingave të tij të shpuara. Më pyeti si
vinin punët në qytet. Më tregoi për disa luftime
të çetave, më tha se së shpejti do të krijoheshin
batalione.

— Dëgjo, o Ndrek, — i theksova kur do të ndaheshim. — E kam të qartë se ku kanë përfunduar ato këpucë. Do të të dërgoj një palë të tjera, më të mira. Po do t'i dërgoj vetëm pér ty, more vesh? Vetëm pér ty, t'i mbash gjersa të të bien copë. U kuptuam?

— Mirë, — buzëgëshi Ndrekova.

Kisha një mik këpuçar. Në masën e këmbësime, porosita një palë këpuçë me qafë për Ndrekon. M'i bëri të shëndosha, për merak. Ia pagova me këste.

Këpucët ia nisë Ndrekos, bashkë me një shënim, ku e qortoja dhe e kërcënoja qël t'i mbante vetë. M'u përgjigj se i kishte marrë dhe më falënderonte.

Gjatë Luftës nuk u pamë më me Ndrekon. Ai kaloi më detyra në vise të ndryshme. Megjithatë, u interesova dhe pyeta: Takova shokë që patën të bënin më të. Më hante meraku e kureshtja edhe për punën e këpucëve. Me marifet, gjurmova përkëtë. Ata më thoshin se asnjëherë nuk është kishin parë. Ndrekon më këpucë në këmbë. Mbante gjithnjë opinga, dimër e verë, gjer në çlirimin e vendit.

VALLJA QË NUK MBAROI

Në murin e kështjellës së vjetër zienin këngët e dridhej vallja. Vendi vinte shesh, lëndinë e njojmë, që ishte harlisur ato ditë maji, kur dielli po ngrohte, pas vesëve të shiut. Në të dalë të qytetit të vogël, ky ishte vendi më i përshtatshëm përtë mbledhur këngëtarët e valltarët më në zë nga fshatrat përreth e përtë bërë një festë të këngës e të valles popullore. Kjo ishte një festë e re. Gëzimin e lirisë po e shtonin tanë gëzime të tjera. Në fshatrat njerëzit kishin filluar të bashkohejshin në kooperativa. Ky sihariq jepej me krisma pushkësh, me këngë e me valle.

Festa e këngës dhe e valles grumbullonte rrëth saj gjithë qytetin e vogël. Me të mëdhenj e me të vegjël vinin e shtroheshin këmbékryq rrëth e rrotull lëndinës, ndiqnin gojëhapur këngët e vallet, habiteshin përmeshtërinë e këngëtarëve e të kërcimtarëve dhe ia bënин: «Bre, bre, ç'zë që passka! Bilbil, o, iu haptë dera!... Shih, shih, si hidhet, derri! Qiellin do të zërë me dorë»!

Kënga buçiste, vallja tundte dheun atje rrëzë mureve të kështjellës së vjetër, që qëndronte e

heshtür, por që sikur shikonte me një sy dhe mban-
te ngrehur një vesh. Nga kështjella e moçme kishin
mbetur ca rrënoja. Muri i trashë, që mbahej më
këmibë, e kishte pjesën e sipërme të dalë përpala,
të kërcyer, si një njeri që ka nxjerrë kraharorin
e mbështetet fort në kërcinjtë e tij, pa dashur
të dije nga ata që e kërcënojnë. Bedenat ishin rrë-
zuar. Një vetëm kishte shpëtuar. Nën të ishte
hapur një vrimë rrumbullakët, nëpër të cilën
kalonte kaltërsia e qiellit. «Ja ku e ka veshin, ja
ku e ka dhe syrin», thoshin njerëzit, duke treguar
copën e ngritur të bedenit dhe vrimën si një sy i
kaltër, që ishte hën të. Pleqtë rrëfenin se, pesë-
qind, vjet të shkuar, kështjella i kishte bërë ballë
ushtrisë së një pashai. Ishte rrethuar, kishte pritur
gjylet e topave, por nuk ishte dorëzuar. Shqiptarët
i kishin thyér turqit dhe në atë lëndinë kishin he-
qur vallen e fitores. Murratorët i kishin dhënë kësaj
kështjelle pamjen e një shqiponje me krahë hapur.
Edhé përmbi gurët e saj kishin gdhëndur shqipe
me dy krerë. Në një gur të thyer dallohej sot e
kësaj dite një krah i shqipes. Rrëbeshet e viteve
kishin shembur anët e kështjellës, krahët e saj, por
gjoksi i kishte mbetur, një sy i shikonte dhe një
vesh i dëgjonte.

Kështu thoshin e flisnin të moshuarit, sa herë
shtroheshin rrëthi e qark për këtë festë të këngës
e të valles popullore.

Vallja ndiqte vallen, kënga këngën.
Te njerëzit u afrua një oficer trupngjeshur,
me shpatulla katër pëllëmbë e me fytyrë eshtake.
Kapën e kishte ulur gjer në mes të ballit; në të
dyja anët e jakës së mbyllur i shndrisnin nga dy
yje verdhoshe. Ai ndali si i menduar, me sytë e

kaltër mbi valltarët që po kërcenin në lëndinë. Secili prej këtyre rrëmbente mbi kokën e tjetrit, duke filluar që nga i dyti gjer te i pesti valltar, që ishte më i madhi. Aq sa rrëmbezin në shtat, rrëmbezin ata edhe në moshë. Ai që hiqte vallen, sapo do t'i kishte kapërcyer të pesë vjetët. I vogël dhe i imtë nën mëngoren dhe nën kindat e fustanellës, me ato opingëza të kuqe me xhufka të zeza. Takija e bardhë i rrinte mënjanë mbi kryet, ku zverdhte një push i butë flokësh. Shkallë-shkallë, gjer tek i fundit, dymbëdhjetëvjeçar, mbani vallen të tjerët, të veshur edhe këta me këmishë pëlzure, që ndritnin nga bardhësia, me jelekë të zinj shajaku, ngjeshur me breza të kuq e shtrënguar dizgat e murme nën gju mbi benevreket.

Më i vogli tundte shaminë e kuqe, që kishte në dorën e djaththë, hidhët hapat shtruar, duke shkelur në majat e këmbëve, i anuar në krahun e majtë, mbi shokun që e mbante, dhe ndiqte me kujdes hapat e tij, ashtu si bënin dhe të tjerët. Gërmeta herë trashte e herë hollonte zërin e saj, rrëfente e paralajmëronte diçka më të madhe, më bujare; violina rrëshqiste e ledhaçonte me mall; lahuta sikur miratonte kallëzimet e bëmat e dikurshme.

Oficerin e mbërtheu kjo valle e lashtë burrash nën atë kështjellë, që ruante ngjarje trimërie, këngë e valle zemre.

Këtyre anëve ishte ai. Dinte kështjellen dhe gojëdhanat për të, dinte këngët e vallet e burrave, të dasmave e të dhimbjeve.

Por njëra ishte vallja e gjakut të tij. Vallja që po luani tanë valltarët e vegjël. Kjo valle e rrëmbeut, e çoi në vite e në ndodhi që nuk kanë vdekje.

2

Ata ishin bashkëfshatarë, e moshatarë. Kishin kullo tur dhitë bashkë, e ishin rrëkellyer luadhe vel Ishin shtirirë mbi kashtën e vrakeve e kishin numëruar yjet natën, gjersa ishin këpitur e gjumi i kishë mundur. Ishin kacavjerrur plepave, kush e kush t'u ngjitej më parë. Kishin mësuar t'u hipnin kuajve e t'i ngisnin revan. Pendë shkönin e pendë vinin. Por ai mësoi një gjë më shumë se ky, osë, më mirë, ia kaloi në shkathtësi, e mjeshtëri. Ndofta se ashtu ia solli sëra. Mirëpo, qështë e drejta, ishte më i zhđervjellët e më shpuzë përkësö pünëshi.

Një ndajnatëherë ai i pat thirrur

— Sefe! O Sefel! Na kërdhi xhaxhai!

Kishte dalë nga shtëpia, dhe kishte vrapuar në shtëpinë e shokut.

Në oborri ishin mblidhur njërezit e Refkiut dhe fqinjët. Xhaxhai kishte zbritur nga mushka dhe ishte sheshuar në shkallët e hajatit, pasiv kishte, puthur tri herë pragun. Ai merrte fryshtë thellë dhe i shikonte të gjithë një për një sikur të mos bi kishte parë kurri, sikur të donte t'i përpinte. Ftyra kishte filluar t'i rrudhej, por ruante një ngjyrë trëndafili të zbehur. Ishte vëshur me një palë rroba mavi qyteti, që e dallonin nga fshatarët, por mbi kokë kishte takije të bardhë.

E kë mbajtur takjen dhe andej? — e pyet dikush. — Në punë, jo, — iu përgjigj xhaxhai.

— Këtu e ndërroi, — u hodh i kushëriti, Kasoja. — Sapo shkeli në truallin tonë, hoqi shapkën, na e flaku neve dhe nxori nga bohçja takjen.

— Po, po, këtu i kam, — foli xhaxhai, sikur i dha përgjigje dikujt që e pyeti.

Ai u ra me shpinën e dorës mustaqeve të trasha të thinjura dhe zgjidhi bohçen. Shpalosi me radhë fustanellën, këmishën, xhamadanin, enterinë, tirqit, vendosi pranë tyre opingat me xhufka.

— Ja tek i kam, — tha pastaj.

— I paske ruajtur të perit? — vërejti një fqinj.

— Eu! Kanë meselenë e tyre, — foli xhaxhai. Por një herë tjetër do t'juai tregoj.

Ai hoqi nga bohçja një sëpatë, i fërkoi me mëngën tehun dhe e mbajti në të dyja pëllëmbët, sikur donte ta peshonte, se mos kishte bërë firë nga koha dhe përdorimi.

— Paske dhe sëpatën? — e pyetën.

— Me këtë kam ngrënë atë copë bukë, — ia ktheu xhaxhai Refkiut.

— Me këtë!? — u çudit një djalosh.

— Po si e di ti? — i tha xhaxhai. — Sëpataxhi në pyll kam qenë. Ç'e kujtoni andej? Fushë me lule? Mos i gjerryejnë paratë me lopatë? Ah, ç'i gënjen mendja disa! Pyje, po, pa, anë e fund! Shtatë vjet. Ç'them! Shtatëmbëdhjetë, me gjithë dhjetë vjetët e parë. Një herë në mot e kam parë qieillin me sy gjatë këtyre vjetve. Në pyll, si egërsirë, mes egërsirave. Tërë motin më thithte pylli. Punoja pér bosin.¹⁾ Dhe ç'solla, që andej? Këtë sëpatën time dhe këto rroba të vendit tim, që i shpura që këtej. — Xhaxhai psherëtiu, pastaj, si papritmas thirri: «Mjaft! — i thashë bosit. — Nuk punoj më pér ty! Do të kthehem në atdhe». Kështu, vëlle-

1) (Anglisht) Pronar.

zër, më mirë bukë e kripë e vendin tënd. Vendi i huaj të ha të gjallë.

— Po babai? — e pyeti Refkiu.

Xhaxhai i vuri djalit dorën e rrreshkët mbi kokë dhe i tha:

— Do të vijë pas meje. Unë ika i pari. Jam më plak. Do të vijë edhe ai...

Do të vijë edhe ai...

3

Kaluan ditët, kaluan javët, dhe një mbrëmje xhaxhai i Refkiut tregoi atë punën e fustanellës që kishte marrë në kurbet dhe e kishte sjellë prapë brenda në bohçe bashkë me sépatën.

Një herë në vit, Ditën e Flamurit, tërë mërgimtarët mblidheshin në kryeqendrën e krahanës dhe kremonin. Ata që kishin sjellë veshjet e mëmëdheut visheshin me to. Pa kërcitnin vendje kënga dhe vallja. Xhaxhai i Refkiut ishte i pari ndër valltarët. Ai hidhej e përdridhej si askush. Një bos e kishte parë dhe e kishte pëlqyer. Ai u kishte këruar shqiptarëve të kërcenin në një kafene të madhe bashkë me kërcimtarë të tjera të Ballkanit dhe të Evropës. Atje do të mateshin, dhe kush të kërcente më mirë do të merrte shpërbllim.

Kafeneja e madhe ishte mbushur plot. Valltarët dilnin e kërcenin në një vend të ngritur në krye të kafenesë. Kishte nga ata që të thanin në valle. Grekët mburreshin se nuk kishin shokë në këtë mes. Ata kërcyen me kryelartësi e sqimë. Kryevalltari i tyre u hodh e u përdrohd, ra në

gjunjë e u rrotullua. Ai priste t'i jepnin shpërblimin.

Kur u erdhi radha shqiptarëve, xhaxhai i Refkiut dhe shokët e tij u bënë tym e flakë. Ata e ndezën vallen e lashtë të burrave, sa tërë kafeneja u ngrit, në këmbë. Në krye të valles, xhaxhai fluturonte. Në rrotullimin e fundit, ai u hodh drejt tavanit, sikur ta kishin zënë e ta kishin flaku ë njëqind burra bashkë. Dy hostenë mbi kokat e valltarëve, varej një abazhur i madh me sumbulla qelqi rrëth e rrotull në fund. Në kërcimin e tij xhaxhai këputi disa sumbulla dhe ua hodhi njerëzve që po thërrisin nga habia dhe gjëzimi si të marrrosur. Disa u bbinin duarve, të tjerë fishkëllësin, që dikush, i papërmbarjatur, flaku në mur. Një shishe që plasi me bugimë.

Shpërblimin e caktuar për valltarët e fituan shqiptarët:

Një mërak kishte xhaxhai, t'ia mësonte mirë dhe t'ia linte i trashëgim këtë valle burrash, ashtu si e kishte mësuar ai nga i ati dhe ky nga babai i vet, brez pas brezi. Vallja vinte tej nga shekujt, i ndiqte dhe nuk u ndahej Zalollarëve. Fëmijë nuk kishte xhaxhai, ndaj i gëzohej nipit të vogël.

Oborri i shtëpisë ishte i shtruar me plloça të mëdha katrore ngjyrë plumbi, që i nxirrin nga mademi i aty lärt në malin e fshatit. Xhaxhai u jeptë urdhër grave ta fshinin e ta pastronin, të mos linin asnjë lëmishte e guriçkë, ta bënë si sini. Gratë mërrnin fshesat prej shelgjishtesh të shtrën-

guara me një fill lëvozhge dhe i binin oborrit në të katër anët, e bënин si për ta lëpirë me gjuhë.

— Eja këtu, — i thërriste xhaxhai Refkiut.

Ky është afrohej. Nëpërmjet gardhin e shtëpisë mbledheshin fëmijët fqinjë, shokët e tij, dyshëm e trembëdhjetëvjeçarë.

— Hyni, hyni brenda, — u thoshte këtyre xhaxhai. — Edhe juto ta mësoni. Nuk do ta lozë vetëm Refkiu.

Ai ia merrte këngës dhe fillonte vallen shtruar, me dorën e majtë në bel, në të djathtën shaminë e kuqe, që s'e hiqte nga qafa. Pas niste e i tregonte Refkiut se si duhej mbajtur trupi, si duhej hedhur këmba, si duhej bërë përpëra, pastaj prapë, si duhej rrrotulluar, si duhej uluri në bisht e si duhej kërcyer përpjetë. Ishte çudi se si aisburë trupmadh, i thinjur flokë e mustaqe, me dy vraka të thella faqeve, kërcente aq lehtë, si djalosh fidan, shkonte para e prapsej, ngrinte këmbët e i vërviste ato në ajër si gërshtë, përplaste potillen e djathtë mbi plloqet e oborrit.

Pastaj merrte për dore Refkiun dhe i thoshte ta hiqte vallen, ashtu si e udhëzonte ai.

Djali e mësoi shpejt. Xhaxhai nuk e përbani dot gjëzimin.

— Ma kaloi nipçja! — ngazellehej ai. — Ma kaloi! Do të bëhet trim! Se kjo është valle trimash. Shqiptarët e kanë luajtur qëmoti, që në kohën e Skënderbeut, kur luftonin kundër turkut.

Ai ua mësoi edhe fëmijëve të tjerë. Por asnjëri nuk ia kaloi dot Refkiut. Dhe xhaxhait i bëhej zemra mal, kur i shikonte ata varg, tek hiqnin vallen, me në krye Refkiun: Ai kendonte dhe u thërriste «Hopa! A, më ju lumtë, kapetanë!».

Vitet shkuani. Refkiu u rrit e bëri emër në tërë krähinën si valltar, që nuk e kishte shokun, që ia kishte kaluar edhe të ungjit, xha Malos, i cili tani flinte nën një gur atje te varrezat e fshatit. Thoshin se, pára se t'i dilte shpirti, ishte ngritur në shtrat, sikur kishte dashur t'ia merrte këngës, por ishte këputur dhe kishte rënë pa frysë.

Në gostira e në dasma, në gëzimet e fshatit, Refkiu me shokë kishin kryen e vendit, ia buçisnin me këngë dhe e tundnin me vallen e tyre. Atëherë ahengu, merrte zjarr, gëzimi rritej, urimet shtoheshin. Dasmorët, që vinin nga ana e anës, e shpihin nëpër viset e tyre, e përhapnin nëpër duqina e fusha atë zulm të këngës e të valles të Refkiut me shokë.

Koka i vajti lart djaloshit, barabar me të xhaxhait, kur ishte gjallë. Veç nga trupi Refkiu virite më i hollë e më i derdhur, nga fytyra mëni hequr, me një palë sy të zinj sterrë, me një hundë të drejtë, e me një ballë të gjerë e të rrumbullak-tët, që të kujtonin të atin, ashtu siç ishte në atë fotografinë e murit, që është kishte dërguar nga kurbeti, ku kishte mbetur, se lufta ishte nisur dhe rrugët ishin zënë.

Kur shkeli në majin e njëzenjetë të jetës, e éma iu lut tangëzonte me një nuse. Dhe Refkiu zgjodhi atë vajzën vetullore të cilën e kishte vënë rë se e sodiste me përmallim nga dhoma e grave, kur ai dridhte vallen nëpër dasma të fshatit.

Sefen e bëri vëllam.

Me të hyrë nusja në oborrin e shtëpisë, një dajë i foli Refkiut:

— Kujto amanetin e xha Malos, nipçë.

Xhaxhai u kishte lénë një porosi. I nipi të vishej dhéndér me atë fustanellén e tij, që e kishte mbajtur festave kombétare, me të cilén kishte hequr vallen e kishte nderuar veten dhe vendin. Dhe, kur të vinte nusja, në mes të oborrit, aty ku ai ia kishte mësuar vallen, Refkiu të hiqte të parén vallen e dhéndérise.

— Hajde, Refki!

Djali mbeti si në mëdyshje në mes të oborrit, i rrrethuar nga dasmorët. Ai sikur nuk po vendoste dot pér atë që i kërkonin. Njerëzit po heshtnin dhe po e vështronin. Nusja po qëndronte mënjanë, kokulur dhe me duart të mbërthyera në lug të zemrës.

Refkiu i pa të gjithë një pér një. Pastaj ia bëri me kokë Sefes, t'i mbante vallen. Ky i vajti pranë me tre djem të tjerë. Por, kur e zuri Refkiun, dora e këtij dridhej.

Djali vuri dorën e djathtë mbi brezin e kuq të mesit. Ngriti kokën lart, kroi zërin dhe ia nisi lavër këngës pér vallen. Por ky nuk ishte zëri i tij i plotë e i butë, që fillonte lehtë e kumbonte pastaj si një përrua që vjen vrullthi nga një grykë mal. Ky zë kishte një drithërimë. Kështu filloi edhe vallja.

— O burra, Refki!, — i dha zemër Sefja.

— Iso! — thirrën dasmorët.

Kënga u rrit, vallja u gjallërua, por, prapëseprapë, diçka e metë i mbeti asaj.

Këtë e ndien të gjithë dasmorët, por ata nuk folën gjë me gojë, veç sytë e tyre thoshin se kjo nuk ishte vallja e vërtetë e Refkiut. C'kishte ai? Kujtimet e dikurshme të këtij oborri, të xhaxhait,

përkujdesjet, e tijotë mira përit'ia mësuar me rrënjëjtë valle të burrërisë, ia kishin lënduar zemrën shtë ditë dasine.

Toka mori zjarr e qelli u mbush me bubullima. Pyjet e brigjet ushtuan nga krismat. Djemtë ngjishnin armët, vinin një yll të kuq në ballë, dhe i delnin zot atdheut, që e kishte shkelur cizmja e huaj dhe e kishte helmuar tradhtia.

Do, tē, ngjitemi malit, — i tha një ditë Refkuu
Sefes.

Do tē ngjitemi.

- Dy maliherët ë grekut po më thérresin nga tavani. Nuk durojnë më të mbështjellë me pecet e vajosura.

Vendimin që morën, Refiku ia tha së shoqes.

— Do te dal partizan.

— Ylli nuk është ngritur akoma në këmbë.
— Kur të kthehem, ai do të dalë të më presë
te kroi i fshatit.

Vafsh si burrat dhe ardhsh si trimat, e uroi atë e ëma dhe e puthi në ballë.

Refkiu kishte një dëshirë, të cilën nuk e linte dot ta digjte thellë në krahor.

— Këtu, ku na mësoi xhaxhai, kam qejftë heq vallen e tij, para se të nisemi, — i foli ai Sefes Kishim dalë në oborin e shtëpisë. Ishfe më të ngrysur. Së shpejti do të ngrihej hëna. Nga mali vinte njëherë e lehtë. Ato ditë kishin mbledhur misrat.

Nëna e Refkiut ishte e menduar. Nusja mbante
në krahë djalin motak. Refku tha:

— Ky do të jetë dimri i fundit i robërisë. Ne
do të kthehemë të gëzuar e fitimtarë. Nuk kanë
për të shkuar më e pér të humbur burrat në kur-
bet. Nuk do të na e marrë kafshatën e bukës dhje-
tari. Nuk do të na i djegë më kásollet hasmi, sic
bëri njëditezaj gjermani në Dushkas.

Ai e filloj vallen. Sefja ia mbajti. Kësaj here
nuk iu drodh dora si atë ditën e dasmës. Vetëm se
bëri një rrrotullim dhe qëndroi. Pastaj ngriti maliher-
rin dhe e zbrazi tri herë.

— A.a! — thirri i biri nga krismat.

Refku puthi djalin e nënën, përqafoi nusen
dhe u nis bashkë me Sefen. Pushka nuk i lozte në dorë. Zemra e goja i
këndonin.

Në krye të valles dilte ai, kur batalioni pushon-
te pas luftimeve, kur fshatarët u hapnin dyert
e shtëpive partizanëve apo para se ata të nise-
shin pér një rrugë të gjatë. Kënga dhe vallja e tij
sikur u jepnin krahë njerëzve.

Në luftën e Qafëshkozës ai mori një plagë në
krahun e majtë. Ishte lëshuar mbi gjermanin, që
po e qëllonte me automatik që prapa një guri. Ishin
kacafytur e rrokullisur në shpat. Pastaj Refku e
kishte vënë poshtë, atë, kishte nxjerrë dhjetëshen
e ia kishte mbajtur në kokë. Me automatikun e
gjermanit ua kishte këputur ushtarëve të tjerë.
Tek po ngrihej pér t'i ndjekur, që nga një gëmu-
shë krisi një automatik dhe e goditi në krah.
Refku u kthyte kësaj anë dhe e ndezi flakë gëmu-
shën.

Kur batalioni u mblodh, hoqi mënjanë robërith
dhe grumbulloj armët dhe plaçkën që kishin zënë,
Refkiu pllakosi ca duhan, mbi plagën e krahut
dhe u ngut të hiqte vallen.

— Rri, i thanë. — Të vajti shumë gjak, plaga
do të të lëndohet.

— Hiç mos e nga, duhani i bën mirë, — ia ktheu
ai partizanes që vajti ta mjekonte. — Shtrëngajoje, po
deshe, me atë copë pëlhirë dhe lëre. Do të mbyllët,
ç'do të bëjë.

Dhe nisi vallen siç e kishte zakon.
Por, të lojtur, si përpëra luftës, në Gardhishtë,
Sefja nuk kishte parë. Batalioni ishte në pritë atë
korrik me vapë. Kishin marrë lajm se një autokolonë
gjermane kishte rrugën për andej. Partizanët
ishin përhapur nëpër kodrat gjatë xhadesë. Tutje
shtrihej lijeni, i qetë vaj, i kthjellët, dhe i kaltër
si qelli, ku nuk dukej asnje re. Komandës i erdhë
një lajm i dytë, që thoshte se autokolona mund të
vonohej, ndofta nuk do të kalonte atë ditë.

Kompania e Refkiut ishte në pjesën e mesit
të pritës. Në xhade nuk lëvizte as miza. Ajo pritje,
prej më shumë se një ditë, sikur po i mërziste par-
tizanët. Në drekë, dy fshatarë të armatosur, me një
mushkë të ngarkuar, dolën nga gryka përmbi kod-
rat dhe sollën bukën. Pararojës ia zbritën ushqim
në pozicion. Partizanët e tjerë u mblodhën e
hëngrën në një shesh ku bari ishte i përzhitur. Si
mbaruan bukë, Refkiu u foli fshatarëve:

— Na kënaqët. Jua paçim hua për të mira. —
Pastaj i pyeti: — A ua thoni këngës e valles këtej
nga ju?

— Nuk ka fshat pa këngët e vallet e tij... —
tha njëri prej tyre.

- Kjo dihet. Po ju vetë, e kam fjalën.
— Lozim, besa, por jo kushedi çfarë...
— Hej, se do t'ia marrim njëherë! — brofi Refkiu dhe i tërhoqi fshatarët pranë.

Ai kishte etje të madhe për të lojtur, sikur të mos kishte kërcyer, të thuash, prej vitesh. Mori në dorë shaminë e kuqe të qafës — ashtu si bënte xhaxhai — përplasi këmbën e djathëtë e thirri: «Hopa, trima!», — e ngriti një herë këmbën e djathëtë, e rrrotulloi ashtu të ngritur, e uli përsëri dhe bëri dy hapa prapa. Sefja po ia mbante vallen. Pas tij vinin dy fshatarët e dy partizanë. Si u zembraps, Refkiu mori vrull dhe u hodh përpara me tërsëllëm; ai shkëputi duart, i ngriti lart, zuri Sefen pér dore, thirri: «Hopa! hopa!» dhe u lëshua përsëri përpara, në një rrrotullim rrëthor, bashkë me të gjithë valltarët. Të gjitha këto i kreu vetëtimthi, me një fuqi e shpejtësi të atillë, sa Sefja mezi po e mbante dhe mezi po e ndiqte në hapat e tij. Kur mbaroi rrrotullimi i parë i vargut të valltarëve, Refkiu qëndroi dhe e mylli me rrokjet e fundit të këngës dhe me zgjatjen e zërit të tij kumbues. Pastaj këngën e nisi prapë pér rrrotullimin e dytë e më të ndezur të valles. «Iso, djema, hopa!» — ngriti kësaj radhe zërin më lart. Nuk e nisi vallen shtruar, por rrëmbimthi. U vërvit majtas e djathtas, këmbeu duart me Sefen, u ul galiç, thirri përsëri «Hopa, hopa!» dhe u hodh përpjetë, mbi supet e Sefes. Ky e priti, duke i shtrënguar dorën e majtë, kur ai zbriti. Por Refkiu, pa qëndruar, u hodh në një kërcim të dytë, përmbi kokën e shokut të tij. Tek ishte në këtë fluturim, ende pa i zënë këmbët në tokë, andej nga xhadeja erdhën tri krisma pushke dhe një plasje bombe. Vallja u pre.

Autokolona gjermane kishte hyrë në pritën e parë. Partizanët e kishin qëlluar dhe lufta kishte marrë zjarr. Dy makina bënë përpara, por ranë në pritën e dytë, ku ishte kompania e Refkiut. Këtu u ndalën përsëri. Ushtarët zbritën nga makinat dhe u futën hendeqeve të xhadesë. Pastaj u matën të merrnin sipër kodrave, por partizanët i kundërsulmuani. Refkiu, bashkë me Sefen dhe dy fshatarët, që kishin sjellë drekën, u hodhën në sulm të parët. Spastruan hendekun nga gjermanët, prej të cilëve, disa mbetën të shtrirë në vend, të tjerët, hipën në njërin kamion, që mundi të zmbrapsej, të kthehej e të bashkohej përsëri me autokolonën. Makinën tjeter e zunë partizanët. Kjo ishte e mbushur me municion. Nga ledhi buzë bregut të ligenit po vinin të shtëna. Atje kishte gjermanë. Refkiu u bëri zë dy partizanëve.

— O burra t'i fshijmë, se paskan mbetur akoma!

Ai u hodh nga kamioni drejt liqenit. Në këtë çast, një automatik e këputi përdhe. Ndërsa po binte, partizanët e tjerë vërvitën bombat, dhe prapa ledhit çdo gjë heshti.

Engriten Refkiun. Ai po shträngonte fort bu-
zët e murrëtyera. Sytë i kishte të hapur drejt qie-
llit të kaltër. Ai u kthyte nga shokët. Me mundim
murmuriti:

— Vdekje fashizmit...

Dhe mbylli sytë.

Tutje autokolona kishte marrë rrugën e lëkthimit.

Të gjitha këto i dolën si të gjalla, e prekën dhe e tronditën toger Sefen, tek ishte afruar të sodiste valltarët që kërcenin aty në lëndinë, nën muret e kështjellës, së moçme, që hetonte me një sy dhe përgjonte me një vesh.

Vallja e të vegjëlve, që nuk kishte mbaruar, i ndollti gjithë këto kujtime. Sefja po i kundronte valltarët që nga i pari gjer tek i fundit, tek po loz-nin pikërisht vallen e shokut të tij. Mendja i vajti te djali i Refkiut. Të ishte ai, vocërraku kokëverdhë, që po hiqte vallen? Jo, ai duhet të jetë më i vogël.

Sefja eci drejt valltarëve.
«Edhe ai do të mësojë», mendonte, duke iu af-ruar gjithmonë edhe më shumë atyre.

ANGULLIMAT E QENVE NATËN

Teni hodhi në stivë thesin e mbushur dinga më kuintalin e misrit, këputi me gishtin e madh të dorës sumbullat e djersës nga balli dhe mori të zbriste shkallët e larta prej druri, që kërcitnin. I thyer më dysh nga pesha që kishte mbi shpinë, po ngjitej Fakja lëkurëtarë e kockëdalë.

- Gjene ky misër i farmakosur!.. — tha ai.
- Hëm! Ç'do të presim... — ia ktheu Teni.

Ai doli te dera e madhe e depos për të marrë një thes tjetër. Një karrocë me një kalë cil ishte e mbushur plot dhe punëtorët po ngarkoheshin njëri pas tjetrit. Teni qëndroi me grushtet në ije, me këmbët të hapura, duke pritur radhën. Trupi mesatar i dukej si një katërkëndësh. Thasët i kishte mbuluar një shtresë dëbore. «Të marrë akoma noti, se pak i mykur është ky misri që po hamë prej një muaji...», mendoi Teni. Dëbora kishte rënë që në mëngjes dhe ia kishte shtruar. Nga dreka ishte prerë, por, ja, po ia thurte tani me grimca që të pickonin fyttyrën.

Në fund të karrocës kishte kthyer kurrizin Leki, me ato shpatulla të ngushta, të pazhvilluara. Punë-

tori trupmadh, fytyrëvvarëlie e sybardhë, që ishte pas tij, i foli:

— Ik!

— Jo, — iu përgjigj Leki, — kam edhe unë radhën.

— Shko, ore, s'janë për kurrizin tënd këto, — ia priti tjetri disi me zemërim dhe e shtyu me bërryl. Djali nuk deshi të ikte.

— Ngjitu lart; ke ç'të bësh atje, — ndërhyri Teni.

Leki pa sytë gështenjë të errët të Tenit, të rënduar nga një hije, dhe u bind. Duke kaluar përparrat, e vështroi me bishtin e syrit, ku dallohej një qortim dhe murmuriti:

— Sonte, nuk më ndalon dot...

Teni mbeti pa lëvizur, me fytyrën e gjerë të qetë, me shikimin ndaj punëtorëve. Por në cepat e buzëve të holla sikur po përbante një të qeshur të cilët. Nga i kishte rënë era djaloshit për sonte?... Nuk kishte se si të mos e nuhaste: dhe vetë ai kishte ndihmuar për mbartjen e armëve që kishte sjellë karroca në rrugën e saj të dytë, bashkë me misrin, dhe i kishte mbuluar në kapicën e thasëve të vjetër në hammbar. Ai e dinte se më shumë se një ditë materialet nuk mund të mbaheshin në fabrikë.

Këtë javë Leki i ishte qepur e nuk po i ndahej. «Përse nuk më pranoni në njësitin e transportit?! — i ankohej. — Unë jam i ri komunist... Apo nuk ke besim?...»

I ri komunist ishte. Prej dy javësh kishte hyrë punëtor në fabrikën e miellit. Por ai nuk i kishte mbushur të tetëmbëdhjetat dhe trupi i tij shëndetlig e ato shpatulla të njoma e trembnin Tenin. Ndaj e ruante nga puna dhe nga detyrat e rënda. Ndryshe

kishte qenë me Nedon. Kur kishte ardhur në centralin elektrik, le që ishte dy-tre vjet më i madh, por kishte duar të forta e kraharor të zhvilluar. Ai kishte punuar një katër vjet në oficinë dhe ishte regjur.

Leki ishte i vërtmi i ri komunist në fabrikë. Përgjithësisht, punëtorët e tjerë ishin të rritur, mbi të tri-dhjetat, të munduar e të kalitur vite të tëra nën brrën e «Shoqërisë Anonime», që kishte dy centralë elektrike, fabrikën e miellit dhe ujësjellësin e ri. «Ti do të kryesh ato detyra që do të të ngarkoj unë», i kishte shpjeguar Teni djaloshit. «Këtu nuk kemi aktiv të Rinisë Komuniste. Atje në lagje, ku bën pjesë, parashtron kërkuesat e tua dhe merr detyrat që do të të japid». «Unë jam i ri komunist, e kuption, shoku Teni... — kishte këmbëngulur Leki. — Dhe këtu, ku punoj, do të kryej edhe detyrat e luftës! «*Do të merresh me agitacionin në punëtorët... do të sjellësh e do të shpërndash traktet...* — Këtë e di dhe po e bëj. Por do të marr pjesë edhe në njësitin guerril të transportit! Po! Edhe aktivë i rinisë e ka aprovuar këtë. Do të vijë sekretari të bisedojë me ty».

Kjo vendosmëri e Lekit i fliste Tenit për karakterin dhe ndërgjegjen e tij. Por ai ndiente një dhembshuri për këtë djale. Jo, nuk ishte çështja se donte ta ledhatonte, ta mbante mënjanë e ta mësonte keq. Mirëpo, ajo fytërë çehrevrarë, ajo qafë e hollë, ata krahë të pambushur ende, sikur nuk e lejonin ta fuste në një ndërmarrje shumë të vështirë, siç ishte ajo e njësitet të transportit. Ai e dinte se djali nuk do ta linte të qetë. Kishte një kokë të ngjeshur, që ia kalonte së tijës. Teni shikonte se do të vinte dita të epej, t'i bënte lëshimin... «Por jo sonte», tha me vete. Kishte një arsyё të madhe. Koha ishte keqësuar shumë. Po e

kthente me tufan. Materiali ishte i shumtë dhe me peshë: një mitraloz i rëndë, bomba, fishekë...» Jo sonte...», tha edhe një herë.

— Si stivosën gjithë thasët, u duk në depo sekretari i shoqërisë, i gjatë e i kërrusur, me syze në hundën e tij si sqep, i cili i foli Tenit:

— Ti e ke radhën sonte?

— Unë.

— Do ta bluan gjithë misrin që erdhi.

— Myk do t'i shesim përsëri popullit?...

— Autoritetet dhanë urdhër që mielli të shpërndahet që pa gdhirë. Furrat kanë mbetur trokë.

— Por autoritetet e hanë bukën has...

— Këto janë fjalë me zarar, — ngriti zërin e thate sekretari. — Zbato atë që të thashë.

Teni urdhëroi Faken të bënин gati misrin, ta zbrazni në koritat dhe të ndizni motorin e mullirit. Pastaj të linte ndihmësin e tij të kujdesej për tërë punën dhe të shkonte të lajmëronte Lilin dhe Nedon në central. Ai do t'i priste në punishte.

Punishtja ishte një e ndarë e ngushtë në katin e dytë të fabrikës. Ajo kishte një bankë të nxirë, një trapano të vogël, një mengene, disa çekanë, lima e sharra dore, për të ndrequr ndonjë vegël të mullirit, kur prishej. Një dritare katrore zbulonte pamjen e fushës, që fillonte disa metra tutje fabrikës.

Kishte zënë të ngrysej dhe dëbora vazhdonte të binte me erë. Bardhësia e fushës po irnosej.

Si një dhembje, si një rënkim, si një grahmë, erdhë një angullimë e zvarritur dhe e zbehtë. Tenit iu kujtua dalja e javës së kaluar. I kishin ndjekur me qen. Në vesh i kishte ende lehjet e tij nga prapa. Por, gjermanët ishin kujtar një çikë vonë. Ndofta pinin,

ndofta ishin vonuar. Dhe ata nuk kapércejnë tutje lumenit, ndonëse këtë kohë ushtria e tyre lëviz edhe natën poshtë e përpjetë. Tërë puna është sa të afrohesh te lumi. Gjer atje ka një copë të madhe fushë, e zhveshur, si pëllëmba e dorës. Por shokët presin furnizime. Tani kanë nevojë më shumë se kurrë.

Njëri pas tjetrit, hynë në punishte Fakja, Lili dhe Nedoja. Teni i pa një nga një mendueshëm.

— Ç'ke që ke rënë në të thella? — i tha Lili.

— S'kam gjë. I rregulluat punët në central e në fabrikë? — pyeti Teni.

— Në vijë çdo gjë, — iu përgjigj Lili.

— Siç më the, i mbaruam, — shtoi Fakja. — Mulliri është gati për blojë.

U dëgjua zhurma e një motori dhe përplasja e rripit që vërtiste rrotën e makinës.

— Ja... — u hodh Fakja.

— Mirë, — tha Teni. — Të presim pak. Nata do të bjerë së shpejti. Ti dil njëherë nëpër fabrikë, vështro ç'bëhet, shko dhe te hambari, zgjidh thasët ku do të futim materialin, — iu drejtua Fakes.

Ky iku. Teni u çapit pa folur.

Angullima e mëparshme u dëgjua përsëri. Këtë radhë më e mprehtë. Një angullimë e dytë iu përgjigj asaj, sikur i miratonte dhembjen dhe shqetësimin.

— Filluan qentë, — tha Nedoja. — Janë dy, më duket.

— Dy i kanë bërë, — shpjegoi Teni. — Edhe rojat në postbllok i dyfishuan.

Lili lëvizi në kokë beretkën mavi me dy njolla vaji makine dhe ndërhyri:

— Le t'i dyfishojnë e le t'i katërfishojnë, po de-shën. Materiali do të dalë se s'bën.

— Ta merr mendja, — e përkrahu Nedoja.

Një e lehur e trashë dhe e fugishme gjëmoi tri-katër herë, aty më afér fabrikës.

— Ja dhe Murroja i xha Tushit, — foli Nedoja.

Pastaj u përsëritën angullimat e zvarritura, të ndërprera nga klithma të holla. Murroja ia dha më fort, sikur donte t'i mbyste ato angullima të mërzit-shme.

— Oj, ç'na u ndezën qentë! — tha Nedoja.

— Është muaji i qenve dhe i ujqve, — ia priti Lili. — Mani muni¹), siç thotë vjehrri im, — dhe përpëlliti qepallat e kuqërrremë.

Teni buzëqeshi.

— Njëditëzaj ujku kishte kaluar nëpër qytet, më thanë, — vërejti Nedoja.

— Edhe kalon. Me këtë dëborë egërsirat sharrrojnë për të ngrënë dhe lëshohen ku të mundin. Tani që qyteti bie në pus tërë natën, nuk kanë frikë të afrohen.

— More, këtë muaj ujqit dalin me kope...

— Dalin, o, posa. Po ti, Nedo, mos u tremb. Sonte kemi mitraloz të rëndë e do t'i kortarisim, po na dolën.

— Jo, mör, s'e kam hallin atje, — mënjanoi kokëNedoja dhe uli kapakët e syve. — Por, them...

— Do të jetë degdisur kapteri... — iu kthye Lili Tenit.

— Iku menjëherë, si dorëzoi arkën e dytë me fiskekë.

1) (Anglisht) Muaji i mjaltit

— Nuk morëm dot më shumë...

— Do ta kishin ngritur tërë depon shokët, por, ç't'i bësh, e solli kokën nëntogeri...

— Mirë, gjene, që mundi t'ia mbathë kapteri...

Do ta ketë gjetur batalionin?

— Kushedi. Me këto luftime që po bëhen,, — tha Teni.

— Janë xhindosur fricët... — foli Nedoja, pas një heshtjeje.

— Si qentë e tyre që po angullijnë. Por, do të venë në esfel... — shau Lili, duke shtrembëuar hundën e tij plloçake tërë prenka.

U ndien përsëri të lehurat e Murros.

— Dëgjoni Murron? — tha Nedoja. — Po u jep xhevapin ujqve.

— Ta merrnim Murron sonte me vete e t'ua lëshonim qenve të postbllokut, po të na binin në qafë... — foli Lili dhe përsëri lëvizi me dorën leshatore beretkën e tij.

— Ku ta jep xha Tushi... — ia preu Nedoja.

— S'na duhet Murroja, jo, — qeshi Lili. — Murro jemi vetë. Do t'u shkojmë nën hundë gjerma-nëve, dhe gjë s'kanë për të marrë vesh.

— ... S'i kemi shpënë Rimollit tjetër herë materiale si këto të sotmet... — tha Nedoja. — Mitraloz i rëndë.

— Dhe është fringo, — shtoi Lili.

— T'ua futim nazistëve dhe t'i bëjmë bërlok bijtë e bushtrave!

Hyri Fakja si një vastangar i gjatë e i thatë; pas tij u duk Leki i imtë dhe i shkurtër.

Tenit i vajti menjëherë mendja se çfarë mund të

kërkonte djali, ndaj deshi ta ndalte që në prag të derës.

— Si e ke punën?! — e pyeti me një tingull që donte të thoshte edhe «Ç'të duhet që vjen këtu!».

— Mos më prit vrullin, — iu përgjigj Leki.

— Fol çfarë do dhe ik poshtë.

— Ta thashë qëparë: Sonte nuk më ndalon dot.

— Leki, nuk do të bëj pazarllëqe, me ty. Ta kam shpjeguar çështjen, ndaj, nisu!

— Si është puna? — ndërhyri Lili, që për të parën herë vërente një vrazhdësi në zérin e Tenit.

— Nuk do të më pranojë në njësitin e transportit, — i tha Leki, i skuqur çuditërisht kësaj radhe në ftyrë, që gjithmonë kishte një ngjyrë verdhacuke.

— Këtu komandoj unë dhe jo ti, — u hodh Teni, i prekur.

— Këtu komandon lufta, në radhë të parë, — kundërshtoi Leki, — dhe ne të gjithë duhet t'i përgjigjetë asaj. Nuk ka dallim.

— Leki!...

— Po, shoku Teni.

Të dy heshtën, duke vështruar njëri-tjetrin. Nedoja, i habitur, i hidhte sytë një herë te djaloshi, një herë te Teni. Fakja kishte mbetur me kokën të varur, si ndonjë degë e thyer në majë. Lili po fërkonte kokën. Pastaj u kollit dhe tha:

— Ta gjejmë në mes tonë, të mos ashpërsohemi.

— Unë do të vij me ju! — foli me ngulm Leki.

— Jo sonte. Do të të them unë se kur, — u zbut disi Teni.

— Edhe sonte, edhe nesër, edhe pasnesër, më duhet. Jo si të ketë mbaruar dasma...

Sytë e zinj të djalit sikur të shponin.

Lili ndërhyri përsëri:

— Ç'bëri sonte, ç'bëri pas një javë, Teni. Le ta marrim edhe Lekin në njësitin tonë.

— Le ta marrim, — tha edhe Nedoja.

— Ta mbyllim këtë mesele, se ka disa ditë që nuk po më lë rehat edhe mua, — foli së fundi Fakja, duke ngritur kokën.

Teni nuk bëri zë.

Motori po gumëzhinte, mulliri po bluante dhe mielli po rridhte i verdhë dhe i hidhur. Ata kaluan një nga një dhe hynë në hambarin e thasëve të vjetër, ku ishin fshehur armët dhe municionet që do mbartnin atë natë. Ishte një kapicë e tërë me thasë bardhoshë, të grisur, me vrima e të shqyer, në të cilët kishin bërë punën e tyre minjtë dhe koha. I vunë klapën që brenda derës dhe filluan me shpejtësi nga veprimi. Ata mbanin mënjanë disa thasë të qepur e të rregulluar, me të cilët nxirrin jashtë materialet. Mitralozin e rëndë e ndanë vetët dështratin me këmbëzat, në një thes futën dy arkat me fisehekë; në një tjetër, arkat me bombat e dorës dhe arkën metalike të mitralozit. Teni i dha secilit thesin e tij. Për vete mori atë me dy arkat e fishekëve.

— Ç'po bën kështu?! — i tha Lili. — Një kuinal ke ndërmend të mbash vetë?

Leki, që po vështronte me një sy të habitur e me një dyshim që ishte gati të shpërthente rëndë, u hodh:

— Po për mua ç'latë?!

Teni e pa vëngër dhe nuk foli.

Lili hapi thesin e fishekëve, duke thënë:

— Nuk e mban dot njëri gjithë këtë. Fishekët duhen ndarë.

Ai nxori njërën arkë, i zbërtheu kapakun, duke futur nën dërrasat një hekur të gjatë, që e gjeti në një qoshe të hambarit, dhe shtoi:

— Ta zbratzim gjysmën në thesin e bombave.

Hoqi që këtej arkën e mitralozit dhe ia zgjati Lekit:

— Merr edhe ti pjesën tënde. Ja, kështu.

Pastaj hodhi gjysmat e fishekëve në thesin e bombave dhe përfundoi:

— Tani jemi në rregull.

— Revolet i keni të gjithë? — pyeti Teni. — Ua vini fishekun në gojë. — Ai u shikoi këmbët, dhe tha: — Këpucët do t'i nxjerrim. Jashtë ka ngirirë. Dëbora duhet të kërcasë e të jetë bërë shumë e rrëshqitshme.

Vështrimin e qëndroi mbi Lekin. Në atë vështrim ndihej përsëri një dhembje.

Djali i zgjidhi shpejt e shpejt këpucët gjysma dhe i mbajti në dorë. Nuk dinte ç't'i bënte.

— Silli këtu, — i tha atij Lili dhe bashkë me të tijat i hodhi këpucët në thesin e vet, ku ishte tyta e mitralozit.

Kishin marrë nga një copë zabllof dhe po mbështillnin këmbët, Teni pa këmbët e Lekit me çorapë të hollë pambuku të arnuar.

— Prit, — i foli ai djalit.

Kërkoi nëpër kapiçën e thasëve dhe zgjodhi një thes më të trashë. E grisi, e bëri rripa të gjerë dhe iu afrua Lekit.

— Ngrije këmbën.

Djali zgjati dorën për të marrë zabllofin.

— I mbështjell vetë.

Teni i ra dorës.

— Rri aty!

Ai u ul galic, i ngriti djalit këmbën e djathëtë me dorën e tij të madhe me kurriz të hedhur, e mbështeti mbi copën e zabllofit dhe filloi t'ia mbështillte. E vërtiti rripin gjer afër pulpës, duke marrë brenda edhe pantallonin kafe dalëboje. Pastaj ia lidhi me spango të trashë. Si i mbështolli edhe këmbën e majtë, u çua, vështroi punën që kishte bërë dhe pyeti djalin:

— Mirë i ke?

— Mirë.

Ai u kthye nga të tjerët.

— Gati jeni?

— Gati.

Këmbët e mbështjella me zabllof shëmbëllinen si putra ariu. Leki po i shikonte një nga një, shikon te edhe këmbët e tij dhe i dukej çudi, i vinte për të qeshur.

— Nisemi, — tha Teni.

Ai hapi derën dhe vëzhgoi se mos kishte njeri. Nuk ndihej asnjë lëvizje rrotull. Ia bëri me dorë Lilit, i cili doli i pari. Pas tij kaloi Fakja, pastaj Nedoja, në fund Teni me Lekin. Ata u futën në një rruginë të ngushtë të errët që ishte prapa hambarit dhe u drejtuan në një derë të vogël të hekurt, e cila të nxirrte jashtë fabrikës. Pranë derës Teni u tha të ndaleshin. Ndonëse e dinte se në këtë kohë nuk mund të kishte njeri jashtë, tërhoqi kanatin e derës me kujdes dhe zgjati kokën. Fytyrën ia fshikulloi thëlli mi. Në errësirë asgjë nuk dallohej. Teni lëshoi thesin në këmbët e shokëve dhe doli për të hetuar në

qoshet e ndërtesës. Pa rrëth e qark, hodhi shikimin tutje, në fushë, mbajti vesh. As dukej, as dëgjohej gjë. Ngriti pakëz buzën dhe fërshëlleu lehtë, duke u thënë shokëve se gjithçka ishte në rregull. Me nxitim, ai u kthye, mori thesin e tij në kurriz dhe u nis i pari, i ndjekur nga të tjerët.

Nata ishte fare e qetë dhe e ftohtë. Dëbora kishite pushuar. Retë kishin zënë të çaheshin dhe vendë-vende yjet po vezullonin. Shtresa e dëborës që mbulonte tokën ishte shndërruar në akull, që përgjante me një qelq të përmasave vigane, i shtrirë tejetej.

Ata u nisën njëri pas tjetrit, varg, me ngarkesat në kurriz, me njérën dorë në xhep, duke shtrënguar revolen. Printe Teni. I fundit ishte Lili. Lekin e kishin marrë në mes.

Heshtje e plotë, nën peshën e materialeve, të mendimeve e të ndjenjave të asaj nate.

Lanë pas kosheret dhe barakat gjysmë të anuarë të fabrikës dhe dolën në fushën e hapët, ku acharin e ndien më të mprehtë. Lakuriqësia e fushës dukej e egër dhe e mërzitshme. Rimolli ishte tutje, matanë lumi dhe asgjë e qartë nuk shquhej prej tij, veç një si njollë e zezë për ata që ia dinin vendin dhe kishin rrahur disa herë këtë rrugë në errësirë. Duhej të ecnin gati një orë kryesisht këtej lumi. Po ta kapërcenin, fshati nuk mbante shumë dhe rreziqet e mëdha kishin kaluar.

Vetëm në të dy krahët kishin tanë nga një pikë, të ndryshme njëra prej tjetrës. Më të djathtë, banesën e fundit të qytetit, kasollen e xha Tushit, e platur nën terrin dhe qetësinë. Më të majtë, si një çiban i verdhë, dalë tej qytetit, postbllokun gjerman,

frëngjia e të cilit ishte e ndriçuar. Përmes këtyre dy pikave duhej të bënин përpara, të arrinin në kohë dhe shëndoshë e mirë në Rimoll.

Tani ktheu pak më të djathtë, nga ana e kasolle. Këtej rruga largonte ca për në fshat, lumi ishte më i gjerë e më i thellë. Por kishin vendosur të mbanin kësaj ane, meqë herën e fundit gjermanët i kishin ndier dhe i kishin ndjekur.

— Si jeni? — pëshpëriti Teni, mbasi ecën një copë herë.

— Pikë, — erdhi nga fundi zëri i Lilit.

— Leki, si ndihesh? — pyeti përsëri Teni.

— Fare mirë.

— Këmbët mos i ngre shumë. Akulli kërcet. Hiqi një çikë zvarrë. Je më i sigurt për të mos rrëshqitur.

Lekit i tingëlluan të dashura këto fjalë, të thëna me një farë butësie, krejt ndryshe nga zëri i fortë dhe pak i ashpër, zakonisht, i Tenit. Djaloshi ishte tani gati të zbatonte qdo urdhër, t'i nënshtrohej qdo porosie që do të vinte nga komandanti. Ai ishte bërë anëtar i rregullt i njësitit. Ishte i barabartë me të tjerët. Nuk do ta shikonin si çunak, as si të paaftë. Kjo rrugë do të ishte tani e tutje dhe e tija.

Nata e parë që ai po shkonte në Rimoll. Fshati për të nuk ishte i panjohur. Kishte qenë disa herë. Kishte vajtur me biçikletë nga xhadeja, ditën. Atje kishin bërë nja dy mbledhje të rinisë. Një herë kishin dhënë shfaqje artistike për fshatarët. Ai vetë kishte kënduar këngët. «Ato maja rripa-rripa» dhe «Rini, rini!», i shoqëruar me kitarë. Në Rimoll kish-

te qenë edhe vîte më parë, i vogël, në përvjetorin e rënies së tre komitëve në luftë me turqit.

Por, kjo ishte nata e tij e parë, në këto kushte, kësaj ane, në cingërimë, me shokë të njësitet, me armë e municion mbi shpinë për partizanët. Ai kishte ndier gjëzimin e shqetësimin e ndarjes së trakteve, të marrjes së revoleve nga rripat e oficerëve në kinema, të zbulimit të numrit të ushtarëve e të llojeve të armëve të armikut. Por të gjitha këto ishin bërë për të tashmë të rëndomta e i dukeshin të thjeshta. Atë e shqetësonte kryesish mendimi i pjesë-marrjes në njësitet luftarake që kishte qyteti. Ky shqetësim i kishte lindur prej kohësh, para se të pranohej në Rininë Komuniste, kur ishte vetëm një i ri antifashist. Atë ia kishte ngjallur Pani. Prej tij ishte tërhequr së pari në ndeshjet e rinisë. Ata ishin shokë, ndonëse Pani ishte disa vjet më i madh. Megjithatë, Leki kishte vënë re se ai nuk i tregonte çdo gjë që bënte. Ai merrej me punë të rëndësishme e të fshehta. Lekit i kishte rënë në sy. Herë-herë nuk vinte natën në shtëpi. Leki e kishte pyetur se ku shkonte, me se merrej. Pani ia sillte rrotull, por nuk ia thoshte të vërtetën. Më vonë Lekit i vajti mendja se shoku i tij do të ishte pjesëtar i njësitet të transportit. Kur u bë i ri komunist, Pani sikur iu hap një çikë më shumë. Ai i linte të kuptonte se njësitet e transportit bënин një punë të madhe, i kishte përshkruar vështirësitë e shumta që kapërcenin, ndonjë ndeshje që ishte bërë me armikun. Të gjitha këto ia tregonte në mënyrë aq të gjallë, sa dukej që edhe vetë ai kishte qenë në njëren ose në tjetrën ngjarje. Leki mahnjitej dhe një farë zilie i lindte për të gjitha ato të bëma dhe për ata që i kryenin. Dhe

ëndërronte tē ishte midis tyre, tē dilte me ta natën nga qyteti, tē shkonte t'u shpinte partizanëve këtë ose atë...

Më së fundi, kjo ëndërr i ishte plotësuar. Ndaj ai ishte i lumtur son te.

Në çastin kur u ndodhën më afër kasolles së xha Tushit, Murroja filloi tē lihte. Një buçitje zëri, me një tē hapur tē gojës, sikur shpërthente nga një gropë. Pastaj, një si gérhitje e thellë, që niste ngadalë e vinte duke u shtuar e u trashur, që vazhdon te duke u shtrirë përmbi akullin dhe pakësohej e tërhiqejej përsëri, sa gati shuhej fare. Një lehje e dytë dhe e tretë, tē njëpasnjëshme. Shkundja e një trupi dhe tringëllima e mbytur e një zinxhiri.

— Mos na lëshohet... — u ndie zëri i Fakes.

— Është i lidhur. A nuk dëgjon zinxhirin? — tha Nedoja.

— I lidhur s'është, — ia priti Lili. — Kushedi ka marrë zinxhirin me këmbë. Por nuk lëshohet, jo. Na e njeh erën.

— Ty tē njeh mirë, i ke vajtur disa herë xha Tushit.

— Dhe huqet ia di. Mos u tremb, Leki.

— Jo, jo.

— Kështu, — foli Teni.

Angullima tē zgjatura e tē përsëritura erdhën nga ana e postbllokut. Disa më me klithmë, tē tjerat më tē ngjirura. Atëherë ia dha prapë Murroja. Qentë e postbllokut nuk po pushonin. Murroja po e ngrinte zërin më lart, po ushtonte si një shpellë dhe mundohej t'u kalonte atyre.

— Nxitojmë, — tha Teni.

Ai shpejtoi hapin dhe pas tij bënë me ngut Nedoja, Leki, Faikja dhe Lili.

— Kini mendjen se mos shkisni, — foli prapë Teni. — Hiqni zvarrë këmbët dhe shikoni mos ju hidhen ngarkesat në kurriz e dëgjohet ndonjë përplasje e materialeve. Nata përhap edhe zhurmën më të vogël.

Qentë e postbllokut heshtën. Atë përleshje angullimash e lehjesh e mbylli Murroja me një britmë të prerë.

Dhe qetësia mbi të gjithë natyrën ra përsëri.

Njësiti po zvarriste me nxitëm hapat mbi tokën e ngrirë. Fërfëritja e tyre mezi ngrihej përmbi akuillin e shpërndahej memece.

Lekit iu kujtua kur bënte kolovajzë në skerkën aty sipër shtëpisë së tij. Ishte një kolovajzë e mirë ajo, e gjatë dhe që mbante tërë dimrin, se vendi ishte i kthyer nga veriu. Mblidheshin tërë fëmijët e lajges. Ai nuk ndahej që andej gjithë ditën, gjersa ngrysej. E ëma dilte dhe e qortonte. Por, ja, ajo kolovajzë po i hynte në punë tani. Po të mos jesh i stërvitur, në këtë akull të kësaj nate, ndonëse me këmbët të mbështjella me zabllof, mund të rrëzohesh e të thyesh kokën.

Ata po rrëshqitnin, po rrëshqitnin, dhe zabllofët lëshonin fërfëritjet e tyre të mekura. Nata ishte fare e qetë. Mund të ndieje çdo zë e çdo shqetësim të kësaj nate të akullt, e cila fytyrat e njerëzve po i mpinte dhe duart e tyre po i mardhte.

«Haushvanerai... haufynkleht...», u dëgjua një përzierje e paqartë fjalësh dhe të briturash nga ana e postbllokut.

— Qëndroni, — u foli Teni shokëve. — Mos lë-vizni. Gjermanët kanë dalë.

Ata ndalën në vend, dikush më i gjatë, tjetri më i shkurtër, dikush i kërrusur, tjetri pak i epur, trupore të ngrira në hapësirën e shkretë, të zezë dhe njgjethëse.

«Haushvanerai...», përsëriteshin fjalët e pashkqura dhe britmat e mbytura të postbllokut. Pastaj, ajrin e çorrën ca si të qeshura që gjerryenin gurmazet nga kalonin dhe të kujtonin gërvishtjet e angullimavë të qenve pak më parë. Këtyre çjerrjeve qentë u bënë jehonë. Ndonëse si të trembur e të tulatur, ata nxorën hungërimat e tyre. Dhe u bë një trazirë e një koklavitje njerëzish e qensh, sa vështirë t'i ndaje. Muroja, si i tronditur dhe i inatosur së tepërmë nga këto, ia dha me të lehura të forta, të larta e të dendura. Nata gjëmoi dhe ajri i saj sikur u nxeh. Atëherë nga postblloku erdhi një batare mitralozi.

— Shtrihuni barkas! — urdhëroi Teni.

— Plumbat kishin fërshëlyer afër tyre.

Ata ranë si një bllok i vetëm dhe mbetën duke përgjuar.

— Na pikasën... — tha Nedoja.

— S'ma merr mendja, — iu përgjigj Lili. — Ata po shtien në drejtim të Murros.

Batare të tjera mitralozi u përhapën, si bie tehu i kosës mbi tufën e barit. Ata dalluan flakën që dilte nga gryka e armës.

— Po shtien nga frika, siç e kanë zakon, — foli Teni.

Mitralozi po gogësinte me nxitim, qentë po angullinin dhe Murroja vazhdonte të lihte, pa dashur t'ia dinte as nga të shtënat dhe as nga angullimat.

Plumbat po shponin errësirën në të dy krahët e postblokut. Por, së fundi, ata u dendësuan në anën e Murros e të njësitet. Dy palë hungërima e kishin marrë njësitin në mes. Dukej sikur qentë ishin shkëputur nga postblloku dhe ishin afruar. Dhe mitralozi ishte përqëndruar tanë e po qëllonte në një drejtim. Viu, viu, viu, plumbat po i shkonin njësitet mbi kokë.

Ç'po ndodhë? I kishin kuptuar? Po i sulmonin? Ç'duhej bërë? A nuk duhej marrë ndonjë masë?

Teni po mendonte se ishin në gjendje të vësh-tirë. Mundet që gjermanët të shtinin kot, siç bënин gati çdo natë; sidomos këto kohët e fundit, që kur po zhvillohej operacioni, por edhe mund të kishin dy-shuar gjë. Pse qëntë ishin lëshuar përpara?

T'u përgjigjeshin? Gjermanët mund t'i goditnin nga postblloku, që prapa atyre mburojave prej betoni që kishin ngritur. Dhe mitralozi i hante mirë në këtë vend rrafsh, ku nuk kishin ku të mbronin kokën. Jo, këtu nuk mund ta ndiznin zjarrin. Sa larg mund të ishin nga ai hendeku i cekët, i cili priste tërthor një copë të arës që kishin në rrugë. Pesë-mbëdhjetë metra? Ndofta më shumë? Atje mund ta ngrinin mitralozin e tyre dhe t'u bënин ballë gjermanëve, në qoftë se këta i kishin zbuluar dhe donin t'i asgjësonin.

— Mund ta kenë edhe me ne, — u tha Teni shokëve. — Prandaj këtu nuk qëndrojmë dot. Duhet të zëmë hëndekun e arës. Ti, Lili, Fak, dhe ti... — Teni e ndërpren fjalën, pastaj vazhdoi.... Leki, njëri pas tjetrit, me një largësi prej tre-katër metrash, të zvariteni gjer te hendeku dhe të ngrini atje mitralozin. Unë me Nedon do të qëndrojmë këtu gjersa ju

të zini vend. Po të shikojmë se gjermanët na kanë vënë në shenjë, para se ju të arrini atje, do të përpinqemi t'i çoroditim, duke u flakur nga një bombë në drejtime të ndryshme, që të largojmë vëmendjen e tyre nga ju. Nisuni, o burra!

Lili u zvarrit me tytën e mitralozit në kurriz, pas tij Fakja me shtratin e këmbëzat, dhe i treti Leki, me arkën metalike të mbushur me kollanët e fisehekëve. Me krahët e këmbët, duke bërë lëvizje të bashkërenditura të gjymtyrëve, ata dukeshin disa gjallesa të papërcaktuara, të çuditshme, që diçka kërkonin e përdicë përpinqeshin, sikur do të kafshonin akullin e do ta brenin atë.

Lili në krye dhe më pas Fakja, sikur po hareshin midis tyre, njëri të shmangej e të ikte, tjetri të mos e linte të largohej e ta kapte. Leki po mbetej më i ndarë prej tyre. Këtë zvarritje po e provonte për të parën herë. Ai ishte struktur nëpër qoshe për të bërë një zbulim a për të ngjitur një trakt, ishte kacavjerrur në mure të avllive, kur patrulla e karrabinierisë i kishte rënë në gjurmë, kishte vrapiuar e kishte kaptuar gropë e kanale, por nuk i kishte qëlluar të bënte një copë rrugë kështu, i mbështetur në gjunjët e në brinjët e tij, në kraharorin e barkun, mbi tokën, mbi akullin. Po shikonte të tjerët që po i knin me shkathtësi dhe e ndjeu veten të pazotin. I erdhi inat. Gjithë trupi po i lëshonte miza të nxehta. Kurrizi po i djersinte. Deshi t'i jepte trupit një shtytje të fortë përrpara, që t'u afrohej shokëve. Zgjati duart dhe bëri të ngulte thonjtë në akull, që të merrte fuqi e të lëshohej me hop tutje. Por thonjtë i përvëluan, sikur t'i kishin shkuar një brisk të mprehtë midis tyre dhe mollëzave të gishtërinjve.

Mbeti në vend, s'e duroi dhembjen që i theri në zemër, i shkoi mendja të ngrihej në gjunjë dhe të ikte këmbadoras. Tani gjermanët nuk po qëllonin në drejtëm të tyre. Ata po shtinin, por në krahun tjetër të postbllokut. Megjithatë, hoqi dorë nga ky mendim. Ai duhej të zbatonte urdhrin e Tenit. T'u fshiheshin sa më shumë syrit të gjermanëve. Dhe vazhdoi të mundohej të zvarritej, për të shkurtuar largësinë nga shokët, për të arritur në vend në kohën kur ata të kishin ngritur mitralozin, që t'i furnizon te me fishekë e t'i përgjigjeshin armikut, apo Teni t'u thoshte të hapnin zjarr. Tani po i dëkujt sikur po rrëshqiste më mirë, ndonëse ishte ende shumë prapa tyre. Po u jepte, po u jepte këmbëve e krahëve, gjithë trupit, e po merrete frymë me gojë të hapur, duke dihatur. Thëllimi po i mpinte dhëmbët e po i digjte fytin. Kurrizin e ndiente të djersirë, por në kraharor e në bark sikur i ishte ngjitur një plakë e ftohtë. Lagështira e akullit i kishte kaluar nëpër rroba dhe i kishte rënë në mishin e ngrohtë.

Po ikte, po ikte, po afrohej, sido që të tjerët mund të kishin arritur te hendeku. Edhe ca dhe do të ishte pranë tyre. Ah, po e pengonte dhe kjo pesha në shpinë! Arka po ia vriste shpatullat, dhe kjo ia cungonte fuqitë e krahëve.

Pa që diçka po lëvizte drejt tij. Kush ishte? Ndonjëri po kthehej? Pse?

— Hej, Leki, ma jep arkën mua, — dëgjoi zërin e Fakes.

— Jo, mirë e kam.

— Sille! Ja, aty është hendeku. Ne e ngritëm mitralozin. Sille!

— Lërmë, Fake, nuk është punë kjo! Duhet të mësohem edhe unë.

— Do të mësohesh. Por sille tani, se mund t'ua vërvitim gjermanëve.

Fakja zgjidhi litarin, hodhi thesin mbi kurrizin e tij dhe u nisën të dy krah për krah. Vërtet, hendeku nuk kishte qenë shumë larg. Të tre u vunë në gatishmëri pranë mitralozit.

Nata vazhdonte të mbushej nga krismat e mitralozit të postbllokut. E, herë-herë, angullimat dhe lehjet i shoqëronin ato. Lili, Fakja dhe Leki panë se drejt tyre ishin nisur Teni dhe Nedoja. Në këtë ko'hë mitralozi gjerman ia dha kësaj ane. Të dy shokët po zvarriteshin me shpejtësi. Edhe pak metra u kishin mbetur. Mund t'u flisnin e të dëgjoheshin pa qenë nevoja të ngrinin zërin.

— Teni, ne gati jemi. Si t'ia bëjmë, t'ua futim nazistëve? — tha Lili.

— Jo, prisni, — mori përgjigje ai.

Teni dhe Nedoja arritën e u futën në hendeke. Plumbat filluan të fërshëllënин të shpeshtë lart e poshtë, në të dy krahët e njësitet, ata shkonin gati rrafsh me tokën.

— Ç'djall?! Të na kenë parë?...

Batare plumbash. Shirita të verdhë përshkonin natën.

— Derrat e derrave!

— Në gojë ia keni futur fishekët mitralozit?

— Është për zjarr.

— Mirë. Ti, Nedo, na një bombë.

— Po mua?... — u hodh Leki.

— Di ta përdorësh?

— Di.

— Na, por kujdes. Në qoftë se shikojmë që naziştët e kanë me ne, apo bëjnë të na sulmojnë, do të jap urdhër dhe atëherë do t'ua këputim. S'kemi si bëjmë ndryshe, ndonëse materialin duhet ta kur-sejmë pér partizanët.

Ata pritën me gishtin në këmbëzën e mitralozit, me bombat gati pér t'ua hequr rripat me dhëmbë. Pritën. Plumbat u vinin breshër. Si asnijëherë tjetër, gjermanët e postbllokut e ndezën flakë atë natë.

Por, papritmas, batareja e tyre u pre. U dëgjuan britmat e njerëzve dhe angullimat e qenve. Pastaj, një breshëri mitralozi ushtoi tutje postbllokut. Britma, të qeshura të ngjirura, angullima përsëri. Dhe, në fund, heshtje e plotë e natës së ngrirë.

— Aq e patën, — foli Nedoja.

Që larg erdhi një e lehur e Murros.

— Këtë po thotë dhe Murroja, — qeshi Lili.

— Të nisemi, shokë, se sonte na vonuan, — urdhëroi Teni.

Ata morën përsëri rrugën varg. Po linin pas gjithnjë edhe më shumë qytetin dhe zemra po u rrithet e lehtësuar e me gufim, se po shkonin drejt Rimmilit.

— Kemi dhe shumë? — pyeti Leki.

— Jo, — i tha Nedoja. — U lodhe?

— Nuk e kam aty. Nuk e njoh këtë rrugë...

— Se mos është rrugë kjo!... Ja, edhe një çikë, dhe vemi te lumi. Përtej tij, fshati është dy hapa. Ne s'e kemi punën atje, po në plevicë.

— Në plevicë?

— Atje na pret njësiti i fshatit; ky është vend-takimi ynë. Gjer atje. Do të qëndrojmë gjer afër të

għħirit. Pastaj do tē dalim njē nga njē dhe do tē ktheħem i nē qytet tē shpérndaré, qē tē mos biem nē sy.

Kësaj ane fusha kishte hapésiré dhe frymémarrje mē tē madhe. Lisa tē lartē sajoheshin si vija tē zeza tē hequra nga toka drejt qiellit. Nēpér degét e tyre tē zhveshura kishte thurur njē kēngé fshikulluse murrieria, qē gjarpéronte tejtej.

— Paska eré fusha! — tha Fakja.
— Avazi i saj, — iu përgjigj Lili.
— Shpejtoni, shoké, qē tē mos na hajé, veriu, — foli Teni, — Leki, ule kokén dhe duart mbaji nē xhepa!

Djali i kishte futur gishterinttē e mēdhenj nēn litar, aty nē kraharor, qē ta ngrinte njē ciké ngarkesén, e cila i ishte varur. Cingērima po ia digħżei duart, dhe gishterinttē nuk po i ndiente. Kur i hoqi duart, sic i tha Teni, kuptoi se dy gishterinttē e mēdhenj i ishin ngjitur nē litar. Ngarkesa i rēndoi poshtē, i ndjeu pak tē ċliruara shpatullat, kurse duart nē xhepa sikur ia mbështolli njē push i vakét.

— Ja lumi, — tha Nedjoa.
Ata qēndruan nē buzè tē tij. Nuk i dukej as rrjedhha, nuk i dëgħohej as gurgullima.

— Ka ngriré, — foli si me vete Teni.
— Me kêtē kiāmet, doemos... — ia priti Lili.
— Por nuk dihet sa mund tē jetē cipa e akullit...
— vazħdoi Teni. — Mund tē na għennejé, tē ċahet e tē fundosemi.

— Duhet t'ia marrim andej, si radħen tjetér, — tha Lili, duke bérë me dorë djathas. Atje ka qené mē ceket.

— Andej do tē drejtohem, por do tē dredhojmé,

se ka grapa; uji shtohet, dhe në ato vise akullin nuk
është i trashë uji që rrjedh nën tē e Ingroh dje e ha.
Kësaj duhet t'i shmagemi sa të mundim. Do të zi-
hemipën dorej tuq. Ajoq do ëm mundur që jetet.
Zunë dhë shtrënguan duart njërimë tjetrin. — I ktheni brinjën bregut, — porositi në fund
Teni, kur ata zbritën mbi akullin e lumenit. — nsjek e
Dorën e ndjathtë. Lekit ia pushtoi pellëmbamë
shtore e Nedos, kurse të majtën ia shtrënguan gish-
térinjtë e gjatë të Fakës. Nëpërmjet këtyre shtrëng-
gimeve ai ndjeu kujdesin, sigurinë dhe një të ngroh-
të. Duart e tij kishin ngrirë më shumë. —

Duke hequr këmbët, ata ecën djathtas, pastaj
bënë më të majtë; në krah të kundërt të rrjedhës së
lumenit.

— Akulli po na mban, — tha Lili. — Mirë jem qjer këtu, — u përgjigj Teni.
— Të bëjmë edhe disa hapa këtej, pastaj du-
het të marrim prapë djathtas, — vazhdoi Lili.
— Po, — miratoi Teni. — Dhe pastaj përsëri maj-
tas, që të hidhemi në brég, atje ku janë shelgjish-
tet.

— Ai është vendi ku dolëm dhe herën e parë.

Kishin dredhuar përsëri më të djathtë. Kthesa
e fundit do t'i conte në krahun e majtë, do t'i nxirr-
te në breg, prej nga plevica nuk mbante shumë.

Teni u ndal. Qëndruan dhe të tjerët.

— C'është? — pyeti Lili.

— Mos shkuam shumë kësaj ane?

— S'më duket. Hej, dreq! Me këtë errësirë...
Njëherë vetëm kemi kaluar...

Teni mendoi të kthehej majtas, por, sa zvarriti
hapin e parë, krak, u dëgjuat çarja e akullit, dhe ai

di fundas né i ujia qesi willokoçit. Pas tij rané Nedojé
diše Lekib kurşen Fakjare Lilibi imberthyen né vendlisë
-is 55 Shokib mhabunat iuthirri Teni, + Gropéa Ké

Ai ishte anuar më të majtë, por kishtë rënësi dhe dorënë i Nedosinjuk te kishtë lëshuar. I përmblajtur nga tifujja e Tenit, Nedoja kishtë mundur të mbledhë veten e tëmmos rrëzohet në turinj; vegj dorale intë kishtë shpëtuar nga ajo e Elikit. Ky ishte shkëputur ngai gjeri dyja sani. Përtijëri çast e kishtë humbur, qëdo ishte n'plasur, përmblin Nedon. Ðhe ishte përbajturi n'pas tijorët është që është shtrirës, nisëbërisht ujeti is evenig. Si ishte? I kishë veshur e veshur, i cili ka transfigur

— Si ja ei läki sellest, et ta mäe täte on tröndlitud.
Tasdasid neil põhjapäevast saab õhtustiis, kuid seda ei saa vältida.

— Në rregull, — shtoi Leki.

— Asaj që i fu' tremba, — vazhdoi më i qetë Teni.

— A mund t'ju têrheqim që tê ngjiteni lart? —

i tha Lili.

— Nuk ngjitemi dot. S'kemi ku tē mbështetëmi. Akulli është i hollë. Ju bëni prapa dhe merrni majtas. Na dilni përpëra dhe na prisni gjersa tē kalojmë gropën.

Uji u kishte vajtur Tenit, Nedos dhe Lekit përmby mes.

— Ngulini këmbët, — u tha Teni. — Lumi nuk
është i rrëmbyer. Të ngremë ca ngarkesat që të mos
na lagen. — Ai u rregulloi dhe u shtrëngoi Nedos e
Lekit thasët pak më sipër. Ngriti edhe të tijin. — A
ndiheni të vrarë gjékundi? — pyeti.

— Jo.

— Sillni duart. Ja, kështu, në ije do t'i biem lumit. Gropa nuk besoj të jetë e madhe. Pastaj do të dalim në cektinë. Këmbët, gjithnjë zvarrë.

“Groparkishte menjnjë kurdhë e vogël. Ata nuk u vonuan ta kalonin dhetë arruinin Lili me Fakes që po i prisnin në zallës së mbaruar, ngal njëzipë e akullt. Por, kur u ngjiten në breg, i mbaruar e zyre, që kullojnë shqipë; filluan të mbingrin. Muriqja i mbarului ata me okita, që nga mesi i poshtës: Zabullofet i këmbët bëye jnu, bëgësi kalltan, Lekiti i ishin shpërmeshtur në një dyshme. Tëk i vnu i lillës mësuar. Një kësive. Një kësive.

— Dales, të gjithësh ti jeshi! —

— Ç’ti mbështjetësh! A t’i bëj janë bëre si kockë edhe zabullofet, i ndhej corapët. Të jete imë këmbët e tuaq, t’ndërhyri Lili q. Pastaj shkru: “Të është, emajtëm i plevice. Atje në pjetë plehu. ! bnev imusq H! është që

Leki nuk kuptoi se ç’donte të thoshtë me fjalët e fundit Lili, por nuk pyeti. Vërtet qod kupti këse. Tani, ite tregjet, Tenit, Nedos, dha Lekiti këmbët i ishin bëre si trarë, dhe atë mesi i lëviznës. Edhe kofshët, barku dhe vithet u ishin ngurosur.

— Leki, lëshojet e thesin! — foli Lili q. eH —

— Më lër rehat.

— Nuk — Lëshojë, të them! S’të duam vëtëm përsonte. Këtë rrugë kemi për ta bërë sa e sa herë, gjersat t’ua thyejmë zverkun nazistëve. Qëndro këtu!

— Lili, e kapi djalin për krahu, ia hoqi thesin dhe i tha Fakes t’ia lidhëte mbi ngarkesën e tij.

— Njësiti i Rimollit u dol përpëra pa arritur në plevice.

— Pushka partizane.

— Plumbi tiranëve.

— Njësitet këmbyen parullën.

— U vonuat. Filluan të shqetësohen, — tha me zë të trashë njëri nga njësiti i fshatit.

— Do t'jua tregojmë më nge; tan i jemi bërë pér qepë e pér kripë, — iu përgjigj Teni.

— Shgarkoni, — foli fshatari.

— Sosëm tan i.

Afshi i plevicës u ra në fytýrat më i dashur dhe më gjallërues se rrezet e diellit.

Një llambë me fitil të ulur hidhte një drithë verdhoshe. Një kalë hingëlliu. Leki vuri re se ishin dy kafshë dhe dëgjoi bluarjen e dhëmbëve të tyre.

Ata u ulën përdhe të rraskapitur.

— Qënkeni bërë në ditë të hallit! — u habit fshatari me zë të trashë. — Shpejt, në pleh, në pleh të gjithë! Hapuni vend! — u foli ai dy fshatarëve të tjere.

Leki nuk po merrte vesh, ndonëse ai po dëgjon ato që kishte thënë edhe Lili rrugës. Ai pa Tenin dhe Nedon që u futën në plehun që kishin hapur fshatarët.

— Hë, ç'pret?! — i thanë këta.

— Përse?

— Hyr shpejt! Se, kështu si je bërë ti, akull, vetëm plehu të shpëton nga pleviti dhe nga ngrirja e mishravës.

— Mos ia vini re. E ka pér herë të parë, — u shpjegoi Lili.

Të gjithë ishin mbuluar nga plehu që u kishin hedhur përsipër me furka fshatarët. Lekit po ia shponte hundën era e rëndë e plehut. Por ai kishte filluar të ndiente një lehtësirë në trupin e tij. Ngrohtësia po ia shkrinte kockat dhe po i sillte gjumë. Por ai po mundohej të mos i myllte sytë.

Pa Tenin që po e vështron te mendueshëm. Në fytyrën me nofulla të trasha të komandantit të një-

sitet po shikonte një farë prehjeje, të cilën ai e pat zbuluar edhe herë të tjera, pas një pune të rëndë, që kishte përfunduar mbarë.

«Ta kem fituar besimin e tij?», tha me vete Leki.

Fshatarët kishin ngarkuar armët dhe municipionin në kafshët.

— Do t'i nisim; — iu drejtua Tenit ai fshatari zë-trashë, që ishte një burrë mesatar në moshë e në trup, me faqe të futura e me mustaqe të shkurtra.

— Urdhri na erdhi qëparë nga batalioni. Në Çukën e Shqipes u kishin dhënë dërmën gjermanëve sot.

— Si t'ju kenë thënë... — foli Teni. — Më parë, më mirë.

Kafshët dolën nga plevica.

— Sa t'i përcjell dhe u ktheva, — tha fshatari.

— Mos u mérzitni. A ndihëni një çikë më ndryshe?

— Mos na ki gjalën, — iu përgjigj Lili. — Ne ia dimë këmetin këtij ilaci...

Ai deshi sikur ta ngacmonte pakëz Lekin, por ndërroi mendje. U kthyë nga djali dhe i bëzëgeshi. Por këtë e kishte zënë gjumi. Qetësia e ëmbël kishte mbuluar të gjitha tiparet e njoima të djaloshit. Dhe Lili, bëzëgeshi përsëri.

— Ai do t'i kthehet, — tha fshatari. — Ai do t'i kthehet.

— Ai do t'i kthehet, — tha Lili. — Ai do t'i kthehet.

— Ai do t'i kthehet, — tha fshatari. — Ai do t'i kthehet.

— Ai do t'i kthehet, — tha Lili. — Ai do t'i kthehet.

— Ai do t'i kthehet, — tha fshatari. — Ai do t'i kthehet.

— Ai do t'i kthehet, — tha Lili. — Ai do t'i kthehet.

FAMILJA E USHTARIT

Kur arritëm në avllinë e ulët të shtëpisë, Fatosi nxitoi përpara nesh, duke na ftuar:

— Urdhëroni! Urdhëroni!

Në muzgun që po zbriste nga malet e larta, në grykën e të cilave ishte futur lagjja e sipërme e fshatit, shtëpia e re shndriste nga vijat e trasha të gëlqeres, që rrëthonin gurët e murmë. Pjesa e poshtme e mureve zbardhët fare dhe humbiste në bardhësinë e dëborës, që mbulonte oborrin.

Në derën e mesit doli me shkathtësi një vajzë me gërshteta mbi kraharor; pas saj u dukën një nuse faqekuqe dhe një grua e pakët nga shtati, por e plotë. Vajza dhe nusja ecën drejt nesh. Atéherë, të dera u dha një burrë i gjatë e i thatë, me një takije të errët në kokë, i cili na foli:

— Mirë se na vini, mirë se na vini, o miq!

Në dhomën e ndriçuar nga drita elektrike, na vunë të uleshim pranë stufës. Vajza solli një krah dru. Ndonëse flaka bubullinte, ajo futi edhe një kopacë.

Të gjithë pjesëtarët e familjes na u mblodhën në gjysmë rrëthi. Ne ishim të lodhur. Unë më shumë, se

mjeku ishte ngjituf në fshat që tië drékë. Por, edhe ai, gjithë pasditen kishte pritur e parë në ambulançë shumë gra, fëmijë e burra.

Kisha bërë tri orë rrugë që nga qendra e lokalitetit gjér në fshat, ku më duhej të qëndroja një ditë për një studim historik, që i nevojitej muzeut tonë. Rruga ishte e keqe: thikë e përpjetë dhe me dëborë. Vetëm se lodhjen sikur ma lehtësonin ajo bukuri e ashpër, por madhështore e natyrës, dhe këershëria përi i njohur sa më mirë ato vise, që nuk i kisha shkelur ndonjëherë. Male njëri mbi tjetrin, male të përziera e të gërshetuara ishte gjithë vendi. Majat e tyre shponin qiellin e vogël, ku lundronin re të bardha e të përhime. Malet duke shin sikur kishin shtrirë pëllëmbët e tyre, kishin thurur gishtërinjtë njëri me tjetrin dhe nuk kishin lënë asnjë shteg ku të kaloje. Në faqet e tyre, si në prehër të bardhë, ato mbanin gjithë fshatrat e lokalitetit.

Isha në fund të karvanit të mushkave të ngarkuara me pleh kimik në depot e lokalitetit përkoooperativën. Fshatarët kthehen në kohë më kohë, më shikonin me dashamirësi dhe më pyesnin nëse isha lodhur. Fatosi mbajti kafshën e tij dhe më priti. Ai pa fytyrën time të djersirë, ngulmoi që të hiqja çantën nga shpina, dhe e hodhi mbi samar. Nga e nxeha që kisha në trup, kisha nxjerrë gozhupin e trashë dhe po e mbaja në dorë. Një fshatar tjetër mormori dhe e vendosi mbi kafshën e tij.

Fatosi nuk m'u nda, ndonjëse lodhja më shkëputste mjaft nga karvani. Ishte i ri Fatosi, me shtat mesatar, më flokë e sy të zinj, me një shikim të qetë. Ai ishte fjalëpak. Kishte ndonjë mot i martuar.

Folëm rrugës dhe u njohëm me njëri-tjetrin. Ai më ftoi në shtëpinë e tij.

Kur hymë në fshat, në të dalë të ambulancestakuam mjekun e lokalitetit, me të cilin njiheshë. Sytë e tij të mëdhenj dukeshin të buhavitur, kurse në fytyrën gjatore dhe të ngjallme kishte një tis zbehtësie. Fatosi ngulmoi që edhe ai të vinte bashkë më mua.

... Tani, tok po rrinim rrotull stufës, duke mbajtur në duar filxhanë me çaj mali, kundërmimi i të cilit kishte mbushur dhomën, ndiheshim të clodhur. Dekoja, motra e Fatosit, na i kishte mbushur plot ata, filxhanë të bardhë të mëdhenj, me buzë të trasha. Mjeku e thithë lëngun e verdhë me një zhurmë të zgjatur. E zonja e shtëpisë, duke na vështruar si ndonjë shqerrë e butë, herë mua, herë mjekun, na pyeste:

— A u clodhët? Apo do të shtriheni në minder? Shtrihuni pakëz, gjersa të bëjmë gati darkën. Shtrihuni!

Ajo na kishte folur përfëmijët e saj, përf një vajzë më të madhe, që e kishte martuar në Skrapar dhe përdjalin e dytë, i cili ishte ushtar. Sa na kishte zënë në gojë këtë të fundit, i shoqi kishte ndërhyrë dhe ia kishte prerë fjalën.

I zoti i shtëpisë, xha Tareja, që i kishte kaluar të gjashtëdhjetepesat, na kishte lënë në minder, kurse vetë kishte ndenjur në karrige, kundrejt nesh. Ai qëndronte kokoroc, me kurm të drejtë, i hajthëm, sidru thane. Nuk fliste shumë, por fjalët, herë-herë, i kripte me një shpoti të lehtë, pa të keq, ose u linte atyrrë ndonjë kuptim të pashkoqitur, ndërsa sytë e tij si rruaza ndritnin.

Biseda jonë kapercante nga një gjë, në tjetren. Ai më shumë pyeste. Tregonte dhe për kooperativën, për punët, për ato që mbante mend nga, é, kaluara dhe për jetën që bënte sot.

Dekoja hyri e zhđervjellët dhe me një buzëqeshje në fytyrën e celur: pas saj, nusja, Ato shtruan tryezën dhe vendosën të ngrënati. Fatosi solli rakinë, mbushi goftat.

Xha Tareja e ngriti i pari. Mjeku e uroi edhe për djalin ushtari. I zoti i shtëpisë e pa atë drejt, në sy, sikur xheç deshi të thoshte; por nuk foli; vuri gotën në buzë dhe e zbrazi givsmën. Si e lëshoi mbi tryezë; shkoi trinën e dorës mbi mustaqet e rralla dhe u kollit. M'u duk sikur çeli zërin për të thënë atë që deshi pak më parë, pas urimit të mjekut, por sikur u mbillaçit, u gëlltit edhe një herë dhe heshti.

E shoqja erdhë dhe u ul pranë mjekut. Xha Tareja e shikoi me habi. Gruaja u mat të fliste, por dukej e druajtur. I shoqi u kollit si enkas. Fatosi po mbushët përsëri gotat. Më në fund, gruaja i tha mjekut ngadalë:

— Doktor, nusja po bën motin që më ka hyrë në shtëpi, mirëpo...

Në këto fjalë, Fatosi u skuq. Dora iu drodh dhe disa pikë raki ranë mbi mbulesën, e tryezës. Xha Tareja mori frymë thellë.

— Mos u mérzit. — i tha mjeku gruas. — nuk është vonë. Sidoqoftë, e shikojmë...

— Hé, të këqen! Më rrofsh!

Midis të tre njerëzve të shtëpisë sikur ishte ndërrë një lidhie dëshirash dhe ëndrrash të përbashkëta Ata, vetë shtëpia, që ishte plot jetë e urtësi, ndillnin gonxhe të reja jetë, përv. ta zbuluar këtë më shumë, për ta rritur e përtërirë përherë.

— Dekoja e nusja hynin e dilnin. Xha Tareja py-
eti tē shoqen:

— Ku vajtēn?

— Në ashef.

— Shiko çfarë mund tē na sillni gjë tjetër.

Gruaja u ngrit. Fjalët e fundit tē xha Tares tregonin sikur ia donte zemra tē mbeteshim ne tē katér. Ai e përçolli tē shoqen me vështrim, gjersa ajo mbylli derën. Pastaj, me një zë tjetër nga ai me tē cilin na kishte folur gjer atëherë, tha:

— Dua tē bëj një pyetje...

— Urdhéro, — foli mjeku dhe mbajti vesh.

— Kam dëgjuar... — dhe xha Tareja u mbllaçit.

— Çfarë?

— ...Se mishi i një njeriu bashkohet, ngjitet me atë tē një tjetri... E vërtetë është?

U duk sikur xha Tareja kishte nxjerrë një peshë që i rëndonte dhe ishte lehtesar. Ai ia kishte ngulur sytë mjekut dhe prej tij priste përgjigje; buzët i kishin mbetur pak tē hapura, koka i ishte bërë mënjanë.

— Po... ka raste... — iu përgjigj mjeku.

Xha Tareja mori frymë thellë, Fytyra e tij ndriti, më kureshtare. Ai u zgjat përrpara, mbështeti tē dy parakrahët mbi tryezë dhe pyeti:

— Si bëhet kjo punë?

— Kur një njeri plagoset a dëmtohet nga shkaqe tē ndryshme, marrin pjesë nga një tjetër dhe ia vënë...

— Ç'thua?! Po a ngjitet mishi i tjetrit?

— Po.

— Çudi! — tundi kokën xha Tareja dhe më vështroi.

— Sidomos pjesë lëkure përdoren dendur... —
shtoi mjeku.

— Këtu ftyra e xha Tares u bë më e kthjellët dhe
ai foli me nxitim.

— Pjesë lëkure, the?

— Po, po. Në djegie të rënda, merren pjesë lëk-
ure nga vende të caktuara të trupit dhe i vihen atiji
që është djeguri, për ta mjekuar sa më mirë.

— Kujt ia marrin këto lëkurë?

Atyre që dëshirojnë të dhurojnë.

— A është punë e vështirë kjo?

— E lehtë nuk është...

Xha Tareja râ në mendime, duke shikuar në
heshtje mjekun.

Në këtë kohë, u hap dera dhe bashkë me Dekon
hyri një burrë irreth të dyzetave.

— Mirëmbrëma, — foli ai. — Më falni që pô vij
në këtë orë, pór tani dolëm nga mbledhja.

— Urdhéro, urdhéro, Syrja, — u ngrit xha Ta-
reja dhe i trëgoi atij një karrige të lirë në tryezë.

— Jo, jo. Ju bëftë mirë, — tha tjetri. — Fálémi-
nderit. Vetëm për një fjalë erdhá.

— Hajde tani, mos ma prish mua! — theksoi xha
Tareja dhe u kthyte nga ne, — E kemi kryetarin e
Frontit; jemi fqinjë.

— Nesër na vijnë vullnetarë nga qyteti, — shpje-
goi Syrjai, duke u ulur. — Janë nga parku i automo-
bilave. Do të qëndrojnë një vit te ne. Prandai, që
në mëngjes dó të zbrësim për t'i pritur në lokalitet.
Do të dalë nga një njeri për shtëpi. Le të vijë Deko-
ja, të kemi dhe ca femra.

— Vlij edhe unë t'i pres, — u hodh xha Tareia.

— Mos u mundo. Rruga është rënduar shumë.
Pa e di që nuk përton.

... Biseda u shtrua. Pastaj, fjalët u rralluan. Në dhomë sikur gjithçka po binte në mendim.

Vura re xha Taren dhe mjekun, që ishin futur në të thella. Mjeku ngriti kokën dhe vështroi të zotin e shtëpisë. Ky sikur po e përgjonte tjetrin tinsizt. M'u duk se te mjeku ishte ndezur një kërshëri. Ai deshi ta shuante.

— Xha Tare, përsë më pyete qëparë nëse mishimi dy njerëzve mund të ngjitet? — pyeti.

Tjetrit sikur nuk i erdhi mirë nga kjo pyetje.

— Hi... kot... — lëvizi ai në karrigen që krisi, thua t'i shmangej hetimit që po i bënte mjeku. Ai u mat ta kthente bisedën nga Syrjai.

— Si kot?... — vazhdoi mjeku. — Apo të ka zë/ në gjë veshi?...

Xha Tareja nuk iu përgjigji menjëherë. U pa që i peshoi fjalët, pa i nxori.

— Po xheç kisha dëgjuar... ndaj thashë: të pyes një herë doktorin...

Dhe përsëri u drejtua nga Syrjai, sikur pyetjet e mjékut po e mërzitnin.

Syriai e kuptoi gjendjen aë ishte krijuar.

— S'di gië; o doktor? — ndërhyri ai.

— Cfarë?

— C'i ka ngjarë Xha Tares me Astritin?...

— Jo. Cilin Astrit?

— Të birin... E ka ushtar...

— S'kam marrë vesh gjë.

Xha Tareja u ndërrua në fytyrë. Ai ia preu fjalën Syrjaít:

— Eu! iku e vajti ajo! Mesele e vjetër. Pa ngrijë një gotë...

Dhe mori kupën e rakisë.

— Hajde, gëzuar! Ju paçim sa malet!

— Do ta pi një gotë, xha Tare, por dëftuat trëz goj atë ndodhi miqve. Mos u mërzit, se ti nuk doj e di unë.

Neve na shkoi mendja se në këtë mes do të kishte ndonjë gjë jo fort të pëlqyer për të zotin e shtëpisë. — Mos u vejë mendja për të keq, — na u drejtua Syrjai, sikur t'i kishte zbuluar mendimet tonë. — Jo. Eshtë një gjë e mirë, shumë e mirë bile, por as xha Tares, as të tjerëve të familjes, nuk ua ka ëndë ta mbajnë nëpër gojë, ta rrëfejnë, se u duket si lëvdatë. Më ka zënë veshi se këtë huq xha Tareja e ka pasur që kur ishte partizan. Nuk i pëlqente ta lëvdonin.

— Si është puna? — pyeti mjeku.

— Hëm! Ajo, për të cilën të ka bërë pyetje, i ndodhi të birit.

— Si?

— Në repartin e tij u dogj një ushtar. Katër shokë dolen vullnetarë dhe i dhanë lëkurë. Midis tyre ishte dhe Astriti.

— Tani kuptova, — pohoi mjeku. — Prit dhe mbaj vesh, — vazhdoi Syrjai. — Këta nuk dinin gjë. Ai nuk u shkroi. Edhe kur erdhim me leje në shtëpi, nuk u tregoi.

— Vërtet, xha Tare? — u ktheva unë nga i zoti i shtëpisë.

Por ky nuk më dha përgjigje. — Hë, de, tregoje vetë! S'e mban dot të fshehëtë... — e ngacmoi Syrjai.

Xha Tareja e pa tjetrin vëngër, tundi kökën dhe tha:

— E, o Syrjai...

Pastaj, dashje pandashje, shpjegoi:

— Na erdhi një javë me leje. E pyetëm përsë ia

tij. Ai kishte hall se mos ndonjërit nga pjesëtarët e familjes i shpëtonte goja është na tregonte ngarjen e të birit.

— Më falni, se u bë vonë, — kërkoi leje Syrjai dhe u ngrit.

— Edhe ne do të biem, ndonëse muhabeti na pëlqen. Por, miqtë i kemi të lodhur. Shtroni, — u foli xha Tareja grave.

Mbi minder na shtruan dyshekë e çarçafë të rinj, jorganë ngjyrë alle, që i nxorën nga musandra.

Ramë. Po gjumi nuk po më zinte. Isha plot mbresa e mendime, që nuk më linin të mbyllja sy. Edhe mjeku u vërtit një dy herë në shtrat. Ndofta, edhe ai, si unë, po mendohej e po i përqaste këta njerëz të mirë me malet e këtyre viseve, që janë të thjeshta e të heshtura, por që majat i kanë të larta, shumë të larta.

PASQYRA E LËNDËS

Kapedan Cilja dhe i nipi	3
Një grua e lagjes së vjetër	24
Mirëmëngjes profesor	61
Mollët	72
Përtëritje	83
Këpucët	114
Vallja që nuk mbaroi	126
Angullimat e qenve natën	142
Familja e ushtarit	170